



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 567 Akti

Nr. 650 Vendim  
Tiranë, më 27.4.2023

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përberë nga:

<b>Etleda Çiftja</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Firdes Shuli</b>	<b>Relatore</b>
<b>Suela Zhegu</b>	<b>Anëtare</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler në datat 24.4.2023 dhe 27.4.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Ylli Pjetërnikaj**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneres Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Z. Ylli Pjetërnikaj është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës

së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

**2.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.6.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Alma Faskaj dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Alma Faskaj.

**3.** Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

**4.** Me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Ylli Pjetërnikaj duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktoj kryesuesen e trupit gjykues, komisioneren Etleda Çiftja. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Po kështu, në datën 24.11.2020, subjekti, përmes postës elektronike deklaroi se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

**5.** Me vendimin e Komisionit nr. “\*\*\*”, datë 13.7.2022, u vendos zëvendësimi me short i komisioneres relatore Alma Faskaj në çështjet e shortit të muajit qershor 2020, nga ku rezultoi se kjo çështje do të ndiqej nga komisionere Firdes Shuli.

**6.** Në datën 5.12.2022, subjekti u njoftua përmes postës elektronike për trupën e re gjyquese, dhe po në këtë datë ai njoftoi mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

**7.** Me vendimin nr. 2, datë 30.3.2023, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj dhe vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit të bazohet në të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

**8.** Në datën 5.4.2023, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 19.4.2023; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni administroi një denoncim nga shtetasja Shaqe Marinaj, për të cilin, trupi gjykues me vendimin nr.3, dt.14.04.2023, vendosi t’i kërkojë subjektit sqarime mbi pretendimet e ngritura në këtë denoncim.

**9.** Subjekti i rivlerësimit dërgoi përmes postës zyrtare parashtrimet e tij dhe dokumentacionin shoqërues mbi rezultatet e hetimit administrativ, protokolluar nga Komisioni me nr. “\*\*\*” prot., datë 20.4.2023.

**10.** Me vendimin nr. 4, datë 20.4.2023, trupi gjykues vendosi kalimin e çështjes në seancë dëgjimore dhe caktimin e seancës dëgjimore për në datën 24.4.2023.

**11.** Në datën 24.4.2023 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

**12.** Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**13.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**14.** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit dhe Pasurive dhe Konfliktit të Interesit është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

**15.** Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, bazuar në nenet 45,46, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar nga ILDKPKI-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (ii) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar nga DSIK-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (iii) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP) dhe dokumentet shkresore të paraqitura prej tyre; (iv) provat shkresore/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet apo subjektet publike a private; (v) denoncimet e publikut, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe çdo informacion i marrë në rrugë ligjore; (vi) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit; (vii) sugjerime/opinionet të vëzhguesit të ONM-së sipas pikës 11 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016.

### **III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI**

#### **Vlerësimi i pasurisë**

**16.** Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë në datën 27.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2013, me nr. indeksi “\*\*\*”, ka dorëzuar sipas ligjit deklaratën përpara fillimit të detyrës (në vijim DPF) në vitin 2013 dhe në vijim ka dorëzuar rregullisht deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV).

**17.** ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, dhe në përfundim të veprimeve verifikuese, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e pasurive; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

**18.** Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1 të nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit

të rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016.

**19.** Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

#### **Pasuri të deklaruara në deklaratën Vetting nga subjekti i rivlerësimit**

**20.** Pasuria *Shtëpi banimi, e cila ndodhet në Bashkinë Tropojë, fshati "\*\*\*\*", Njësia administrative "\*\*\*\*". Sipërfaqe 460 m<sup>2</sup>, 2 kate plus papafingo. Ajo është ndërtuar në vitin 1990 nga prindërit si dhe familjarët e tjerë. Është rikonstruktuar në vitin 2007 dhe së brendshmi në vitin 2014. Është në proces legalizimi me kërkesën për aplikim nr. "\*\*\*\*" prot., në vitin 2014. Kërkesa për aplikim është bërë në emrin tim për lehtësi aplikimi dhe për llogari edhe të anëtarëve të tjerë të familjes, sipas certifikatës familjare bashkëngjitur praktikës. Në momentin e legalizimit do të bëhet pjesëtimi vullnetar, shkak për të cilin unë kam deklaruar vetëm 25 % të saj.*

*Dua të sqaroj se për rikonstrukcionin e bërë në vitin 2014 të sipërcituar janë përdorur të ardhura nga ato të deklaruara pranë ILDKPKI-në në vitin 2013, të akumuluar ndër vite nga anëtarët e familjes, si dhe nga të ardhurat e fermës.*

*Objektet me destinacion stallë për bagëti, të cilat ndodhen në Bashkinë Tropojë, fshati "\*\*\*\*", Njësia administrative "\*\*\*\*", në afërsi të banesës së sipërtreguar. Ato kanë sipërfaqe 140 m<sup>2</sup> dhe 40 m<sup>2</sup>, të ndërtuara nga prindërit dhe vëllezërit e tjerë në vitin 1990. Janë në proces legalizimi me kërkesat për aplikim nr. "\*\*\*\*" prot. dhe nr. "\*\*\*\*" prot., në vitin 2014. Kërkesat për aplikim janë bërë në emrin tim për llogari edhe të anëtarëve të tjerë të familjes, sipas certifikatës familjare bashkëngjitur praktikës. Pavarësisht gjendjes civile dhe në kuptimin pasuror, këto pasuri janë të përbashkëta dhe në momentin e regjistrimit edhe këto pasuri do të pjesëtohen në mënyrë vullnetare.*

*Vlera: sipas vlerës së tregut, në total të gjitha objektet mendoj se kanë vlerën 25.000.000 lekë. Sipas situacionit të punimeve, vlera totale e tyre: 17.953.001. Pjesa takuese: 25%.*

**21.** ILDKPKI-ja në lidhje me këtë pasuri ka konstatuar: (i) banesa dhe dy stallat e bagëtive nuk konfirmohen nga ZVRPP-ja Tropojë, pasi banesës i ka dalë vetëm leja e legalizimit, por që të regjistrohet pritet të miratohet trualli me VKM, ndërsa dy objektet stalla bagëtish, konfirmohen nga ALUIZNI në proces verifikimi e legalizimi; (ii) mospërputhje ndërmjet aplikimit për legalizim të bërë nga subjekti Ylli Pjetërnikaj më 19.12.2014, sipas të cilit banesa në Tropojë është ndërtuar në vitin 2005, dhe deklaratës së rivlerësimit, ku deklarohet se ndërtimi është bërë në vitin 1990, rikonstruktuar në vitin 2007 dhe së brendshmi në vitin 2014. Është i pasqaruar fakti se pse aplikimi është bërë në emër të subjektit Ylli Pjetërnikaj dhe jo në emër të babait, si përfaqësues i familjes, të vëllait të madh apo ndonjë pjesëtar tjetër të familjes, meqenëse është pasuri e përbashkët. Si e tillë, nuk është i qartë deklarimi i pjesës takuese prej 25%, pasi referuar certifikatës së trungut familjar, subjekti ka në familje prindërit, katër vëllezër dhe tri motra; (iii) mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat familjare, të cilat referuar deklaratës së rivlerësimit, kanë shërbyer si burim për asetet e deklaruara, ndër të cilat edhe për ndërtimet në Tropojë, rrjedhimisht mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e pasurive; (iv) gjithashtu, në deklaratën "para fillimit të detyrës 2013, subjekti ka

deklaruar gjendje *cash* 20.000.000 lekë, me zotërim të tij 50%, e krijuar ndër vite nga puna dhe ferma, për të cilat nuk ka burime të ligjshme financiare për krijimin e tyre.

## Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

**22.** Nga verifikimi i deklarimeve rezulton se subjekti ka deklaruar ndër vite pasurinë si vijon:

- Në DPDFD-në e vitit 2013, ka deklaruar: *“Shtëpi banimi në fshatin “\*\*\*\*”, Komuna “\*\*\*\*”, sip. 660 m<sup>2</sup>, 2 kate + papafingo, ndërtuar në vitin 1991, rikonstruktuar në vitin 2007. Vlera: 25.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”*.

- Në DPV-në e vitit 2014 ka deklaruar: *“Rikonstrukcion i shtëpisë së banimit në Tropojë në vlerën 2.100.000 lekë”*.

- Në deklaratat e viteve 2015 – 2017 nuk ka deklaruar ndryshime, shtesa, pakësime të kësaj pasurie.

- Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar një shtëpi banimi dhe dy stallat në pjesë takuese 25% me vlerë tregu 25.000.000 lekë dhe sipas situacionit të punimeve bashkëlidhur me vlerë 17.953.001 lekë.

- Në DPV-në e vitit 2018, ka deklaruar: *“Shtëpia e banimit së bashku me godinat e shërbimit të pasqyruara në deklaratën fillestare të vitit 2013, të cilat kanë qenë në proces legalizimi, janë legalizuar me lejet përkatëse të legalizimit dhe janë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tropojë, me nr. pasurie... pjesa takuese 10%”*.

**23.** Banesa dhe dy godinat/stallat kanë kaluar në proces legalizimi pasi vetëdeklarimet për legalizim janë bërë nga subjekti Ylli Pjetërnikaj në datën 19.12.2014, ku si periudhë e ndërtimit të objekteve është deklaruar viti 2005, dhe rregjistrimi përfundimtar i tre objekteve është kryer në bashkëpronësi të subjektit dhe vellezërve të tij në ¼ pjesë takuese.

**Ne rend kronologjik, për të treja pasuritë, nga verifikimi i akteve shkresore<sup>1</sup>, rezultoi se:**

**23.1** Në lidhje me objektin “godinë banimi 2 kate”:

- Ky objekt është legalizuar me lejen e legalizimit nr. “\*\*\*\*”, datë 28.7.2017, në emër të subjektit Ylli N., Pjetërnikaj. Sipas lejes, sipërfaqja e ndërtimit është 234.57 m<sup>2</sup>, nr. i kateve mbi tokë është 2 (dy) dhe sipërfaqja e parcelës ndërtimore 500 m<sup>2</sup>.

- Objekti është ndërtuar në tokë shtet dhe me VKM-në nr. 810, datë 29.12.2017, është bërë kalimi i të drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore, në favor të z. Ylli Pjetërnikaj.

- ASHK/Zyra Vendore Tropojë me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 23.12.2020 konfirmoi të regjistruar në emër të 10 bashkëpronarëve N.P., L.P., A.P., F.P., V.P., F.P., V.P., A. P., Ylli Pjetërnikaj, Y.P.,<sup>2</sup> pasuritë si vijojnë: (i) pasuria nr. “\*\*\*\*”, z. k. “\*\*\*\*”, Tropojë, fshati “\*\*\*\*”, ndërtesë me sip. 234,57 m<sup>2</sup>, regjistruar në datën 9.11.2017, me leje legalizimi nr. “\*\*\*\*”, datë 28.7.2017. Sip. e katit përdhe 228.86 m<sup>2</sup>, sip. e katit të parë 228.86 m<sup>2</sup>, sip. e shkallës 5.71 m<sup>2</sup>; (ii) pas. nr. “\*\*\*\*”, z. k. “\*\*\*\*”, Tropojë, fshati “\*\*\*\*”, lloji i pas. truall, sip. 500 m<sup>2</sup>. Pasuria është fituar me VKM, regjistruar në datën 12.12.2019.

- Sipas kartelës së pasurisë me datë 23.12.2021, pasuria ka nr. “\*\*\*\*” dhe është në bashkëpronësi të shtetasve Ylli, Y., A., e A.P., dhe secili prej tyre zotëron ¼ pjesë, ose 25%, aq sa është deklaruar pjesa takuese e subjektit në deklaratën *Vetting*.

<sup>1</sup> Shihni aktet në aneksin 4/1, në dosjen e ILDKPKI-së, shkresa nr. “\*\*\*\*” prot., datë 21.10.2021, e ASHK-së, Drejtoria Vendore Kukës, protokolluar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 25.10.2021; shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 23.12.2020, e ASHK, Zyra Vendore Tropojë, protokolluar në Komision me nr. “\*\*\*\*”, datë 9.4.2021; shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 16.12.2020, e ASHK-së, protokolluar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 21.12.2020; dokumentat në përgjigje të pyetësorit nr.4.

<sup>2</sup> Referuar certifikatës së përbërjes familjare në datën 1.8.1991, këta bashkëpronarë janë prindërit dhe vellezërit e motrat e subjektit.

- FSHU-ja<sup>3</sup> ka informuar se për këtë objekt janë lidhur dy kontrata për furnizim me energji elektrike, konkretisht kontrata me nr. "\*\*\*\*", datë 17.11.2020, në emër të shtetasit A. P., dhe kontrata me nr. "\*\*\*\*", në emër të shtetasit N.P., datë 28.2.2006.

### **23.2** Në lidhje me objektin "godinë shërbimi 1 kat" (stalla e parë e bagëtime):

- Ky objekt është legalizuar me lejen e legalizimit nr. "\*\*\*\*", datë 24.5.2018, në emër të subjektit Ylli N., Pjetërnikaj. Sipas lejes së legalizimit, sipërfaqja e ndërtimit është 101.25 m<sup>2</sup>, përmirësuar në vitin 2014 dhe sipas fotografimit në platformën *Google Earth*, objekti është me një kat mbi tokë dhe sipërfaqja e parcelës ndërtimore është 300.07 m<sup>2</sup>.

- ASHK/Zyra Vendore Tropojë konfirmoi<sup>4</sup> të regjistruar në emër të 10 bashkëpronarëve pasurinë nr. "\*\*\*\*", z. k. "\*\*\*\*", Tropojë, fshati "\*\*\*\*", sip. 300.7 m<sup>2</sup> truall dhe 101.25 m<sup>2</sup> ndërtesë. Ndërtesa është fituar me leje legalizimi nr. "\*\*\*\*", datë 24.5.2018, ndërsa trualli me VKM-në nr. 315, datë 15.5.2019, "Për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara". Pasuria është regjistruar në datën 9.7.2020.

- Sipas kartelës së pasurisë pasuria nr. "\*\*\*\*" është në bashkëpronësi të shtetasve Ylli, Y., A., e A.P., dhe secili prej tyre zotëron ¼ pjesë, ose 25%, aq sa është deklaruar pjesa takuese e subjektit në deklaratën *Vetting*.

### **23.3** Në lidhje me objektin "godinë shërbimi 1 kat" (stalla e dytë e bagëtime):

- Ky objekt është legalizuar me lejen e legalizimit nr. "\*\*\*\*", datë 24.05.2018, në emër të subjektit Ylli N., Pjetërnikaj. Sipas lejes së legalizimit, sipërfaqja e ndërtimit është 48.4 m<sup>2</sup>, me një kat mbi tokë dhe sipërfaqja e parcelës ndërtimore është 144.38 m<sup>2</sup>.

- ASHK/Zyra Vendore Tropojë konfirmoi<sup>5</sup> të regjistruar në emër të 10 bashkëpronarëve pasurinë "\*\*\*\*", z. k. "\*\*\*\*", Tropojë, fshati "\*\*\*\*", sip. 144.38 m<sup>2</sup> truall dhe 48.40 m<sup>2</sup> ndërtesë. Ndërtesa është fituar me lejen e legalizimit nr. "\*\*\*\*", datë 24.5.2018, ndërsa trualli me VKM-në nr. 315, datë 15.5.2019, "Për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara". Pasuria është regjistruar në datën 9.7.2020.

- Sipas kartelës së pasurisë pasuria nr. "\*\*\*\*" është në bashkëpronësi të shtetasve Ylli, Y., A., e A.P., dhe secili prej tyre zotëron ¼, ose 25%, aq sa është deklaruar pjesa takuese e subjektit në deklaratën *Vetting*.

**24.** Në analizë të deklarimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, gjatë hetimit administrativ u konstatuan disa mospërputhje për të cilat janë kryer një numër i konsiderueshëm veprimesh hetimore, trajtuar si në vijim.

### **Sa i takon pjesës takuese**

**24.1** Në deklaratën e vitit 2013, subjekti ka deklaruar pjesën në përqindje 100%, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar pjesën në përqindje 25 %, me shpjegimin: "*Në momentin e legalizimit do të bëhet pjesëtimi vullnetar, shkak për të cilin unë kam deklaruar vetëm 25 %*". Në vijim, në DPV-në e vitit 2018, ka deklaruar pjesë takuese 10%.

**24.2** Me qëllim përcaktimin/saktësimin e pjesës takuese të subjektit, Komisioni iu referua nenit 49 të ligjit nr. 33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", sipas të cilit regjistrimi

<sup>3</sup> Shihni shkresat nr. "\*\*\*\*" prot., datë 17.2.2021 (administruar në Komision me nr. "\*\*\*\*" prot., datë 20.12.2021); shkresa nr. "\*\*\*\*" prot., datë 17.1.2022 (administruar në Komision me nr. "\*\*\*\*" prot., datë 19.1.2022); shkresa e FSHU/OSHEE nr. "\*\*\*\*" prot., datë 7.3.2022 dhe dokumentacioni bashkëlidhur (akt konstatime, procesverbale të verifikimit në terren, foto, etj.) dhe sqarimet në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe dokumentet, si dhe sqarimet në përgjigje të pyetësorit nr. 6, të paraqitura nga subjekti.

<sup>4</sup> Me shkresën nr. "\*\*\*\*" prot., datë 23.12.2020 (administruar në Komision me nr. "\*\*\*\*" prot., datë 9.4.2021).

<sup>5</sup> Me shkresën nr. "\*\*\*\*" prot., datë 23.12.2020 (administruar në Komision me nr. "\*\*\*\*" prot., datë 9.4.2021).

bëhet në favor të subjektit të cilit i është lëshuar leja e legalizimit, ndërkohë kreu verifikimet si vijojnë:

- ASHK/ZV Tropojë informoi<sup>6</sup> se pas informacionit të marrë nga Komisioni, kjo zyrë ka konstatuar se regjistrimi i banesës + dy stallat, është bërë në mënyrë të gabuar në pronësi të 10 bashkëpronarëve sipas certifikatës së datës 1.8.1991 e, për këtë arsye, u bënë korrigjimet përkatëse në të dhënat kadastrale. Përfundimisht, informon se, me ndryshimet e bëra në nëntor 2021, u regjistruan në pronësi individuale të subjektit Ylli Pjetërnikaj të tria pasuritë si vijojnë: pasuria nr. "\*\*\*\*", me sip. 144.38 m<sup>2</sup> truall + 48.40 m<sup>2</sup> ndërtesë; pasuria nr. "\*\*\*\*", me sip. 300.07 m<sup>2</sup> truall + 101.25 m<sup>2</sup> ndërtesë; pasuria nr. "\*\*\*\*", me sip. 500 m<sup>2</sup> truall + 234.57 m<sup>2</sup> ndërtesë. Siç vërehet, fillimisht regjistrimi i pasurive nuk është bërë vetëm në emër të aplikuesit, pra subjektit, por është bërë në emër të 10 bashkëpronarëve. Po kështu, vërehet edhe një gabim tjetër në regjistrimin fillestar pasi në periudhën kur është aplikuar për legalizim, në dhjetor të vitit 2014, babai i subjektit N.P., dhe vëllai i tij F.P., nuk jetonin më<sup>7</sup> dhe pavarësisht nga ky fakt, ata janë regjistruar si bashkëpronarë në pasurinë objekt vlerësimi. Duket se këto kanë qenë arsyet që ZVRPP-ja ka bërë korrigjimet përkatëse sikurse dhe ASHK/ZV Tropojë konfirmon.

- I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me regjistrimin në emër të 10 bashkëpronarëve dhe mospërputhjet e deklarimeve për pjesën takuese, subjekti sqaroi<sup>8</sup> se si dokument për të bërë regjistrimin e këtyre objekteve nga ASHK ZV Tropojë në emër të 10 personave, mund të ketë shërbyer një certifikatë familjare e muajit gusht të vitit 1991, e cila kishte në përbërjen e familjes 10 persona. Sipas tij, kjo certifikatë ishte administruar prej tij dhe dorëzuar prej tij, në kuadër të grumbullimit të dokumentacionit për efekt të aplikimit për regjistrimin e objekteve sipas VKM-së nr. 608, datë 5.9.2012, akt që kishte për objekt kalimin e pronësisë të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më 10.8.1991 dhe të truallit të tyre funksional, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie. Më tej, ai ka informuar se grumbullimi i dokumentacionit dhe aplikimi prej tij për legalizim ishte për shkak të formimit juridik krahasimisht me familjarë të tjerë të tij. Kur ai kishte plotësuar formularët e vetëdeklarimit, të njëjtat dokumente të cilat më parë ishin paraqitur në komunë dhe ishin kthyer mbrapsht nga kjo e fundit (sepse duhet të paraqiteshin pranë ALUIZNI-t në Kukës), i ka paraqitur pranë ALUIZNI-t, e më tej, e gjithë procedura e legalizimit dhe regjistrimit të ndërtesave në emër të 10 bashkëpronarëve është bërë nga ana e punonjësve të ALUIZNI-t dhe ASHK, ZV Tropojë, të cilët kanë vijuar komunikimet zyrtare në adresën e vëllezërve të tij, të cilët nuk kishin pasur ndonjë rol. Mbi bazën e vërtetimeve nga dokumentet hipotekore të vitit 2017 ku ai rezultonte bashkëpronar me 1/10, janë kryer edhe deklaratimet përkatëse pranë ILDKPKI-së (konkretisht në DPV për vitin 2018 është deklaruar 10%). Sipas subjektit, për anëtarët e familjes së tij ka pasur rëndësi të madhe legalizimi dhe regjistrimi i arritur pas 27 vitesh, duke marrë rëndësi sekondare emri i familjarëve që rezultojnë bashkëpronarë, pasi bashkëpronësia faktike sipas numrit të vëllezërve është e qartë dhe e pakontestuar nga asnjë prej tyre.

- Në vijim, subjekti bën me dije se ka marrë njoftim nga ASHK Tropojë mbi korrigjimet përkatëse të bashkëpronësisë në mënyrë të njëanshme nga punonjësit e kësaj zyre, duke i regjistruar pasuritë vetëm në pronësi të tij për shkak se aplikimi për leje legalizimi ishte bërë prej tij. Ai sqaron se deklarimi i pjesës takuese prej 25% në deklaratën *Vetting* lidhet me pjesëtimin vullnetar që do të bëhej në momentin e legalizimit, e në këto kushte ka informuar Komisionin se ai dhe tre vëllezërit e tij Y., A., dhe A., kanë kryer në datën 15.12.2021 veprimin

<sup>6</sup> Me shkresën e saj nr. "\*\*\*\*" prot., datë 26.11.2021 (administruar në Komision me nr. "\*\*\*\*" prot., datë 1.12.2021).

<sup>7</sup> N.P., babai, ka vdekur më 26.11.2010 dhe pasqyrimi i këtij fakti në gjendjen civile është bërë më 2.3.2011 (sipas shpjegimeve të subjektit në pyetësorin nr. 3 dhe shënimit në certifikatën familjare datë 20.11.2019, përcjellë nga subjekti me pyetësorin nr. 2). F.P., vëllai, ka vdekur në vitin 2007.

<sup>8</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3 dhe nr. 4 në dosjen e Komisionit.

juridik të dhurimit për të formalizuar pjesët e tyre takuese, veprim i cili është regjistruar në ASHK ZV Tropojë. Në mbështetje të deklaramëve të tij subjekti ka paraqitur një kontratë dhurimi me nr. "\*\*\*\*", me datë 15.12.2021, sipas së cilës Ylli Pjetërnikaj u ka dhuruar tre vëllezërve të tij A., A., dhe Y.P.,  $\frac{3}{4}$  e secilës prej pasurive të trajtuara më lart (secilit prej tyre nga  $\frac{1}{4}$ ) dhe në bazë të kësaj kontrate, është bërë regjistrimi i pasurive në bashkëpronësi të katër vëllezërve. Përfundimisht, sipas kartelave të pasurive nr. "\*\*\*\*", "\*\*\*\*" dhe "\*\*\*\*" këto tri pasuri janë në bashkëpronësi të shtetasve Ylli, Y., A., e A.P., dhe secili prej tyre zotëron  $\frac{1}{4}$  pjesë në secilin prej objekteve, ose 25%, aq sa është deklaruar pjesa takuese e subjektit në deklaratën *Vetting*.

**24.3** Sa më sipër, nuk ka pasur dyshime sa i takon pjesës takuese të subjektit në pasurinë objekt vlerësimi, e cila u vertetua të jetë është 25%, sikurse subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*. Po kështu, subjekti ka sqaruar në mënyrë shteruese dhe bazuar në dokumente shkresore shkakun e mospërputhjeve në deklarime në lidhje me pjesën e tij takuese në pasuri. Konkretisht: (i) sa i takon deklaramit të pjesës takuese prej 100% në DPFĐ-në e vitit 2013, duket se subjekti i është referuar faktit që aplikimi për legalizim është kryer prej tij dhe jo pjesës *de facto* të tij; (ii) sa i takon deklaramit të pjesës takuese 10% në DPV për vitin 2018, i është referuar vërtetimit hipotekor me datë 8.11.2017 për ndërtesë banim dy kate, trualli shtet<sup>9</sup>, i cili vërteton bashkëpronësinë e 10 bashkëpronarëve bazuar në certifikatën familjare të vitit 1991, ashtu sikurse edhe ASHK Tropojë informon Komisionin.

**Sa i takon sipërfaqeve të deklaruara, periudhës së ndërtimit/investimeve dhe numrit të objekteve**

**24.4** Në lidhje me shtëpinë e banimit

**a.** Sa i përket sipërfaqes vërehet se:

- Në DPFĐ-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar sip. 660 m<sup>2</sup>, 2 kate plus papafingo (janë deklaruar edhe dy stallat siç është trajtuar në vijim).
- Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar 460 m<sup>2</sup>, 2 kate plus papafingo.
- Sipas lejes së legalizimit, objekti është 2 kate, me çati të pashfrytëzueshme, sipërfaqja e ndërtimit të një kati është 234.57 m<sup>2</sup>.
- Në DIPP-në e vitit 2018 subjekti ka deklaruar që kjo pasuri është regjistruar me sip. 234.57 m<sup>2</sup> godinë banimi, ashtu sikurse konfirmon edhe ASHK-ja, sipas së cilës, objekti është regjistruar në datën 9.11.2017 ndërtesë me sip. 234,57 m<sup>2</sup>. Sip. e katit përdhe 228.86 m<sup>2</sup>, sip. e katit të parë 228.86 m<sup>2</sup>, sip. e shkallës 5.71 m<sup>2</sup>.

**b.** Sa i përket vitit të ndërtimit dhe rikonstruksioneve:

- Në DPFĐ-në e vitit 2013 ka deklaruar që është ndërtuar në vitin 1991 (rikonstruktuar në vitin 2007).
- Në shpjegimet e dhëna para ILDKPKI-së më 31.3.2016 ka deklaruar që është ndërtuar në vite, duke filluar nga viti 1992.
- Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar që pasuria është ndërtuar në vitin 1990 nga prindërit, si dhe familjarët e tjerë, dhe është rikonstruktuar në vitet 2007 dhe 2014.
- Në formularët e vetëdeklaramit për legalizim, datë 19.12.2014, është deklaruar që objektet janë ndërtuar në vitin 2005.

**24.5** Në lidhje me dy objektet stalla bagëtish, vërehet se:

- Në DPFĐ-në e vitit 2013 nuk ka deklaruar objekte me destinacion stallë për bagëti, por, siç ka rezultuar nga hetimi, ka deklaruar sipërfaqen totale të objektit prej 660 m<sup>2</sup>, në të cilën përfshihen edhe dy objektet ndihmëse, stallat e bagëtive.

<sup>9</sup> Konfirmuar me shkresë të ASHK Tropojë nr. "\*\*\*\*" prot., datë 26.11.2021.



- Në shpjegimet e dhëna para ILDKPKI-së më 31.3.2016 ka deklaruar: “...sqaroj se aplikimi për legalizim është bërë për tre objekte, së pari për banesën prej 460 m<sup>2</sup>, së dyti dy stallat e bagëtive rreth 140 m<sup>2</sup> dhe së treti, një sipërfaqe e vogël banese prej 40 m<sup>2</sup>, e cila është e shkëputur nga banesa kryesore”. Siç vërehet, ky deklaram është i paqartë pasi duket sikur bëhet fjalë për katër objekte, por në fakt në të gjitha deklaramet periodike apo gjatë procesit të rivlerësimit bëhet fjalë për tre objekte, aq sa në fakt kanë rezultuar edhe nga hetimi administrativ.

- Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar dy objekte me destinacion stallë për bagëti, me sipërfaqe përkatësisht 140 m<sup>2</sup> dhe 40 m<sup>2</sup>. Subjekti duket se i është referuar planimetrive bashkëlidhur vetëdeklarimit ku rezulton se janë dy objekte me sipërfaqe përkatësisht 100 m<sup>2</sup> dhe 45.90 m<sup>2</sup>.

- Objektet e legalizuara dhe të regjistruara në ASHK janë me sip. 101.25 m<sup>2</sup> dhe sip. 48.40 m<sup>2</sup>.

**24.6** Me qëllim qartësimin e sipërfaqeve dhe periudhës së ndërtimit/investimeve, nga ana e Komisionit u kryen veprimet hetimore si vijojnë:

- U kërkua informacion nga ASIG-u dhe ASHK-ja, të cilat kanë vënë në dispozicion<sup>10</sup> përkatësisht: fotografimet ajrore të realizuara në vitet 2007 – 2008, 2015 nga ASIG-u, si dhe fotografimi ajror e rilevimi fotogrametrik i vitit 2007 nga ASHK-ja. Nga krahasimi i ortofotos së vitit 2007 (sipas ASIG-ut<sup>11</sup> periudha e fotografimit është 2007 – 2008) dhe asaj të vitit 2013, duket se objektet nuk kanë ndryshime sa i përket konfiguracionit dhe sipërfaqes. Ndërsa nga krahasimi i ortofotos 2007 me ortofoton e vitit 2015, sipas vijëzimit që i ka bërë ASIG-u kontureve të ndërtesave, duken ndryshime sa i përket konfiguracionit dhe sipërfaqes së objektit të banimit pasi është shtuar një shkallë 5.71 m<sup>2</sup> dhe një nyje sanitare (këto ndryshime janë për shkak të rikonstruksionit në vitin 2014 të deklaruar edhe nga subjekti në DPV për këtë vit). Po ashtu, në ortofoton e vitit 2007 duket sa ka 4 objekte. Sipas subjektit, objekti i katërt ishte zgjatim i njëres prej stallave, gjysmë i mbuluar me llamarinë e plasmas, që nuk përmbush kushtet për t’u kualifikuar si ndërtim. Ky deklaram i subjektit përputhet me ortofoton e vitit 2015 (që sipas shpjegimit nga ASIG-u, fotografimi është realizuar në periudhën 4.8.2016 – 12.7.2017), ku vërehen 3 objekte, ashtu sikurse subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*.

- U pyet subjekti në lidhje me vitin e ndërtimit të secilit prej objekteve, vitin e rikonstruksionit dhe llojin e punimeve të kryera për secilin prej objekteve, kostot, kontributin e subjektit në ndërtimin dhe rikonstruksionet e objekteve, si dhe iu kërkuan foto për të evidentuar ecurinë në vite të këtyre ndërtimeve si dhe gjendjen aktuale. Në përgjigjet e tij<sup>12</sup>, në mënyrë të përmbledhur, subjekti sqaroi se:

Së pari, në lidhje me mospërputhjet në deklaram mbi vitin e ndërtimit të objekteve, ato janë të paqëllimta dhe të kushtëzuara nga disa rrethana, të tilla si, mosha e tij kur kanë filluar punimet, shkëputja nga jeta familjare, të dhënat e përafërta të marra nga familjarët, mungesa e dokumentacionit zyrtar, si dhe faktin e përlllogaritjeve të kryera nga vetë familjarët. Sipas tij, babai N.P., ishte shpërngulur në këtë fshat në vitin 1990, ndërsa e gjithë familja është shpërngulur në vitin 1992<sup>13</sup>. Në periudhën 1990 – 1993 (kur subjekti ka qenë në moshë 3-5-vjeçare), babai dhe familjarë të tjerë, kanë ndërtuar një ndërtesë njëkatëshe me sip 69.3 m<sup>2</sup> dhe në afërsi prej 10 m nga banesa kanë ndërtuar edhe një stallë bagëtish dhe njësi shërbimi ndihmëse për përdorime të ndryshme sipas nevojave familjare. Më pas, në vitin 2005 deri në

<sup>10</sup> Shihni shkresat nr. “\*\*\*\*” prot., datë 22.12.2021; nr. “\*\*\*\*” prot., datë 6.2.2021 dhe nr. “\*\*\*\*” prot., datë 10.1.2021, të ASIG-ut dhe shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 11.3.2022, të ASHK Qendrore, shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 11.12.2020, shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 21.10.2021, të ASHK Kukës, në dosjen e Komisionit.

<sup>11</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 9.2.2021.

<sup>12</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorëve nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 7 dhe nr. 9, në dosjen e Komisionit.

<sup>13</sup> Shihni dokumentet ne pyetësorin standard - kopje vërtetimi nga zyra e gjendjes civile “\*\*\*\*” datë 15.5.2017, sipas së cilës familja e shtetasit N. P., është vendosur në fshatin “\*\*\*\*” me datë 13.5.1993; shihni dokumentet në pyetësorin nr. 2.

vitin 2007 është bërë shtimi i pjesës së katit të parë, i cili është suvatuar dhe mobiluar, ndërtimi i katit të dytë karabina dhe çatisë<sup>14</sup>. Në vitin 2014 është bërë rikonstruksioni i përgjithshëm dhe përshtatja e banesës sipas nevojave të reja si dhe është bërë unifikimi i çatisë, suvatimi i katit të dytë dhe mobilimi i tij<sup>15</sup>. Duke qenë se në vitin 2005 ndryshimet e ndërtimit ishin të prekshme dhe ai ka qenë në një moshë të rritur (në këtë periudhë është larguar për studime në Universitetin e Tiranës), kjo ka qenë sipas tij arsyeja që në vetëdeklarimin e ALUIZNI-t të vitit 2014, ka deklaruar si kohë ndërtimi këtë vit.

Së dyti, në lidhje me sipërfaqet ndërtimore në vite për objektin e banimit, ka deklaruar se: deri në vitin 1993, ka qenë 69.3 m<sup>2</sup>; deri në vitin 2007 në këtë pasuri është shtuar sip. e bazës me 159.56 m<sup>2</sup>, duke u bërë 225.86 m<sup>2</sup>. Po kështu, deri në këtë vit është shtuar edhe kati i parë teknik me sip. 228.86 m<sup>2</sup> si dhe papafingo me sip. 52.13 m<sup>2</sup>. Sip. totale e shtuar e ndërtimit është 440.55 m<sup>2</sup> (159.56 + 228.86 + 52.13). Pra, sipas këtyre sqarimeve sip. e përgjithshme e këtij ndërtimi në vitin 2007 është 69.3 m<sup>2</sup> (sip. ekzistuese) + 440.55 (sip. e shtuar) = 509.85 m<sup>2</sup>. Në vitin 2014, kjo ndërtesë dykatëshe është me sip. 234.57 m<sup>2</sup>, me sip. totale ndërtimi 457.72 m<sup>2</sup> (është prishur papafingoja, rikonstruktuar çatia, si dhe shtuar shkalla).

Së treti, në lidhje me mosedklarimin e dy objekteve ndihmëse/stallat në DPF 2013, subjekti sqaroi se sipërfaqja prej 660 m<sup>2</sup> e deklaruar në vitin 2013 përbën sipërfaqen ndërtimore brenda murit rrethues, e cila përfshin: 460 m<sup>2</sup> të banesës +101.25 m<sup>2</sup> njësi shërbimi (stallë) + stallë me sip. 48.9 m<sup>2</sup>, si dhe papafingo shtesë me sip. 52.13 m<sup>2</sup>, kjo deri në vitin 2013.

Së katërti, sa i takon numrit të ndërtesave, subjekti sqaroi se referuar fotografimit ajror 2015, nuk janë katër ndërtesa por në fakt janë tre (ashtu sikurse vërtetohet edhe me të gjithë dokumentacionin e administruar), duke pranuar kështu një gabim në deklarimin pranë ILDKPKI-së në vitin 2016. Sikurse shpjegohet edhe në raportin e vlerësimit të ekspertes L. B., objekti që vërehej në ortofoton e vitit 2007 ishte zgjatim i njëjës prej stallave, gjysmë i mbuluar me llamarinë e plasmas, që nuk përmbush kushtet për t'u kualifikuar si ndërtim.

Së pesti, sa i takon punimeve të kryera në vitin 2014, deklaruar si “rikonstruksion banese” në DPV-në e vitit 2014, nga të cilat është vërejtur një shtim në sipërfaqe dhe një ngritje në lartësi, në përgjigjet e pyetësorit nr. 9, subjekti ka sqaruar se për shkak të karakterit teknik të çështjes i është drejtuar një eksperti me njohuri të posaçme, i cili ka përpiluar një relacion teknik. Ndër detajet e shumta teknike, sqarimet e subjektit konsistojnë në faktin se shkalla me sip. 5.71 m<sup>2</sup> nuk përbën shtesë të sipërfaqes ndërtimore, pavarësisht se për shkak të pagesës së taksës infrastrukturore është llogaritur si e tillë nga ALUIZNI, dhe se teknikisht ajo është një rampë e jashtme, pa mbulesë. Ndërsa ndryshimi që vërehet në lartësi ka të bëjë me ngritjen e çatisë në njërën anë të ndërtimit dhe uniformitetin e saj me pjesën tjetër të çatisë. Ai ka deklaruar se në momentin e plotësimit të deklarimeve në DPV-në e vitit 2014, nuk ka qenë kërkesë pasqyrimi i punimeve në mënyrë të hollësishme në formë preventivi.

Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur dokumentacion shoqërues<sup>16</sup> si deklarata noteriale, ortofotot e viteve 2007, 2015 dhe foto ajrore (satelitore *Google Earth*) të viteve 2013 dhe 2016 një raport vlerësimi dhe një relacion teknik të ekspertes L.B.

**24.7** Nga të gjitha informacionet e administruara si më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, rezultoi se:

- Numri i ndërtesave pjesë përbërëse e pasurisë objekt vlerësimi është tre: një banesë dhe dy stalla bagëtish të cilat kanë qenë të ndërtuara në vitin 2007 dhe gjendja e tyre nuk ka ndryshuar deri në vitin 2013, vit në të cilin subjekti ka përpiluar deklaratën përpara fillimit të detyrës.

<sup>14</sup> Subjekti referon ortofotot e fotografimit ajror për vitin 2007.

<sup>15</sup> Subjekti referon ortofotot e fotografimit ajror për vitet 2013-2014-2015.

<sup>16</sup> Deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 23.10.202; deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 22.10.2021, notere E. D., (L.); ortofotot e viteve 2007, 2015, dhe foto ajrore (satelitore *Google Earth*) të viteve 2013, 2016; raport vlerësimi i datës 28.12.2019; relacion teknik nga eksperte L.B., të datës 9.4.2022.

- Sipërfaqja e deklaruar në DPFĐ-në e vitit 2013 prej 660 m<sup>2</sup>, është shumë e përafërt me sipërfaqen e tre objekteve sipas dokumenteve të legalizimit dhe akteve të regjistrimit: 457.72 m<sup>2</sup> sipërfaqja e dy kateve të objektit + 52.13 m<sup>2</sup> sipërfaqe e papafingos (që ka ekzistuar në këtë vit dhe u prish në vitin 2014) + 101.25 m<sup>2</sup> sipërfaqe e njëres stallë + 48.4 m<sup>2</sup> sipërfaqe e stallës tjetër = 659.5 m<sup>2</sup>.

- Në vitin 2014 është kryer rikonstrukcion i banesës, për shkak të disa punimeve të brendshme dhe të jashtme si: është prishur papafingoja, janë kryer punime për përfundimin e ndërtimit pasi kati i dytë i banesës deri në këtë vit ka qenë karabina<sup>17</sup>, është rikonstruktuar çatia, është shtuar një shkallë 5.71 m<sup>2</sup> dhe një nyje sanitare.

- Në DPV-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar “*rikonstrukcion i shtëpisë*”, fakt të cilin e ka deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*.

- Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar “*shtëpi banimi 460 m<sup>2</sup>, 2kt + papafingo*” me sip. 460 m<sup>2</sup>. Referuar fotografimit satelitor të vitit 2016 të paraqitur nga subjekti, ortofotos së vitit 2015 (datë 6.7.2017) dhe aktit të verifikimit në terren të datës 12.6.2017 sipas të cilit sipërfaqja e objektit 2-katësh pa papafingo është 457.72 m<sup>2</sup>, vërehet një diferencë e pakonsiderueshme në deklarimin e sipërfaqes në deklaratën *Vetting*, e cila duket se ka ardhur si pasojë e punimeve të kryera në vitin 2014.

- Sa i takon papafingos, në kushtet kur edhe organet kompetente si ALUIZNI dhe ASHK nuk e kanë kualifikuar si sipërfaqe ndërtimore banimi dhe as të regjistruar si pasuri më vete, vlerësohet se deklarimi i papafingos nga subjekti në deklaratën *Vetting*, para finalizimit të procedurave të legalizimit dhe regjistrimit, duket se është i logjikshëm dhe në harmoni me sqarimet dhe dokumentet e paraqitura gjatë procesit.

## **Sa i takon vlerës së ndërtimit/investimeve**

**24.8** Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit dhe dokumenteve shkresore<sup>18</sup>, konstatohet se:

- Në DPFĐ-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar vlerën 25.000.000 lekë.

- Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Sipas vlerës së tregut në total të gjitha objektet mendoj se kanë vlerën 25.000.000 lekë. Sipas situacionit të punimeve vlera totale e tyre është 17.953.001 lekë*”. Subjekti ka bashkëlidhur një situacion punimesh përpiluar nga shtetasi A. H.I.

- Gjatë procesit të rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti paraqiti një raport vlerësimi të ekspertes L.B., me datë 28.12.2019, në të cilin vlera e objekteve është në shumën 16.052.734 lekë deri në vitin 2014.

Pra, siç vërehet, në DPFĐ 2013 dhe deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar vlerën e tregut të objektit sipas këndvështrimit të tij, ndërsa në deklaraten *vetting* ka deklaruar vlerën e punimeve duke iu referuar një situacioni. Duke qenë se nuk u evidentuan dokumenta që vërtetojnë vlerën e punimeve në kohë reale të kryerjes së tyre, i pyetur në lidhje me mospërputhjet e vlerave, në përgjigje të pyetësorit 9 subjekti ka deklaruar se në preventivin e paraqitur prej tij në deklaratën *Vetting*, përgatitur nga eksperti H.I., zërat e punimeve kanë çmime fikse, ndërkohë që ato janë kryer në kohë të ndryshme dhe nuk është e mundur që çmimi të jetë i njëjtë. Për këtë shkak dhe natyrës teknike të çështjes, subjekti deklaroi se i ishte drejtuar një ekspert me njohuri të posaçme, dhe ka paraqitur aktin “*Relacion teknik mbi sqarimin e pyetësorit nr. 9*” të datës 22.2.2023 të hartuar nga ekspertja L.B. Bazuar në këtë akt, vlera e shpenzimeve në total për të

<sup>17</sup> Në kuptim të ligjit “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim” të vitit 1998, “*karabina*” do të konsiderohet objekti i ndërtuar plotësisht në volum dhe në formë, sipas kushteve urbanistike të miratuara për konstrukcionin dhe muraturën e plotë të objektit.

<sup>18</sup> Shihni dokumentin situacion punimesh të paraqitur në deklaratën *Vetting* dhe faqen 31 të raportit të vlerësimit të përgatitur në datën 28.12.2019 në përgjigje të pyetësorit nr. 2. Në raportin e vlerësimit janë pasqyruar dhe vlera e mobilimit në shumën 2.500.000 lekë.

gjithë objektin deri në vitin 2014 (duke përfshirë edhe këtë vit) ka rezultuar 16.052.734 lekë + 2.500.000 lekë mobilimi = 18.552.734 lekë.

**24.9** Me qëllim përcaktimin sa më afër realitetit të vlerës së investimeve, Komisioni iu referua:

- Periudhës së ndërtimit dhe investimeve, duke konsideruar se: (i) ndërtimi i tre objekteve ka përfunduar në vitin 2007 dhe deri në vitin 2013 nuk janë kryer investime, pra kostoja e ndërtimit e vitit 2007 është e njëjtë me vitin 2013<sup>19</sup>; (ii) në vitin 2014 janë kryer investime për rikonstruksionin e objektit dykatësh + papafingo.
- Sipërfaqeve ndërtimore, ku si të tilla për vitin 2013, duke mbajtur në konsideratë mospërputhjet e papërfillshme, janë konsideruar sipërfaqet e përcaktuara në raportin e vlerësimit të ekspertes L.B., të cilat janë të njëjta me sipërfaqet e dokumentacionit të legalizimit dhe regjistrimit të pasurisë (banesë + stallat e bagëtive), duke shtuar edhe sipërfaqen e papafingos.

**24.10** Nga ana e Komisionit u konstatua se përlllogaritjet e ekspertes vlerësuese L.B., në raportin me datë 28.12.2019 mbështetur edhe me relacion teknik të datës 22.2.2023, përputhen me vlerën e punimeve sipas çmimeve të EKB-së<sup>20</sup> dhe janë të përafërta edhe me vlerat e situacionit të punimeve përpiluar nga shtetasi A.H.I., paraqitur nga subjekti në deklaratën Vetting. Konkretisht kostoja e ndërtimit në vitin 2007 e cila është e pandryshuar edhe në vitin 2013, vit në të cilin subjekti ka përfunduar studimet dhe ka plotësuar DPFĐ-në, është në vlerën 15.833.070 lekë<sup>21</sup>. Ndërsa për vitin 2014 kur është kryer rikonstruksioni i banesës, vlera e punimeve është 6.065.175 lekë. Kësaj vlere i është shtuar si shpenzim 2.500.000 lekë për mobilimin. Në përfundim të hetimit administrativ, vlera e investimit në total për vitin 2014 është përlllogaritur 8.565.175 lekë.

### **Në lidhje me burimin e krijimit**

**25.** Komisioni analizoi burimet e investimit në pasurinë objekt verifikimi në vlerën 8.565.175 lekë në vitin 2014, i cili ka qenë viti i parë që subjekti ka qenë në detyrë.

**25.1** Sa i takon pjesës takuese të subjektit në këtë investim, gjatë hetimit administrativ u evidentuan faktet si vijojnë:

- Në DPV-në e vitit 2014 në rubrikën “*Shpenzime të deklarueshme*” subjekti ka deklaruar “*Rikonstruksion i shtëpisë së banimit në Tropojë në vlerën 2.100.000 lekë*”.
- Duke qenë se sipas raportit të vlerësimit të datës 28.12.2019 hartuar nga shtetasja L.B., paraqitur nga vetë subjekti gjatë procesit, e cila përputhet edhe me çmimet e EKB-së, rezulton se në vitin 2014 vlera e investimeve ka qenë 6.065.175 lekë dhe jo 2.100.000 lekë, është pyetur subjekti i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2 duke deklaruar se nuk ka dhënë kontribut në ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve, ka sqaruar se shuma 2.100.000 lekë e deklaruar në DPV-në e vitit 2014 përbën vetëm një pjesë të gjendjes së aktivitetit të familjes bujqësore, që i korrespondon pjesës ideale në pasurinë e përbashkët. Sipas tij, kjo shumë nuk është poseduar si e veçuar prej tij, por ka rënë dakord që pjesa e tij takuese në tërësi e painedividualizuar, së bashku me pjesën në tërësi të anëtarëve të tjerë krijuar gjatë periudhës 1993 – 2013, përpara

<sup>19</sup> Sa i takon kohës së investimit të ndërtesës 2 kate të deklaruar në DPFĐ-në e vitit 2013, nuk rezultoi asnjë dokument i kohës që të përcaktojë sipërfaqen ndërtimore sipas fotografimit të vitit 2007 apo më përpara, por, referuar informacionit të përcjellë nga ASIG-u dhe ASHK-ja, situata e paraqitur në këtë vit (2007) është e ngjashme me situatën e fotografimit satelitor 9/2013, pasqyruar edhe në konkluzionet raportit të vlerësimit të datës. 28.12.2019. E njëjta situatë paraqitet edhe për stallat, të cilat referuar shkresës së ALUIZNI-t Kukës nr. “\*\*\*” prot., datë 3.5.2018, në dosjen ILDKPKI, janë ndërtuar para vitit 2007.

<sup>20</sup> Shihni Udhëzimin nr. 2, datë 4.4.2007 [https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/udhzim\\_2\\_04.04.pdf](https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/udhzim_2_04.04.pdf). Kostoja e ndërtimit në këtë vit është 31 986 lekë/m<sup>2</sup>.

<sup>21</sup> Është zbritur 25% (20% e TVSH dhe 5% fitimi i planifikuar) i koston të ndërtimit pasi është deklaruar se punimet janë kryer prej tyre ose nga punëtorë të zonës. Ndërsa sipërfaqja totale e llogaritur për vitin 2007 është 660 m<sup>2</sup>.

fillimit të detyrës nga ana e tij, të përdoret nga familja bujqësore. Po kështu, në përgjigje të pyetësorit nr. 9 subjekti sqaroi se pavarësisht se ai personalisht nuk ka dhënë asnjë kontribut në ndërtimin e pasurisë objekt verifikimi, në DPV-në e vitit 2014 ka deklaruar vlerën 2.100.000 lekë si vlerë ideale e pjesës së tij takuese. Subjekti konfirmon se vlera e investimit të kryer në vitin 2014 është 6.065.175 lekë (rikonstruksioni) + 2.500.000 lekë (mobilimi) = 8.565.175 lekë. Përgjigjet e subjektit janë në të njëjtën linjë me përgjigjet në procesverbalin e pyetjes nga ILDKPKI-ja në vitin 2016, ku ai ka deklaruar se vlera 2.100.000 lekë i takon pjesës së tij takuese së bashku me vëllain në investimin për vitin 2014, me burim gjendjen *cash* prej 20.000.000 lekësh deklaruar në DPDFD-në e vitit 2013. Realisht kjo vlerë prej 2.100.000 lekësh përkon përafërsisht me ¼ pjesë të vlerës 8.565.175 lekë, investimi në total gjatë vitit 2014. Në përfundim të hetimit administrativ, deklarimi i shpenzimit prej 2.100.000 lekësh në DPV-në e vitit 2014, është konsideruar se i përket pjesës takuese të subjektit.

- Në DPV-në e viteve 2015 dhe 2016, nuk janë deklaruar të jenë kryer investime dhe nga faktet nuk rezulton të jenë kryer ndryshime në sipërfaqe dhe në lartësi.

**25.2** Sa i takon burimit të të ardhurave në investim, rezultoi se:

- Në DPDFD 2013 subjekti nuk ka deklaruar burim.

- Sipas procesverbalit në ILDKPKI datë 31.3.2016, subjekti ka deklaruar se të gjitha pasuritë e deklaruara nga ana e tij, janë krijuar ndër vite me kontributin e të gjithë familjes me të ardhurat e siguruar nga: (i) blegtoria dhe bujqësia; (ii) kontributi i vëllait A., nga të ardhurat kur ka jetuar në Zvicër. Subjekti ka përmendur në këtë procesverbal edhe një kredi të marrë në vitin 2014 në shumën 1.000.000 lekë për rikonstruksionin e stallave (kjo kredi e cila është trajtuar në vijim në paragrafin 36.2 është shlyer brenda po këtij viti duke mos u përdorur si burim).

- Në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar burimin e pasurisë, por, ka dhënë sqarime në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për rikonstruksionin e bërë në vitin 2014, duke deklaruar të njëjtin burim si në procesverbalin pranë ILDKPKI-së në vitin 2016: të ardhura të deklaruara në DPDFD-në e vitit 2013 (likuiditeti *cash* prej 20.000.000 lekësh) të akumuluar ndër vite nga anëtarët e familjes si dhe nga të ardhurat e fermës.

- I pyetur gjatë procesit mbi burimin e krijimit të gjendjes *cash* të deklaruar në DPDFD-në e vitit 2013 prej 20.000.000 lekësh, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 subjekti sqaroi se kjo shumë është krijuar gjatë periudhës 1993 – 2013 me burim: (i) të ardhurat e fermës që konsistojnë rreth vlerës 56.928.776 lekë si pasojë e aktivitetit bujqësor e blegtoral; (ii) të ardhurat nga pagat dhe pensionet e anëtarëve të familjes bujqësore<sup>22</sup>.

**25.3** Bazuar në më sipër, rezulton se si burim krijimi i pasurisë objekt verifikimi, banesë + dy stalla bagëtish në fshatin “\*\*\*\*” në Tropojë, përfshirë edhe rikonstruksionin e vitit 2014, kanë shërbyer: (i) të ardhurat nga blegtoria/ferma; (ii) të ardhurat nga pagat dhe pensionet e anëtarëve të familjes (subjekti është shkëputur nga trungu familjar në datën 30.4.2013); (iii) të ardhura nga emigracioni i vëllait.

## **Analizë e secilit prej burimeve**

### **26. Të ardhura nga ferma**

Në lidhje me të ardhurat nga ferma, nga aktet në dosje rezultoi se<sup>23</sup>:

**26.1** Sipas ZGjC “\*\*\*\*” të datës 15.5.2017, vërtetohet se familja e shtetasit N.P., është vendosur në fshatin “\*\*\*\*”, datë 13.5.1993.

**26.2** Disponohen tre AMTP, dy në emër të babait dhe një në emër të vëllait të subjektit me sip. 23.300 m<sup>2</sup> pemëtore + 300 m<sup>2</sup> truall. Duke qenë se regjistrimi i këtyre AMTP-ve nuk ishte

<sup>22</sup> Depozituar vërtetimet e pagave ndër vite të shtetasve B.J., (Pjetërnikaj), A.P., R.P., si dhe pensionet e prindërve N.P., dhe L.P.

<sup>23</sup> Shihni aneks 4/2 në dosjen ILDKPKI dhe dokumentat bashkëlidhur pyetësorëve.

konfirmuar nga ASHK ZV Tropojë, u kërkua nga subjekti informacion i mëtejshëm. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 9, subjekti informoi se regjistrimi i këtyre AMTP-ve, me gjithë përpjekjet e vazhdueshme, është bërë i mundur të realizohet vetëm pas 30 vitesh nga marrja e tyre, dhe në datën 30.6.2021 janë lëshuar certifikatat “Për vërtetim pronësie” nga ASHK Tropojë në emër të babait të tij, të ndjerit N.P., dhe vëllait të tij A.P., përkatësisht si vijojnë: (i) sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. “\*\*\*\*”, datë 30.6.2021, është regjistruar AMTP me sip. 8000 m<sup>2</sup> si pasuria nr. “\*\*\*\*”, z. k. “\*\*\*\*”, e llojit “pemëtore” me sip. 8.000 m<sup>2</sup>; (ii) sipas certifikatave për vërtetim pronësie nr. “\*\*\*\*”, datë 30.6.2021 dhe nr. “\*\*\*\*”, datë 30.6.2021 është regjistruar AMTP me sip. 15.600 m<sup>2</sup> (15.300 m<sup>2</sup> pemëtore dhe 300 m<sup>2</sup> truall) e fraksionuar në dy pasuri, pasuria nr. “\*\*\*\*” e llojit “pemëtore” me sip. 9380 m<sup>2</sup> dhe pasuria nr. “\*\*\*\*” e llojit “pemëtore” me sip. 6220 m<sup>2</sup>, të dyja z. k. “\*\*\*\*”; (iii) sipas certifikatës për vërtetim pronësie me nr. “\*\*\*\*”, datë 30.6.2021, në emër të vëllait A.P., është regjistruar AMTP me sip. 5100 m<sup>2</sup> si pasuria nr. “\*\*\*\*”, z. k. “\*\*\*\*” e llojit “pemëtore” me sip. 5.100 m<sup>2</sup>. Subjekti ka paraqitur katër certifikatat e pronësisë dhe kartelat përkatëse.

**26.3** Sipas vërtetimit të lëshuar nga Bashkia Tropojë me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 20.1.2016, konfirmohet se A.P., (vëllai i subjektit), ka paguar taksën e tokës bujqësore vetëm për vitin 2016. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se sipas deklaramëve të vëllait të tij A.P., ky ka përmbushur detyrimet për pagimin e pagesës së taksës së tokës dhe të sigurimeve si i vetëpunësuar në bujqësi-blegtori. Sipas tij, nëse nuk do të ishin paguar taksa e tokës bujqësore dhe derdhja e kontributeve shoqërore nuk do të ishin përfshirë në skemën e subvencioneve të AZHBR-së. Subjekti ka provuar me dokumentacion që familjarët e tij kanë përfituar subvencion pas vitit 2012 e në vijim.

**26.4** Subjektit iu kërkua në vijim të procesit të provojë me dokumente pagesën e taksës së tokës për të gjithë periudhën 1993 – 2013 e më pas deri në deklaratën *Vetting*. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 9 subjekti ka deklaruar se për vitet 1993 – 2015 ka qenë e pamundur pagesa e taksës bujqësore, për shkak të mosveprimit të institucioneve shtetërore, konkretisht Këshillit dhe Kryetarit të Komunës “\*\*\*\*”, të cilët kishin pasur detyrimin ligjor për të vendosur llojin dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore, problematikë kjo e evidentuar sipas tij edhe nga KLSH-ja. Ndërsa pas miratimit të vendimeve përkatëse nga Këshilli i Bashkisë Tropojë të vitit 2015, vëllezërit e tij e kanë shlyer këtë detyrim. Për të mbështetur pretendimet e tij subjekti ka paraqitur dokumentet si vijojnë: (i) shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 22.2.2023 nga Bashkia Tropojë sipas së cilës, ndër të tjera informohet se Këshilli i Komunës “\*\*\*\*” gjatë viteve 1993 – 2013 nuk ka miratuar dhe vendosur taksa vendore, dhe as taksën e tokës bujqësore, e për rrjedhojë ky detyrim nuk i është mbledhur askujt. Arsyet e kësaj vendimmarrjeje janë për shkak të kategorizimit të tokës dhe nivelit të jetesës së zonës në tërësi; (ii) shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 6.10.2017 i KLSH-së ku përcillet raporti i auditimit në Bashkinë Tropojë dhe 7 ish komunat, ndër to dhe ajo “\*\*\*\*”, sipas të cilit nuk ka të dhëna e dokumentacion për taksapaguesit familjarë për taksën e tokës bujqësore, sa duhet të paguajnë dhe sa kanë paguar në fakt, dhe nuk është nxjerrë njoftim vlerësimi për taksapaguesit familjarë të tokës bujqësore në kundërshtim me ligjin “Për sistemin e taksave vendore” ; (iii) vërtetim nr. “\*\*\*\*” prot., datë 23.2.2023 të Bashkisë Tropojë sipas të cilit vërtetohet se subjekti A., N., P., ka paguar taksat dhe tarifat familjare për vitin 2023, dhe se nuk ka asnjë detyrim të papaguar; (iv) vërtetim nr. “\*\*\*\*” prot., datë 20.2.2023 sipas të cilit vërtetohet se N.P., (i vdekur) ka paguar taksën mbi tokën bujqësore pranë “Raiffeisen Bank” në datën 21.12.2018 + akt bankar për derdhjen e shumës nga A. P.; (v) vërtetim nr. “\*\*\*\*” prot., datë 20.2.2023 sipas të cilit vërtetohet se A.P., ka paguar taksën mbi tokën bujqësore në vitet 2016 dhe 2018 + mandatet përkatëse; vendim nr. “\*\*\*\*”, datë 15.8.2015 i Këshillit Bashkiak, Bashkia Tropojë për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore në rrethin e Tropojës.

**26.5** I pyetur në lidhje me pagesën e sigurimeve si të vetëpunësuar në bujqësi, subjekti ka informuar<sup>24</sup> se prindërit e tij janë trajtuar me pension pleqërie, kunatat e tij kanë qenë të punësuar në arsim e po ashtu edhe vëllezërit, dhe se, për periudhën 1993 – 2004 vetëm motra e tij V.P., ka paguar sigurimet shoqërore si e vetëpunësuar në bujqësi, pasi nuk ishte e punësuar. Në vijim vëllai A.P., kur nuk ka qenë i punësuar ka paguar sigurimet shoqërore si i vetëpunësuar për vitet 2011 – 2021. Për të mbështetur deklaratimet e tij subjekti ka paraqitur: vërtetim nr. “\*\*\*\*” prot., datë 17.2.2023, nga ISSH Tropojë sipas të cilit vërtetohet se A. P., është banor i fshatit “\*\*\*\*”; ka tokë në pronësi që nga viti 1991; është i vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 2011 dhe ka derdhur kontributet 2011 – 2016; vërtetim datë 20.2.2023 nga ISSH Tropojë sipas të cilit V.P., rezulton e siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 1993, dhe ka derdhur kontribute për periudhën 1993 – 2004.

**26.6** AZHBR-ja ka konfirmuar se A.P., ka përfituar subvencione në vitet 2012, 2013, 2015 e në vijim për skemën “tufë bazë-dele dhi” ku për vitin 2013 edhe për bletari. Nuk janë konfirmuar subvencione për vitin 2014.

**26.7** Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Shkodër<sup>25</sup>, ka informuar se: (i) për vitet 1990 – 2009 nuk disponojnë regjistër të fermave bujqësore (sistemi RUDA); (ii) bazuar në informacionin e marrë nga veterinerët e zonës familja N.P., ka nisur aktivitetin me bagëti që prej vitit 1992 – 1993; (iii) për vitet 2007 – 2020 ka përcjellë fitimin neto të familjes bujqësore N. Q. P., dhe kafshët e regjistruara në sistemin “Ruda<sup>26</sup>” prej vitit 2008.

**26.8** Në akt ekspertimin datë 30.12.2019, mbi llogaritjen e të ardhurave nga ferma, blegtorale dhe bletaria, përgatitur nga eksperte L.B., janë përcaktuar të ardhurat, fitimi *neto*, si dhe shpenzimet për periudhën 1993 – 2019. Sipas këtij raporti tatimet nuk janë marrë parasysh pasi sipas ligjit fermerët janë të përjashtuar nga tatimi, përveç taksës së tokës, e cila është e ulët dhe është përfshirë brenda shpenzimeve vetjake. Më tej, sipas raportit, të ardhurat *neto* për periudhën 1993 – 2013, rezultojnë në vlerën 56.928.776 lekë ndërsa të ardhurat *neto* për vitin 2014, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për rikonstruksionin e banesës në vitin 2014 rezultojnë në vlerën 4.421.893 lekë.

**26.9** I pyetur mbi produktet e shitura, mënyrën se si janë realizuar shitjet duke paraqitur kontrata, fatura apo çdo dokument tjetër që provon fitimin e të ardhurave nga ferma, në përgjigjet e pyetësorit nr. 8 subjekti ka informuar se produktet e prodhuara nga ferma kanë qenë mishi i qengjit, derri, vicit, pulave, qumështi dhe nënproduktet e tij (djathi, gjalpi dhe kosi), vezët, mjalti dhe qumështi i bletës. Sipas tij, në vitet 1993 – 2005 shitja e produkteve bëhej në pazarin e Tropojës, tregtarëve që vinin nga qytete të tjera apo edhe grupeve të familjeve me të cilat kanë pasur marrëdhënie fisnore, ku u ngritën dhe ushtruan aktivitetin shumë bujtina, bar – restorante apo forma të tjera të aktivitetit agro - turizëm. Për shkak të infrastrukturës, mjedisit, traditës së zonës, etj., shitja e produkteve nuk është bërë kundrejt faturave tatimore. Më tej, subjekti ka sqaruar se në kuadër të këtij aktiviteti, vëllezërit e tij kanë mbajtur shënime, dokumente private në të cilat jepen të dhëna për blerësit, emër, mbiemër, vlerën, masën dhe çmimin e shitjes. Për të mbështetur pretendimet e tij subjekti ka paraqitur:

- deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 21.4.2022, të shtetas L.S., e cila deklaron se për nevoja të aktivitetit të saj bujtinë në Valbonë, Tropojë, ka blerë që prej vitit 2009 nga shtetasit A., dhe A.P., prodhime blegtorale dhe bujqësore, duke dhënë specifikime sipas llojit të produktit mbi peshën dhe çmimin + ekstrakt QKB i PF L.S., + dy foto të bujtinave;

<sup>24</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 9 dhe dokumentacionin bashkëngjitur në dosjen e Komisionit.

<sup>25</sup> Shihni shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 2.11.2021 dhe shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 19.4.2022, të Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Shkodër, në dosjen e Komisionit.

<sup>26</sup> “Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale” sipas VKM-së nr. 320, datë 19.3.2008.

- deklaratë e thjeshtë e shtetasit B.J., në të cilën ai deklaron blerjen e produkteve blegtorale e bujqësore nga shtetasit A.P., dhe A.P., për nevoja të aktivitetit të tij bujtinë, që prej vitit 2007, duke specifikuar sipas produktit peshën dhe çmimin. Bashkëngjitur deklaratës gjendet tabelë e thjeshtë e llogaritjes së shpenzimeve sipas zërave nga biznesi paguar familjes Pjetërnikaj + pasqyra financiare + ekstrakt i QKB + foto *Google Earth* të bujtinës;

- shënime të mbajtura me shkrim dore të familjes Pjetërnikaj që bëjnë fjalë për shitje produktesh të ndryshme bujqësore dhe blegtorale ndër vite, nga të cilat arrihet të kuptohet se shitja e produkteve të fermës është kryer në banorë të zonës, individë sporadikë të rajonit apo edhe të afërm të familjes bujqësore.

**26.10** Përveç sa më sipër, subjekti ka informuar se familja e tij ka siguruar edhe prodhime bujqësore si grurë, misër, fasule, patate, specat, domate, pemë frutore si rrush, arra, mollë etj. Sipas tij gruri, misri, kashta janë përdorur si ushqim për bagëtinë, ndërsa produktet e tjera, përfshi edhe rakinë, përveç konsumit familjar janë tregtuar, pavarësisht se të ardhurat nuk kanë qenë të konsiderueshme.

**26.11** Nga analiza e dokumentacionit sa më sipër, konstatohet se:

- Në lidhje me ekzistencën e pasurisë së familjes Pjetërnikaj, është provuar fakti se familja ka në pronësi tokë bujqësore përfituar me AMTP përfituar nga babai dhe vëllai i subjektit, e regjistruar në ASHK Tropojë, dhe se kjo familje jeton në fshatin "\*\*\*\*" që prej vitit 1993; nuk është paguar taksa e tokës bujqësore për periudhën 1993 – 2015 për shkak të mosveprimit të organeve vendore përgjegjëse që kishin detyrimin ligjor për të vendosur llojin dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore.

- Në lidhje me provueshmërinë e ushtrimit të aktivitetit blegtoral dhe bujqësor është konfirmuar se: (a) vëllai i subjektit A.P., ushtron aktivitetin si fermer që nga viti 1993 deri aktualisht në fushën e blegtorisë dhe mbarështron gjedh, dele, shpend, derra dhe bletë, dhe që prej vitit 2015 është regjistruar edhe me NIPT "\*\*\*\*"; (b) ai është i vetëpunësuar në bujqësi që prej vitit 2011 dhe ka paguar kontributet përkatëse; (c) motra e subjektit V.P., është e vetëpunësuar në bujqësi që prej vitit 1993 dhe ka paguar kontributet përkatëse deri në vitin 2004; (d) janë përfituar subvencione nga AZHBR-ja në vitet 2012, 2013, 2015 e në vijim, por jo për vitin 2014; (e) kafshët e fermës së familjes Pjetërnikaj janë regjistruar në sistemin Ruda që prej vitit 2010. Pra, konstatohen mjaftueshëm të dhëna dhe fakte që dëshmojnë ekzistencën e ushtrimit të aktivitetit blegtoral e bujqësor.

- Në lidhje me legjitimitetin e të ardhurave të krijuara nga aktiviteti i familjes përpara vitit 2013, u vërtetua që mospagimi i taksës së tokës nuk është për faj të pronareve të saj. Po kështu, është fakt që vetëm pas vitit 2014, në legjislacion u përfshi skema e rimbursimit të TVSH-së për fermerin, nëpërmjet së cilës fermerët kërkonin rimbursim të TVSH-së duke deklaruar të ardhurat nga shitjet e tyre. Në këto kushte, mungojnë të dhënat për masën e të ardhurave nga aktiviteti blegtoral e bujqësor. Ndërkohë, Komisioni ka administruar shkresën e Agjencisë Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Shkodër, e cila ka përcjellë një tabelë mbi fitimin *neto* për vitet 2007 – 2020 të familjes bujqësore. Nga një përlllogaritje rezulton se të ardhurat 2008 – 2013 sipas kësaj shkrese, janë në vlerën 23.558.371 lekë. Nisur nga fakti se ky informacion është bazuar në të dhëna statistikore, në përfundim të hetimit administrativ, mbetet e pavërtetuar masa faktike e të ardhurave nga ferma, e për këtë arsye, në përfundim të hetimit administrativ nuk janë përlllogaritur të ardhurat nga ferma të deklaruara si likuiditet *cash* në vlerën 20.000.000 lekë në DPFD-në e vitit 2013.

## **27. Të ardhurat nga pagat, pensionet e prinderve dhe nga emigracioni i vëllait**

**27.1** Sa i takon të ardhurave nga pagat e anëtarëve të familjes bujqësore janë konsideruar vetëm të ardhurat e provuara me shkresat e ISSH-së, të cilat janë përcjellë nga subjekti me pyetësonin nr. 2, informacioni i të cilave përfshin periudhën 1995 e në vijim për shtetasit znj. B.J.,



(Pjetërnikaj) dhe znj. R.P., për z. A.P., nga viti 1997 deri në vitin 2007 dhe pensionet e prindërve të subjektit të rivlerësimit prej vitit 1998.

**27.2** Pavarësisht se në deklaratimet e tij, subjekti pretendonte edhe të ardhura të vëllait nga emigracioni, gjatë procesit të rivlerësimit ai nuk provoi me dokumentacion këto të ardhura, për të cilat në përgjigje të pyetësorit nr. 4 ka deklaruar se nuk disponon dokumentacion.

### Analiza financiare

**28.** Pavarësisht se Komisioni hetoi mbi familjen bujqësore/prindërore të subjektit të rivlerësimit gjatë gjithë periudhës së ndërtimit të objektit, në përfundim të hetimit administrativ nëpërmjet njësisë së shërbimit ligjor, kreu analizën financiare nga janari i vitit 2008 deri në datën e emërimit në detyrë (nëntor 2013) kur subjekti ka deklaruar likuiditetin *cash* në vlerën 20.000.000 lekë, referuar faktit që deri në vitin 2007 subjekti në pjesën më të madhe të kohës ka qenë i mitur (në vitin 2005 ka mbushur 18 vjeç), ndërkohë që në vitin 2007 kur ka qenë 20 vjeç, provohet se ka qenë në qytetin e Tiranës duke ndjekur studimet e larta. Në këto kushte, investimet e kryera para vitit 2007 (kujtojmë që gjendja e objektit në vitin 2013 ka qenë e njëjtë me atë të vitit 2007), është vlerësuar se nuk kanë asnjë vlerë për efekt të procesit të rivlerësimit të subjektit Ylli Pjetërnikaj.

**28.1** Në analizën financiare përmbledhur në tabelën më poshtë në të cilën nuk janë përfshirë të ardhurat nga ferma, është analizuar mundësia e familjes së subjektit për të krijuar likuiditetin prej 20.000.000 lekësh, deklaruar në DPDFD-në e vitit 2013, nga e cila duket se mundësia për kursime është në vlerën 137.232 lekë.

Viti	2008 – 2013
Të ardhurat nga ferma	0
Të ardhura nga pensioni i L. P.	916 623 lekë
Të ardhura nga pensioni i N.P.	455 381 lekë
Të ardhura B.P.	3 205 161 lekë
Të ardhura R.P.	1 903 352 lekë
Të ardhura nga subvencionet për A.P.	45 000 lekë
Dhurim nga Ylli Pjetërnikaj për A.P. (transaksion në RFZ)	1 080 000 lekë
<b>TË ARDHURAT NË TOTAL</b>	<b>7 605 517 lekë</b>
Lukuiditetet në bankë	257 855 lekë
<b>PASURITË NË TOTAL</b>	<b>257 855 lekë</b>
Blerja e pasurisë livadh sip. 1,000 m <sup>2</sup> në “****”	300 000 lekë
Blerja e automjetit tip “Peugeot” 307 më 7.12.2012	558 880 lekë
Shpenzimet jetike	5 424 551 lekë
Transferta parash nga A.P., për Ylli Pjetërnikaj (transaksion në RFZ)	12 000 lekë
Transferta parash nga A. P., për Ylli Pjetërnikaj (transaksion në RFZ)	915 000 lekë
<b>SHPENZIMET NË TOTAL</b>	<b>7 210 431 lekë</b>
<b>REZULTATI FINANCIAR (Mundësia për të kursyer)</b>	<b>137 232 lekë</b>

**28.2** Sa i takon shpenzimeve jetike ato janë llogaritur sipas numrit të anëtarëve të familjes bujqësore të rezultuara nga certifikatat e gjendjes civile deklaruar nga subjekti gjatë periudhës 2008 – 2013. Nisur nga fakti se familja bujqësore prindërore e subjektit të rivlerësimit jeton në zonë rurale (fshati “\*\*\*\*”, Komuna “\*\*\*\*”), shpenzimeve jetike u është zbritur zëri i grupit “ushqime dhe pije joalkoolike” referuar anketës<sup>27</sup> së buxhetit të familjes sipas referencave të INSTAT-it. Kjo zbritje bëhet pasi është e provuar se vendbanimi i familjes ndodhet në fshat dhe anëtarët e familjes bujqësore janë marrë me aktivitete të mbarështimit të bagëtive dhe nxjerrjes së produkteve të tyre që ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në uljen e zërit të

<sup>27</sup> <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes/#tab3>

shpenzimeve jetike, te cilat nuk mund të jenë në të njëjtin nivel sa shpenzimet jetike në zonat urbane.

Në mënyrë të detajuar shpenzimet jetike dhe llogaritja e tyre është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Shpenzime jetike	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Numri i anëtareve të familjes	14	14	12	11	11	13
Shpenzimet jetike sipas INSTAT	136 620 Lekë	136 620 Lekë	136 620 Lekë	136 620 Lekë	141 024 Lekë	141 024 Lekë
% e nëngrupit "ushqime dhe pije jo-alkoolike" (INSTAT)	47,6%	47,6%	47,6%	47,6%	47,6%	47,6%
Shpenzimet jetike të llogaritura	1 002 244 Lekë	1 002 244 Lekë	859 067 Lekë	787 478 Lekë	812 862 Lekë	960 655 Lekë

**28.3** Gjithashtu, në këtë analizë është konsideruar si shpenzim pagesa e pasurisë “tokë livadh me sip. 1.000 m<sup>2</sup> në fshatin “\*\*\*\*” në vlerën 300.000 lekë” në vitin 2010 nga babai i subjektit të rivlerësimit (trajtuar në vijim në paragrafin 30.8).

**29.** Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, në lidhje me pasurinë objekt verifikimi, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës, ku duket se:

- në DPDFD-në e vitit 2013 subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë banesë në fshatin “\*\*\*\*” Tropojë, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar burimin e krijimit vetëm në lidhje me investimet në vitin 2014;

- nuk vërtetohet me të ardhura të ligjshme burimi i krijimit të investimit të kryer në vitin 2014 në shumën 8.565.175 lekë nga likuiditeti *cash* i deklaruar në shumën 20.000.000 lekë, shumë e cila nuk është konsideruar si e ardhur e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës e, për pasojë, nuk vërtetohet burimi i investimit të pjesës takuese të subjektit (2.100.000 lekë)<sup>28</sup>;

Po me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime e dokumente në lidhje me përdorimin ndër vite dhe përdorimin aktual të banesës.

### Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Në parashtrimet e tij, subjekti ka dhënë sqarime të hollësishme për secilin prej konstatimeve të Komisionit, përmbledhur si vijon:

**29.1** Në lidhje me mosdeklarimin e burimit të pasurisë deklaratën e parë, atë të vitit 2013 si dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti e ka kundërshtuar këtë konstatim duke parasshtuar se si burim krijimi të pasurisë ka deklaruar trashëgiminë, sepse pasuritë ishin krijuar nga babai, i cili ka vdekur në vitin 2010. E gjithë pasuria që zotëronin familjarët e subjektit deri në atë moment ishte krijuar kryesisht nga puna e babait dhe nënës (vdekur në gusht 2020), të cilët kanë kontributin kryesor në ndërtimin e banesës, stallave të bagëtive, si dhe kanë krijuar fermën nga fillimi i aktivitetit të saj, e në vijim duke e zgjeruar. Babai i tyre ka qenë administruesi i familjes bujqësore. Pas vdekjes së tij aktiviteti i fermës dhe pasuritë e tjera janë administruar nga vëllezërit A., dhe A. P., si dhe familjarët e tjerë. Sipas subjektit, trashëgimia si burim krijimi është deklaruar për banesën, stallet, tokën arë, krrerët e deleve, koshereve të bletëve, krrerët e lopëve, gëlqeren, ndërsa për vlerën *cash* si burim janë deklaruar të ardhurat e krijuara nga puna dhe ferma. Në vijim, subjekti thekson se edhe në deklaratën *Vetting* si burim ka deklaruar “*prindërit dhe familjarët e tjerë*”, i cili përfshin edhe trashëgiminë për shkak se babai kishte vdekur, ndërsa për investimet e vitit 2014 ka deklaruar: “*...dua të sqaroj se për rikonstruksionin e vitit 2014 e sipërcituar janë përdorur të ardhura nga ato të deklaruara pranë ILDKPKI-së në vitin 2013, të akumuluar ndër vite nga anëtarët e familjes, si dhe nga të ardhurat e fermës...*”. Sipas subjektit, qëllimi i bërjes së këtij dallimi, ka qenë evidentimi i

<sup>28</sup> Shuma prej 2.100.000 lekësh është konsideruar si shpenzim i subjektit në analizën financiare të vitit 2014.

saktë i burimit të ndryshimeve të pasurisë në vitin 2014, krahasuar me atë çfarë ka qenë e ndërtuar më herët.

**29.2** Në përfundim të procesit, pretendimet e subjektit vlerësohen bindëse, pasi nga verifikimi i deklaratës së vitit 2013 konstatohet se subjekti ka deklaruar *shtëpi banimi, e trashëguar qyteti Tropojë*. Po kështu, në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i pasurisë” të deklaratës *Vetting* ka deklaruar se shtëpia e banimit është ndërtuar në vitin 1990 nga prindërit si dhe familjarët e tjerë. Në kushtet kur banesa objekt verifikimi nuk është pasuri e subjektit por pasuri e familjes prindërore, kryefamiljari i të cilës (babai i subjektit) ka vdekur në vitin 2010, deklaramet në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë nuk mund të konsiderohen të pasakta. Ndërkohë, sikurse me të drejtë subjekti argumenton, në deklaratën *Vetting* ai ka deklaruar burimin e krijimit të investimit në vitin 2014 kur është rikonstruktuar banesa, me të ardhurat nga ferma të deklaruara si likuiditet *cash* në DPFDF-në e vitit 2013. Për më tepër, në vlerësim të të gjitha deklarameteve të subjektit para dhe gjatë procesit të rivlerësimit, konstatohet se subjekti ka qenë konsistent në lidhje me deklaramin e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për investimin në objekt dhe jo vetëm, me të ardhurat nga ferma.

**29.3** Në lidhje me konstatimin për mosprovueshmërinë e të ardhurave nga ferma të cilat janë burim i krijimit të shumës *cash* 20.000.000 lekë, përgjithësisht subjekti ka dhënë të njëjtat sqarime sikurse gjatë procesit të rivlerësimit, duke u fokusuar në faktet se në vitet 1993 – 2005 shitja e produkteve bëhej duke i tregtuar në pazarin e Tropojës duke ua shitur banorëve të tjerë të fshatit, apo zonave përreth, subjekteve tregtare, etj. Lidhur me shitjet dhe blerjet faktike, subjekti bën me dije se ka komunikuar me vëllezërit A., dhe A., (A.) Pjetërnikaj të cilët e kanë informuar se kanë mbajtur blloqe faturash që vërtetojnë shitjet e produkteve të fermës që nga viti 1996. Po kështu, ata kishin edhe bllokun e likuidimeve të shkruara nga babai i tyre N. P., dhe më tej, nga kunata, B.P., e cila merret me këtë proces. Në këto shënime, sipas subjektit, janë pasqyruar të gjitha shitjet e produkteve të fermës, në vitet e përcaktuara. Më tej, subjekti ka informuar se të gjitha këto shënime, blloqe faturash, mandatpagesash ia ka vënë në dispozicion ekspertës L.B., e cila ka bërë përlllogaritjet, si dhe ka përgatitur një relacion “*Sqarim mbi faturat e shitjes reale të bëra nga ferma e familjes Pjetërnikaj, kjo në bazë të faturave të bëra nga kjo familje për shitjen e tyre*” përcjellë bashkëlidhur prapësimeve të tij. Sipas raportit të ekspertës rezulton se për vitet 2008 – 2013 shuma e shitjeve të produkteve të fermës ka rezultuar në total të ardhurash në vlerën 21.832.180 lekë, dhe se, nga kjo shumë familja bujqësore ka arritur të kursejë shumën 20.000.000 lekë të deklaruara në vitin 2013 në DPFDF. Bashkëlidhur subjekti ka paraqitur gjithashtu: (i) deklaratë noteriale të z. A.P., i cili konfirmon deklaramet e subjektit; (ii) 420 mandate të thjeshta pagesash (fletë hyrje, fletë dalje, shënime dore të mbajtura në blloqe të thjeshta, urdhërpagesa, urdhër shpenzimi, bllok shënimesh dore për shpenzimet e fermës), 4 fatura elektronike me kod identifikues të vitit 2022 për fermerin A.P., dhe 96 mandatarkëtime të firmosura nga shtetasit K.Gj., K.J., H. S., H. M., M.L., të cilat janë nga viti 2008 deri në vitin 2022.

**29.4** Në analizë të parashtrimeve të subjektit, Komisioni çmon se pavarësisht faktit se dokumentet shkresore të paraqitura gjatë procesit dhe në parashtrime dëshmojnë për përfitim të ardhurash nga shitja e produkteve bujqësore e blegtorale nga ana e familjes Pjetërnikaj, ato nuk vërtetojnë të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës për periudhën 2008 – 2013, periudhë kur subjekti nuk ka qenë në detyrë. Vlerësimi përfundimtar në lidhje me balancën negative të vitit 2014 kur është kryer investimi prej 2.100.000 lekësh nga ana e subjektit, është trajtuar hollësisht në paragrafin 45 të këtij vendimi.

**29.5** Në lidhje me përdorimin e banesës objekt verifikimi në Tropojë, subjekti ka sqaruar se ajo është përdorur vetëm për banim nga familjarët e tij (20 persona) përgjatë gjithë viteve duke dhënë deklaramet të detajuara në lidhje me këtë fakt. Për të mbështetur këto fakte subjekti ka paraqitur: vërtetim nr. “\*\*\*\*”, datë 13.4.2023 të Njësisë Administrative “\*\*\*\*” sipas të cilit

vërtetohet se banesa e familjes Pjetërnikaj përdoret vetëm për banim dhe jo ndonjë aktivitet tjetër, si dhe, detaje të pagesave për përdorimin e energjisë elektrike të dy kontratave të furnizimit me energji elektrike të familjes Pjetërnikaj.

**30.** Pasuria Tokë arë e përfituar sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi, me sip. 24 dynym e 690 m<sup>2</sup>, Bashkia Tropojë, fshati "\*\*\*\*", Njësia Administrative "\*\*\*\*". Pjesa takuese: 30%. ILDKPKI-ja, në lidhje me këtë pasuri, ka konstatuar se sipas dokumentacionit të paraqitur rezultoi se janë 20.400 m<sup>2</sup> pemëtore në emër të babait të subjektit, shtetasit N.P., dhe 8.000 m<sup>2</sup> pemëtore në emër të vëllait të subjektit, shtetasit A. P. Nuk është i qartë deklarimi i pjesës takuese nga subjekti prej 30% në tokën arë (pemëtore) me sip. 24 dynym e 690 m<sup>2</sup>, të përfituar sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, në emër të babait dhe vëllait.

### **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

**30.1** Në lidhje me mënyrën e krijimit, deklarimet e subjektit dhe statusin juridik aktual të kësaj pasurie rezultoi se<sup>29</sup>:

- me AMTP-në datë 3.6.1995, Tropojë, fshati "\*\*\*\*", N.Q.P., ka përfituar 8000 m<sup>2</sup> pemëtore;
- me AMTP-në datë 25.9.1995, Tropojë, fshati "\*\*\*\*", N.Q.P., ka përfituar 15300 m<sup>2</sup> pemëtore dhe 300 m<sup>2</sup> truall;
- me AMTP-në datë 20.6.1995, Tropojë, fshati "\*\*\*\*", A.N. P., (vëllai i subjektit), ka përfituar 5100 m<sup>2</sup> pemëtore;
- nga verifikimi i deklarimeve të subjektit konstatohet se: në DPFD-në e vitit 2013, është deklaruar kjo pasuri me pjesë takuese 30%, në të gjitha deklarimet vijuese nuk janë deklaruar ndryshime, shtesa apo pakësime;
- ASHK/Zyra Vendore Tropojë nuk ka konfirmuar që këto pasuri janë regjistruar në emër babait të subjektit ose të trashëgimtarëve të tij. Pas kërkesës së Komisionit, subjekti informoi se<sup>30</sup> në datën 30.6.2021 për këto AMTP janë lëshuar certifikatat për vërtetim pronësie në emër të babait dhe vëllait të tij, duke u regjistruar si pasuri në kartelat përkatëse.

**30.2** Nga sa më sipër, rezultoi se: (i) dy AMTP janë në emër të babait të tij dhe një në emër të vëllait A.P., i cili sipas certifikatës së gjendjes familjare të datës 1.8.1991<sup>31</sup>, ka qenë pjesë e familjes bujqësore me kryefamiljar babain N.P., e megjithatë ka përfituar tokë me AMTP më vete; (ii) sipërfaqja e përfituar me AMTP nga babai i subjektit është 23.300 m<sup>2</sup> pemëtore + 300 m<sup>2</sup> truall, ndërsa sipërfaqja e përfituar nga vëllai i subjektit A.P., është 5.100 m<sup>2</sup> pemëtore; (iii) sipërfaqja në total është 28.400 m<sup>2</sup> pemëtore + 300 m<sup>2</sup> truall, ndërkohë që subjekti ka deklaruar sipërfaqe 24 dynym e 690 m<sup>2</sup> tokë arë.

**30.3** I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi mospërputhjen e sipërfaqes së fituar me AMTP me sipërfaqen e deklaruar prej tij, subjekti deklaroi<sup>32</sup> se sipërfaqja e deklaruar prej tij përfshin sipërfaqen 23.300 m<sup>2</sup> pemëtore + 300 m<sup>2</sup> truall + sipërfaqen brenda avllisë, në të cilën janë kryer ndërtime të banesës kryesore, njësi të shërbimit apo oborrit që shërben për parking, 1090 m<sup>2</sup>. Ndërsa, në lidhje me pjesën takuese, prej 30%, subjekti shpjegoi se në momentin e deklarimit, motrat ishin martuar dhe larguar nga familja vite më parë, ndërsa babai kishte vdekur në vitin 2010<sup>33</sup>, prandaj pjesën e deklaruar e ka llogaritur në pjesë ideale sipas anëtarëve

<sup>29</sup> Shihni aktet në aneksin 4/2 e 27 në dosjen e ILDKPKI-së, dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 8 në dosjen e Komisionit.

<sup>30</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 9 në dosjen e Komisionit.

<sup>31</sup> Sipas kësaj certifikate familja përbëhej nga 10 anëtarë: dy prindërit N.P., e L.P., si dhe tetë fëmijët A., F., V., F., V., A., Ylli dhe Y.P.

<sup>32</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 8, në dosjen e Komisionit.

<sup>33</sup> Shihni certifikatë vdekjeje të shtetasit N.P., bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, sipas së cilës ky shtetas ka ndërruar jetë në datën 2.3.2011; shihni certifikatën familjare datë 20.11.2019, bashkëngjitur pyetësorit nr. 2 sipas së cilës F.P., është larguar nga familja në vitin 1997.

të familjes që kishin mbetur: 30% Ylli Pjetërnikaj, 30% Y.P., 30% A.P., dhe 10% L. P. Vëllai tjetër A.P., kishte përfitur tokë si kryefamiljar dhe pjesëtar i certifikatës familjare përkatëse.

**30.4** Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me këtë pasuri, me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit i kaloi barra e provës ku duket se ka deklarim të pasaktë në deklaratën *Vetting* dhe në DPFD-në e vitit 2013 në lidhje me: (i) sipërfaqen e tokës së përfitur sipas ligjit nr. 7501 me AMTP; dhe (ii) pjesën takuese në këtë pasuri.

**30.5** Në parashtrimet e tij subjekti ka sqaruar se në deklaratën fillestare të vitit 2013 dhe në atë *Vetting* ka përcaktuar sipërfaqen faktike që kishte familja e tij në ato momente dhe jo vetëm sipërfaqen e përfitur me AMTP. Sipas tij, kësaj të fundit i janë shtuar edhe pjesa e sipërfaqes së tokës brenda avllisë, në të cilën janë kryer ndërtimet e banesës kryesore, njësive të shërbimit, apo oborrit që shërben për parking, 1090 m<sup>2</sup>. Ndërsa në lidhje me pjesën takuese të deklaruar në vitin 2013 ka sqaruar se në vitin 1991 kanë qenë 7 anëtarë në familje sipas certifikatës familjare, ndërsa vëllezërit A., dhe F.P., kanë qenë më vete në certifikatë. Motrat F., dhe V. P., kanë qenë të martuara dhe nuk kanë pasur pretendime në këto pasuri për pjesën e tyre takuese, ndërsa babai ka ndërruar jetë në vitin 2010. Pra, sipas subjektit, referimi i Komisionit në certifikatën e vitit 1991 nuk është i saktë, pasi toka u është shpërndarë në vitin 1992, ku në certifikatë ishin vetëm 7 anëtarë. Më tej subjekti ka deklaruar se në deklaratimet e viteve 2013 dhe 2017 ka deklaruar pjesën e tij ideale, pra 30%, 10% L.P., 30% Y.P., dhe 30% A. P., ndërsa motrat nuk kishin pretendime. Për të mbështetur pretendimet e tij subjekti ka paraqitur: (i) certifikatë familjare nr. “\*\*\*”, datë 12.4.2023 sipas së cilës familja Pjetërnikaj në datën 14.5.1993 përbëhej nga 7 persona; (ii) certifikatë familjare nr. 0150059428, datë 12.4.2023 sipas së cilës në datën 1.10.1992 A.P., dhe F.P., kanë qenë më vete; (iii) deklaratë noteriale nr. “\*\*\*”, datë 17.4.2023 në të cilën shtetasja V.P., deklaroi se është martuar në vitin 2008 dhe se nuk ka pretendime lidhur me tokën bujqësore; (iv) deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 13.4.2023 në të cilën shtetasja F.J., deklaroi se nuk ka pretendime në lidhje me tokën bujqësore.

**30.6** Në vlerësim të pretendimeve të subjektit, Komisioni çmon se në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, dhe VKM-së nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, toka bujqësore është ndarë për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes familjare në datën 1.8.1991. Në këto kushte, bazuar në nenet 4, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit të ILDKPKI-së, subjektet kanë pasur detyrimin të deklaronin pasuritë e paluajtshme, të përfituara sipas ligjit nr. 7501/1991, sipas pjesës së tyre takuese. Në nenin 163 të Kodit Civil përcaktohet se: “*Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë*”. Si pasojë, është ligji nr. 7501/1991 që i ka njohur të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore subjektit të rivlerësimit për shkak se ka qenë në të njëjtën përbërje familjare me babain e tij në datën 1.8.1991 duke qenë gjithsej 10 anëtarë familjeje. Pra, pjesa takuese për frymë e familjes bujqësore llogaritej referuar certifikatës së gjendjes familjare të datës 1.8.1991 dhe jo datës kur ishte përfitur toka, sikurse subjekti pretendon. Sipas kësaj certifikate përbërja familjare e familjes Pjetërnikaj ishte nga 10 persona, e në këto kushte, pjesa takuese *de jure* e subjektit është 1/10, dhe çdo interpretim tjetër që e lidh pjesën takuese me traditën zakonore apo largimin e disa pjesëtarëve për shkak të martesës etj., është e pambështetur në ligj. E njëjta logjikë vlen edhe për deklarinin e sipërfaqes, e cila është e lidhur ngushtësisht me sipërfaqen e përcaktuar në AMTP.

**30.7** Në përfundim, bazuar në të gjitha sa më sipër Komisioni çmoi se, subjekti ndodhet në kushtet e mosdeklarimit të saktë të pjesës takuese, e për rrjedhojë edhe të sipërfaqes së pasurisë tokë arë. Megjithatë çmohet se, kjo pasaktësi nuk ka pasur si qëllim mbulimin e ndonjë shtate të dyshimtë, dhe për më tepër, u vërtetua që burimi i krijimit të pasurisë është ligji nr. 7501.

Për pasojë, kjo pasaktësi nuk mund të përbëjë shkak të një niveli që ta penalizojë subjektin e rivlerësimit.

**30.8** Pasuria *Tokë livadh, me sip. 1000 m<sup>2</sup>, fshati “\*\*\*\*”, Njësia Administrative “\*\*\*\*”, kontratë me kusht, me shkresë të thjeshtë. Vlera: 300.000 lekë. Pjesa takuese: 100%*. Nuk është deklaruar burimi i krijimit. ILDKPKI-ja, në lidhje me këtë pasuri, ka konstatuar: Deklarimi i subjektit nuk konfirmohet nga ZVRPP-ja Tropojë, pasi marrëveshja midis palëve nuk është konkretizuar me dokumentacion justifikues ligjor, për arsye të kushtit të vënë për këtë transaksion. Mbetet në kuadrin e një marrëveshjeje të thjeshtë. Nuk është dokumentuar kryerja e pagesës.

### **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

**30.9** Në lidhje me këtë pasuri nga aktet në dosje, në rend kronologjik rezultoi se<sup>34</sup>:

- Sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar në datën 10.6.2003, në emër të shtetasit N. P., rezulton e regjistruar pasuria nr. “\*\*\*\*”, e llojit “arë” me sip. 1125 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin “\*\*\*\*”, Tropojë.

- Me kontratë shitjeje me kusht, jo formale, lidhur në datën 13.12.2010, Ylli Pjetërnikaj ka blerë nga shtetasi N.P., një sipërfaqe toke prej 1000 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin “\*\*\*\*”, të Komunës “\*\*\*\*”, Tropojë, kundrejt çmimit 300.000 lekë pagesë e bërë paraprakisht. Pavarësisht se akti i datës 13.12.2010, nuk përmbush kushtet e një akti që vërteton fitimin e pronësisë, pra nuk vërtetohej kalimi *de jure* i pronësisë të subjekti, kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në DPFD-në e vitit 2013, si *“tokë livadh, fshati “\*\*\*\*”, Komuna “\*\*\*\*”, sip. 1.000 m<sup>2</sup>. Vlera: 300.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”*.

- Me deklaratën noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 14.1.2017, shtetasit N., dhe L.P., (shitësi i pasurisë dhe bashkëshortja e tij) kanë rikonfirmuar kalimin *de facto* të pronësisë, duke deklaruar: *“Në datën 13.12.2010, i kemi shitur në rrugë private të ndjerit, kushëririt tonë N.Q.P., një tokë bujqësore (arë) me nr. pasurie “\*\*\*\*”, z. k. “\*\*\*\*”, me sip. 1000 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin “\*\*\*\*”, Njësia Administrative “\*\*\*\*”, Tropojë. Meqenëse është tokë bujqësore, në momentin e fitimit të pronësisë kanë qenë përfitues dhe bashkëpronarë edhe fëmijët tanë ...që prej vitesh kanë emigruar jashtë Shqipërisë dhe nuk kanë mundur të jenë prezent për shitjen ligjore të pasurisë së mësipërme.... Deklarojmë me vullnet të lirë dhe të plotë se jemi plotësisht dakord që në momentin e prezencës së fëmijëve tanë, të bëjmë kalimin në rrugë ligjore, trashëgimtarëve ...të kushëririt tonë, të ndjerit N. Q. P”*.

- Me kontratën e shitjes nr. “\*\*\*\*”, datë 17.7.2020, shtetasit A.P., Y. P., Y.P., dhe A.P., kanë blerë nga shtetasit N.P., dhe L.P., pasurinë e llojit “arë” me sip. 1125 m<sup>2</sup><sup>35</sup>. Sipas kësaj kontrate çmimi i shitjes prej 300.000 lekësh është likuiduar sipas dokumentit të datës 13.12.2010, dhe se gjithashtu është likuiduar nga i ndjeri N.Q. P., (babai i subjektit). Siç vërehet në këtë kontratë, në cilësinë e palës blerëse përveç subjektit Ylli Pjetërnikaj janë shtuar edhe tre vëllezërit e tij. Referuar kësaj kontrate dhe deklaratës noteriale të sipërpërmendur të datës 14.1.2017, pavarësisht se në aktin e datës 13.12.2010 si blerës figuronte vetëm subjekti, përfitues të pasurisë kanë qenë të gjithë trashëgimtarët ligjorë të babait të tij N. P. Gjithashtu vërehet edhe një shtim i sipërfaqes së shitur prej 125 m<sup>2</sup>.

<sup>34</sup> Shihni aktet në aneksin 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së; dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. “\*\*\*\*” prot., datë 23.12.2020, të ASHK ZV Tropojë, protokolluar nga Komisioni me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 9.4.2021, në dosjen e Komisionit.

<sup>35</sup> Sipas pikave 1.1 dhe 1.2 të nenit 1 të kontratës, pasuria objekt kontrate është pas. sipas certifikatës së pronësisë lëshuar në datën 10.6.2003 dhe kartelës së pasurisë, rifreskuar më 13.7.2020. Sipas këtyre dokumenteve që janë bashkëlidhur kontratës, pasuria është e llojit “arë” dhe ka sip. 1125 m<sup>2</sup>.

- ASHK/ZV Tropojë ka konfirmuar se pasuria nr. “\*\*\*\*”, e llojit “arë”, me sip. 1125 m<sup>2</sup>, z. k. “\*\*\*\*”, sipas kartelës së pasurisë është e regjistruar në datën 10.7.2020 në pronësi të gjashtë bashkëpronarëve A.P., A.P., Y.P, Ylli Pjetërnikaj, B.P., dhe R.N.<sup>36</sup>.

**30.10** Gjatë procesit subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me këtë pasuri, i cili në përgjigjet e pyetësorëve nr. 2 dhe 3, ka dhënë sqarime të detajuara në lidhje me mosformalizimin e shitjes me një akt noterial që në vitin 2010, duke deklaruar në mënyrë të përmbledhur se shuma prej 300.000 lekësh i është paguar shtetasit N.P., nga i ndjeri babai i tij N.P., në vitin 2009, i cili bleu pasurinë për shkak se ishte shumë i lidhur me fshatin “\*\*\*\*” ku ishte lindur e rritur. Sipas tij, dokumentacioni nuk u përpilua në këtë vit për shkak të mungesës së disa prej fëmijëve të shitësve nga emigracioni, ose qenies së tyre të mitur. Më tej subjekti deklaroi se në nëntor të vitit 2010 babai i tij i ndjerë N.P., ka ndërruar jetë, dhe me qëllim për të garantuar trashëgimtarët për njohjen e kësaj kontrate dhe detyrimeve që buronin prej saj, në datën 13.12.2010, ai si njeri nga trashëgimtarët e babait të tij, ka nënshkruar një shkresë të thjeshtë në të cilën vërtetohej midis të tjerash edhe likuidimi i çmimit të shitjes. Për të mbështetur pretendimet e tij subjekti ka paraqitur: (i) certifikatën familjare të datës 18.10.2021 mbi përbërjen familjare të shitësve në datën 1.1.2010, sipas së cilës kjo familje përbëhej nga 7 anëtarë; (ii) deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 17.7.2020 të shtetasve N.P., dhe L. P., në të cilën ata konfirmojnë ndër të tjera deklaratimet e subjektit mbi shitjen e tokës në vitin 2009 shtetasit N.P., dhe arsyet e mungesës së dokumentacionit në vitin 2009; (iii) certifikatë familjare datë 20.11.2019 në të cilën vërehet shënimi se N. P., ka vdekur në datën 2.3.2011.

**30.11** Në përfundim të hetimit administrativ nuk ka pasur problematika e dyshime në lidhje me këtë pasuri e cila *de facto* është blerë nga babai i subjektit në vitin 2010 (përpara se subjekti të ishte në detyrë), ndërsa *de jure* në datën 17.7.2020 dhe vlera e çmimit prej 300.000 lekësh është përfshirë si shpenzim i familjes së subjektit i vitit 2009, referuar sqarimeve të subjektit dhe dokumentacionit të përcjellë me pyetësorin nr. 2 që janë deklaratat noteriale të shitësve të pasurisë sipas kontratës së shitjes e hartuar në datën 10.7.2020<sup>37</sup>. Analiza financiare e familjes Pjetërnikaj e vitit 2009, rezulton me balancë pozitive. Por, edhe nëse do të ishte konsideruar se shuma 300.000 lekë është likuiduar në vitin 2010, balanca e këtij viti është pozitive.

**31.** Pasuria *Automjet tip “Peugeot 307”*, me targa “\*\*\*\*”, blerë me anë të kontratës së shitjes së automjetit me nr. “\*\*\*\*”, datë 7.12.2012. Çmimi është paguar nga të ardhurat e familjes. Ky automjet përdoret nga vëllai Y.P. ILDKPKI-ja, në lidhje me këtë pasuri, ka konstatuar: Nuk provohet me dokumentacion justifikues ligjor deklarimi se automjeti tip “Peugeot 307”, me targë “\*\*\*\*” përdoret nga vëllai i subjektit Y.P.

## **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

**31.1** Gjatë hetimit administrativ nga aktet në dosje<sup>38</sup> rezultoi se ky automjet është blerë nga subjekti Ylli Pjetërnikaj prej shtetasit E.D., në shumën 4.000 euro sipas kontratës nr. “\*\*\*\*”, datë 7.12.2012, pra përpara fillimit të detyrës dhe është deklaruar prej tij në deklaratën e vitit 2013. Me kontratën nr. “\*\*\*\*”, datë 10.5.2018, automjeti është shitur në vlerën 2.000 euro. Për

<sup>36</sup> Sa i takon përfshirjes se B., dhe R.P., subjekti, në përgjigje të pyetësorëve 2 dhe 3 sqaroi se bazuar në nenin 45, pika 1 e ligjit nr. 111/2018, ato janë regjistruar si bashkëpronarë në pjesën takuese të bashkëshortëve të tyre A., dhe A. P., (vëllezërit e tij), për shkak se ajo është pasuri e fituar gjatë martesës dhe, si e tillë, është pasuri e përbashkët e bashkëshortëve përderisa ata nuk kanë provuar se i nënshtrohen një regjimi të veçantë pasuror.

<sup>37</sup> ASHK Tropojë me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 23.12.2020 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 9.4.2021) ka përcjellë kontratën e shitjes nr. “\*\*\*\*”, datë 17.7.2020.

<sup>38</sup> Shihni aktet në aneksin 4.4 dhe 30 në dosjen e ILDKPKI-së; shkresa kthim përgjigjeje nga Ministria e Drejtësisë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 15.12.2020 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 17.12.2020).

këtë arsye, sipas informacionit të DPSHTRR-së<sup>39</sup> ky automjet nuk figuron në pronësi të subjektit.

**31.2** Nga verifikimi në sistemin elektronik të AMF, Ylli Pjetërnikaj rezulton pronar i automjetit me targë “\*\*\*\*” dhe në disa prej policave të sigurimit, vëllai i tij Y.P., rezulton përdorues. Më pas policat rezultojnë në emër të shtetases F.Ç., blerësja e automjetit në vitin 2018. Nuk rezultuan të dhëna për ndonjë konflikt të mundshëm interesi me këtë shtetase.

**31.3** Komisioni ka kryer analizën financiare për vitin 2012 të familjes bujqësore, paraqitur në tabelën më poshtë në të cilën nuk janë përfshirë të ardhura nga ferma, nga e cila rezulton se justifikohet blerja e mjetit me të ardhura të ligjshme.

Viti	30.11.2012
Të ardhurat nga ferma	
Të ardhura nga pensioni i L.P.	149 583 lekë
Të ardhura B.P.	535 169 lekë
Të ardhura R.P.	354 882 lekë
Dhurim nga Ylli Pjetërnikaj për A.P. (transaksion në RFZ)	1 000 000 lekë
<b>TË ARDHURAT NË TOTAL</b>	<b>2 039 634 lekë</b>
Likuiditetet në bankë	500 lekë
<b>PASURITË NË TOTAL</b>	<b>500 lekë</b>
Blerja e automjetit tip “Peugot 307” më 7.12.2012	558 880 lekë
Shpenzimet jetike	745 124 lekë
Transferta parash nga A.P., për Ylli Pjetërnikaj (transaksion në RFZ)	500 000 lekë
<b>SHPENZIMET NË TOTAL</b>	<b>1 757 430 lekë</b>
<b>REZULTATI FINANCIAR</b>	<b>281 704 lekë</b>

**32.** Pasuria Automjet tip “Volkswagen –VW”, me targë “\*\*\*\*”. Blerë me anë të kontratës për shitblerje automjeti me nr. “\*\*\*\*”, datë 30.12.2014. Çmimi është paguar nga të ardhurat e familjes të akumuluar ndërr vite, siç deklarova më sipër, të përdorura edhe për rikonstrukcion, të deklaruar në ILDKPKI, viti 2013. Vlera: 4.000 euro. Pjesa takuese: 100%. ILDKPKI-ja ka konstatuar: në deklarimin e vitit 2014 nuk është qartësuar nga subjekti burimi financiar i përdorur për blerjen e automjetit me targa “\*\*\*\*”.

### Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

**32.1** Gjatë hetimit administrativ DPSHTRR-ja<sup>40</sup> informoi se në pronësi të subjektit nuk ka automjet në pronësi, ndërsa sipas dokumentacionit të ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së<sup>41</sup>, subjekti ka në pronësi automjetin me targë “\*\*\*\*”.

**32.2** Nga aktet e administruara në ILDKPKI, rezulton se këtë automjet subjekti e ka blerë nga shtetasi O.A.L., kundrejt vlerës 4.000 euro, sipas kontratës nr. “\*\*\*\*”, datë 30.12.2014. Sipas kontratës, kjo vlerë do të paguhet me regjistrimin e mjetit, i cili nga dokumentet figuron i regjistruar në DPSHTRR-në Tiranë në datën 16.1.2015<sup>42</sup>. Blerja e këtij automjeti është deklaruar nga subjekti edhe në DPV-në e vitit 2014 pa deklaruar burimin. Në lidhje me përdorimin e këtij automjeti, nga verifikimi i sistemit elektronik të AMF-së në të gjitha policat

<sup>39</sup>Shihni shkresën kthim përgjigjeje nga DPSHTRR-ja nr. “\*\*\*\*” prot., datë 14.12.2020 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 15.12.2020).

<sup>40</sup>Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 14.12.2020 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 15.12.2020).

<sup>41</sup>Shkresë e DPSHTRR-së nr. “\*\*\*\*” prot., datë 21.7.2017 (protokolluar në ILDKPKI me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 24.7.2021).

<sup>42</sup> Shkresë e DPSHTRR-së nr. “\*\*\*\*” prot., datë 27.7.2017.



subjekti figuron pronar dhe përdorues. Nuk rezultuan të dhëna për një konflikt të mundshëm interesi me shitësin e automjetit O.A.L.

**32.3** Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, në deklaratën *Vetting* subjekti i referohet gjendjes *cash* të deklaruar në DPFID-në e vitit 2013 me burim nga të ardhurat nga ferma. Duke qenë se këto të ardhura në përfundim të hetimit nuk u konsideruan si burim për krijimin e likuiditetit *cash*, viti 2014 në të cilin është blerë mjeti rezulton me balancë negative me vlerë - 2.125.845 lekë dhe në këto kushte, subjekti nuk ka justifikuar blerjen e mjetit me të ardhura të ligjshme.

**32.4** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim si dhe mbi mosdeklarimin e burimit të krijimit në DPV-në e vitit 2014. Në parashtrimet e tij subjekti ka dhënë të njëjtat sqarime si ato të dhëna më sipër për godinat e ndodhura në fshatin “\*\*\*\*”, Tropojë, duke parashtruar se burimi i krijimit për këto pasuri ashtu si dhe për automjetin objekt verifikimi janë të ardhura nga kursime të familjes. Megjithatë, edhe në kushtet kur të ardhurat nga ferma nuk janë konsideruar të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës për vitin 2014, nga analiza financiare e këtij viti pasqyruar në tabelën më poshtë, duket se subjekti ka justifikuar me kursime të tij të ligjshme blerjen e mjetit në vlerën 4000 euro sipas kontratës së datës 30.12.2014. Sa i takon mosdeklarimit të burimit në DPV për vitin 2014, kjo është një pasaktësi të cilën subjekti e ka rregulluar gjatë pyetjes pranë ILDKPKI në vitin 2016, ku ai ka deklaruar si burim të ardhura nga kursimet familjare. Për më tepër, në kushtet kur subjekti ka justifikuar blerjen e mjetit me kursime të ligjshme të tij, kjo pasaktësi mbetet formale dhe pa ndonjë pasojë.

<b>PERIUDHA</b>	<b>2014</b>
Paga si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, nga data 08.11.2013-03.12.2014	899,100
Paga si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, nga data 03.12.2014-31.12.2016	59,481
<b>Të ardhura</b>	<b>958,581</b>
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë dhe CASH	-180,224
Blerja e automjet tip Volkswagen, me targë “****”, me kontratë nr. “****” rep., nr. “****” kol., dt. 30.12.2014.	560,440
<b>Pasuri</b>	<b>380,216</b>
Derdhje nga E. Sh., në llog e Ylli Pjetërnikaj ne RFZ	38,000
Derdhje nga V. C., në llog e Ylli Pjetërnikaj ne RFZ	120,000
<b>Detyrime</b>	<b>158,000</b>
Shuma e transferuar në llogarinë e vëllait Y.P., dt. 29.12.2014 dhe dt. 26.01.2015	32,000
Shpenzime qeraje për apartamentin në pronësi të z. T.T., për periudhën 01.12.2013-26.12.2014.	360,000
Shpenzime interesi për kredinë 988,000 lekë në Raiffeisen	30,283
Shpenzime jetese	219,998
Shpenzime udhëtimi	78,636
<b>Shpenzime</b>	<b>720,916</b>
<b>Rezultati financiar</b>	<b>15,448</b>

**33.** Pasuria “*Bagëti dhe bletë*”: (i) 150 krerë dele të krijuara që nga viti 1990 nga prindërit dhe vëllezërit, të cilat ndodhen në fshatin “\*\*\*\*”. Vlera: 15.000 euro. Pjesa takuese: 50%; (ii) pesë lopë, të krijuara që nga viti 1990 nga prindërit dhe vëllezërit, të cilat ndodhen në fshatin “\*\*\*\*”, Njësia Administrative “\*\*\*\*”. Vlera: 500.000 lekë. Pjesa takuese: 25%; bletë 56 koshere të krijuara që nga viti 1990 nga prindërit dhe vëllezërit, të cilat ndodhen në fshatin “\*\*\*\*”, Njësia Administrative “\*\*\*\*”. Vlera: 5.600 euro. Pjesa takuese: 25%. ILDKPKI në lidhje me këto

pasuri ka konstatuar se dokumentacioni i paraqitur konfirmon pasuri të luajtshme dhe aktivitet privat në emër të A.N.P., dhe jo të subjektit. Konfirmohet nga DPT veprimtaria e A. P., regjistruar si prodhues bujqësor. Nuk është i qartë deklarimi i pjesës takuese prej 50% dhe 25%.

### Hetimi i Komisionit në lidhje me këto pasuri

**33.1** Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit konstatohet se: (i) Në DIPPFD-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar: 150 krerë dele, të trashëguara, fshati “\*\*\*\*”, krijuar në vitin 1996. Pjesa takuese: 50%; 5 lopë të trashëguara, në fshatin “\*\*\*\*”, Komuna “\*\*\*\*”, krijuar në vitin 1996. Pjesa takuese: 25%; 50 koshere të trashëguara, në fshatin “\*\*\*\*”, Komuna “\*\*\*\*”, krijuar më 1996. Vlera: 5.600 euro. Pjesa takuese: 25%; (ii) Në DPV-në e vitit 2013 nuk ka deklaruar pasuri (ndryshime, shtesa, pakësime); (iii) në DPV-në e vitit 2014 në zërin “Përshkrimi i pasurisë...” ka deklaruar vetëm “*të ardhura nga ferma ...*”; (iv) në DPV-në e vitit 2015 ka deklaruar “*nuk ka ndryshim*”; (v) në DPV-të e viteve 2016 dhe 2017 (pas Vetting-ut) dhe as në atë të 2018 nuk ka deklaruar ndryshime, shtesa, pakësime në lidhje me këto pasuri.

**33.2** Nga aktet në dosjen e ILDKPKI-së<sup>43</sup> në lidhje me këto pasuri konstatohet se: (i) sipas printimit të sistemit të informacionit blegtoral e veterinar vulosur nga Kryeinspektori veterinar i DEBUMK-së Kukës, A.N.P., (vëllai i subjektit) ka 210 të leshta, 6 gjedhë, 2 derra, 50 shpendë, 56 bletë, me prodhim të përzier qumësht dhe mish. Informacioni është i datës 10.13.2016; (ii) DRT Kukës<sup>44</sup> ka informuar se subjekti A.P., me NIPT “\*\*\*\*”, me aktivitet prodhues bujqësor e blegtoral në fshatin “\*\*\*\*”, Tropojë, është i regjistruar pranë kësaj drejtorie si fermer që nga data 23.11.2015, me numër serial “\*\*\*\*”; (iii) sipas vërtetimit nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave/Drejtoria Veterinare Kukës, fermeri A.N.P., me kod ferme “\*\*\*\*”, në “\*\*\*\*”, Tropojë, ka të regjistruar dhe vazhdon aktivitetin e tij blegtoral që nga viti 2011 e deri sot.

**33.3** Gjatë hetimit administrativ, DPT-ja<sup>45</sup> informoi se: (i) subjekti Ylli Pjetërnikaj nuk rezultoi i regjistruar në organin tatimor me aktivitet privat; (ii) shtetasi A.N. P., i datëlindjes 19.6.1969, nr. personal “\*\*\*\*”, rezultoi si administrator i subjektit fermeri “\*\*\*\*”, me “\*\*\*\*”, i cili është me status “aktiv” që në datën 21.11.2015. Aktiviteti kryesor i tij është “*shërbime plotësuese në blegtori (mbarështrimi, pastrimi, etj.), përveç aktiviteteve veterinare*”; (iii) shtetasi A.N. P., i datëlindjes 12.12.1978, rezultoi si administrator i subjektit fermeri “\*\*\*\*”, me NIPT “\*\*\*\*”, i cili është me status “aktivi” që në datën 7.5.2019. Aktiviteti kryesor i tij është “*Rritja e kafshëve të tjera (kafshëve shtëpiake, lepujve, bletë, krimb mëndafshi*”. Ndërsa nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural u konfirmua se shtetasi A.N.P., ka përfituar subvencion ndër vite (nga viti 2012 deri në vitin 2021, me përjashtim të vitit 2014) nga skema kombëtare pranë AZHBR-së. Përfitimet kanë qenë për skemën “tufë bazë dele/dhi” dhe në vitin 2013, edhe për skemën “bletari”<sup>46</sup>.

**33.4** Nga sa më sipër rezultoi se: (i) subjekti ka deklaruar pasuritë e mësipërme, ndërkohë që aktiviteti privat në fushën e blegtorisë figuron i regjistruar në emër të vëllait të tij A. P., që në datën 21.11.2015 dhe vëllait tjetër A.P., në datën 7.5.2019; (ii) subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar 150 krerë dele, nga të cilat ai zotëron 50%, ndërsa në pasuritë e tjera zotëron 25%, ndërkohë që vëllai i subjektit, z. A.P., i cili ka qenë i regjistruar si fermer përpara deklaratës *Vetting*, në datën 10.13.2016 ka pasur të regjistruar 210 të leshta.

**33.5** Duke qenë se ka qenë i paqartë deklarimi i pjesës takuese të subjektit mbi këto pasuri, subjekti është pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi arsyet e deklarimit të pjesës së tij takuese ndërkohë që aktiviteti privat ka qenë në emër të vëllait, kontributin e tij në veprimtarinë

<sup>43</sup> Shihni aktet në aneksin 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>44</sup>Nr. “\*\*\*\*” prot., datë 13.10.2016.

<sup>45</sup>Me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 14.12.2020 (prot. në Komision me nr. “\*\*\*\*”, datë 16.12.2020).

<sup>46</sup> Shihni shkresën e AZHBR-së nr. “\*\*\*\*” prot., datë 21.4.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 26.4.2022) dhe dokumentacionin bashkëlidhur.

blegtorale dhe bletët dhe numrin e tyre në vite. Subjekti dha sqarime të shoqëruara me dokumente shkresore<sup>47</sup>, si vijon:

- Në lidhje me aktivitetin blegtoral ai ka informuar se ky aktivitet ka nisur që në vitet 1992 – 1993 nga babai i tyre N. P., dhe është zhvilluar më pas duke u përfshirë në këtë aktivitet të gjithë anëtarët e familjes. Sipas tij, në kohën e përpilimit të regjistrit të fermës në vitin 2010 kur u inventarizuan kafshët në fermë, babai i tyre ishte në gjendje të rënduar shëndetësore, e ndërroi jetë, e për këtë arsye, të gjitha dokumentet u bënë në emër të kryetarit të familjes bujqësore A.P. Sipas legjislacionit civil, kryetari i familjes bujqësore është përfaqësues në marrëdhënie me të tretët, ndërsa bashkëpronësia përcaktohet nga certifikata familjare, apo lidhja ndërmjet tyre për shkak gjinie, martesë, birësimi ose pranimi si anëtar i saj.

- Në lidhje me kontributin e tij në shpenzimet për veprimtarinë blegtorale dhe për bletarinë, dhe pjesën e tij takuese subjekti deklaroi se nuk ka kontribuar për krijimin dhe mirëmbajtjen e fermës dhe se ka qenë pjesë e saj deri në momentin që ka dalë në jetë i pavarur ekonomikisht nga familja e tij. Ndërkohë, pavarësisht nga përcaktimet e Kodit Civil<sup>48</sup> për familjen bujqësore, deklaroi se zotëron 25% të tyre referuar të drejtës zakonore, sipas së cilës pronarë janë katër djemtë<sup>49</sup> e familjes. Ndërsa sa i takon deklarinë të pjesës prej 50%, sipas tij përbën lapsus. Zyrtarisht, nga familja bujqësore është larguar në datën 30.4.2013<sup>50</sup>, por që në vitet 2005 – 2006 e në vijim, është larguar për të jetuar në qytetin e Tiranës ku ka vijuar studimet.

- Në lidhje me faktin që në të gjitha deklaratat ndër vite ka deklaruar të njëjtin numër delesh dhe lopësh (vetëm nr. e koshereve të bletëve në *Vetting* e ka deklaruar 6 më shumë se në deklaratat e tjera), subjekti deklaroi se prej vitit 2014 kur është emëruar në detyrë i ka shkëputur marrëdhëniet me fermën duke mos marrë më të ardhura prej saj (përveç produkteve), dhe kjo ka qenë arsyeja që nuk ka deklaruar ndryshimet ndër vite, ndërkohë që pjesa e tij takuese nuk ka ndryshuar.

**33.6** Në përfundim të hetimit administrativ nuk ka pasur dyshime që do të kërkonin hetime te mëtejshme për këto pasuri, te cilat janë krijuar përpara fillimit të detyrës me kursime familjare te familjes bujqësore.

**34.** Pasuria *Gëlqere, 50 m<sup>3</sup>, e trashëguar, e krijuar në vitin 2004, e cila ndodhet në fshatin “\*\*\*\*”, Njësia Administrative “\*\*\*\*”*. Vlera: sipas llogaritjes, mendoj që vlera e saj në vitin 2013 ka qenë rreth 3.000.000 (tre milion) lekë. Aktualisht, vlera është rreth 1.000.000 (një milion) lekë. Pjesa takuese: 25 %. ILDKPKI në lidhje me këtë pasuri konstaton se subjekti nuk i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacion justifikues ligjor. Nuk është i qartë deklarimi i pjesës takuese prej 25%.

### **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

**34.1** Nga verifikimi deklarimeve të subjektit konstatohet se: (i) në DIPPFD-në e vitit 2013, ka deklaruar: gëlqere, 50 m<sup>3</sup>, e trashëguar, e cila ndodhet në fshatin “\*\*\*\*”, Komuna “\*\*\*\*”, krijuar në vitin 2004. Pjesa takuese: 25%, vlera 3.000.000 lekë; (ii) në DIPP-në e viteve 2013 – 2016 dhe 2017 (pas *Vetting*-ut) nuk ka deklaruar ndryshime, shtesa, pakësime në lidhje me këtë

<sup>47</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit; vërtetim nr. “\*\*\*\*” prot., datë 15.8.2019 i Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, Shkodër; regjistri i fermës me nr. Serial RF nr. “\*\*\*\*”, në të cilin janë përcaktuar, inventarizuar kafshët prezent në fermë; të dhënat e sistemit “RUDA”, praktika e mbajtjes nga AZHBR-ja, procesverbalet e vaksinimit, vërtetime të organeve shtetërore, aktekspertime, akte të marrjes së tokës në pronësi, fotografime.

<sup>48</sup> Neni 227: “Çdo anëtar i familjes bujqësore mund të kërkojë pjesën e vet në pasurinë e familjes bujqësore. Ajo përcaktohet duke marrë parasysh sidomos: a) pasurinë që i përket tërë familjes; b) numrin e anëtarëve të familjes; c) kontributin e tij në vënieën ose shtimin e pasurisë së familjes duke u nisur nga sasia ose efektiviteti i këtij kontributi, si dhe nga puna dhe mjetet e dhëna në krijimin dhe mbajtjen e ekonomisë bujqësore”.

<sup>49</sup> Vëllai tjetër F.P., është ndarë nga familja bujqësore shumë vite më parë.

<sup>50</sup> Referuar shënimeve në certifikatën familjare dt.20.11.2013, subjekti “është larguar për njësinë “\*\*\*\*” Tiranë me datë 30.04.2013”.

pasuri. Subjekti nuk i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* ndonjë dokument. Për këtë arsye, gjatë hetimit administrativ subjektit iu kërkua të japë sqarime dhe dokumentacion ligjor për të provuar kohën dhe mënyrën e krijimit të saj, pjesën takuese si dhe ndryshimin e vlerës nga 3.000.000 lekë në 1.000.000 lekë.

**34.2** Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi mënyrën e krijimit të saj nga pikëpamja teknike. Ai shpjegoi se ajo është krijuar në vitin 2004 dhe paraqiti ortofoto të vitit 2007 e në vijim. Gropa e gëlqeres është përfshirë në raportin e vlerësimit të përgatitur nga ekspertja L. B., të vitit 2019, të paraqitur në Komision dhe referuar kësaj, subjekti sqaron se sipas matjeve të sipërfaqes së gropës së gëlqeres në autokad, thellësisë së saj dhe peshës mesatare të gëlqeres ton/m<sup>3</sup>, shumëzuar me vlerën 12000 lekë/ton, vlera e saj është 2.732.400 lekë, ku nuk janë përfshirë shpenzimet e gërmimit, etj. Në vijim, ka shpjeguar se një pjesë e saj është përdorur gjatë rikonstruksionit të banesës në vitin 2014, ndërsa një pjesë e vogël e saj është bashkuar me dhe, prandaj mendon se në vitin 2017 vlera e saj mund të ketë rënë në 1.000.000 lekë. Gjithashtu, ka deklaruar përsëri se pjesa e tij takuese në këtë pasuri është 25% referuar të drejtës zakonore.

**34.3** Në përfundim të hetimit administrativ nuk ka pasur dyshime që do të kërkonin hetime të mëtejshme për këtë pasuri, të krijuar përpara fillimit të detyrës nga subjekti, për të cilën nuk u vërtetuan kontribute të subjektit.

**35.** Pasuria *Apartamenti me kod "\*\*\*\*", me sip. 112.98 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie "\*\*\*\*", vol. "\*\*\*\*", faqe "\*\*\*\*", z.k. "\*\*\*\*", adresë "\*\*\*\*", rruga "\*\*\*\*" në përdorim të subjektit aktualisht, por në pronësi të vëllait Y.P., blerë me diferencën e të ardhurave të akumuluar ndërsa vite nga familja e subjektit pas rikonstruksionit dhe blerjes së mjetit të deklaruar më sipër, deklaruar në ILDKPKI, viti 2013. Vlera: 44 000 euro.* Trajtimi i kësaj pasurie është kryer në paragrafin 37, si pasuri e deklaruar nga personi i lidhur Y.P., në deklaratën *Vetting*. Në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar si adresë vendqëndrimi tjetër, adresën e kësaj pasurie.

## **DETYRIME FINANCIARE**

**36.** Subjekti deklaron në deklaratën *Vetting*: *kredi bankare në shumën 500.000 lekë, sipas kontratës kredi bankare të datës 9.1.2015. Data e fillimit të kredisë është 13.1.2015. Shuma e detyrimit të mbetur e pashlyer deri në datën 10.1.2017 është 390.417 lekë.*

**36.1** Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e ILDKPKI-së<sup>51</sup> konstatohet se me kontratë kredie bankare të datës 9.1.2015, z. Ylli Pjetërnikaj ka marrë 500.000 lekë kredi nga "Raiffeisen Bank", me afat 84 muaj. Marrja e kësaj kredie, shuma e shlyer dhe gjendja e detyrimit të mbetur është deklaruar në DPV-në e vitit 2015 për qëllime personale. Gjithashtu subjekti e deklaron kredinë edhe në DPV-në e vitit 2016 dhe në deklaratat e tjera në vijim, duke deklaruar gjendjen e mbetur të saj dhe shumën e shlyer çdo vit. Edhe në informacionin e dërguar nga "Raiffeisen Bank" në datën 17.12.2020<sup>52</sup>, informohet se subjekti ka pasur një kredi konsumatore në shumën 500.000 lekë, të marrë në datën 13.1.2015, me detyrim në datën e dërgimit të shkresës nga "Raiffeisen Bank" në Komision në shumën 105.719,39 lekë. Prej *statement*-it bankar rezulton se kjo kredi është shlyer tërësisht në vitin 2019, me të ardhura nga pagat e subjektit. Sa i takon përdorimit të kredisë, rezulton se subjekti ka tërhequr *cash* vlerën 259.000 lekë nga llogaria në datën 20.1.2015, në datën 26.1.2015 ka transferuar shumën 140.000 lekë në llogarinë e vëllait, z. Y.P., dhe pjesa tjetër prej 98.000 lekësh është tërhequr nga subjekti pjesë-pjesë në shumën të vogla, nga data 13.1.2015 deri më 23.1.2015.

**36.2** Përveç këtij detyrimi financiar, sipas informacionit të marrë nga "Raiffeisen Bank"<sup>53</sup>, subjekti ka pasur edhe dy kredi të tjera:

<sup>51</sup> Shihni aneksin nr. 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>52</sup> Shkresë nr. "\*\*\*\*" prot., datë 17.12.2020 (administruar në Komision me nr. "\*\*\*\*" prot., datë 17.12.2020).

<sup>53</sup> Shkresë nr. "\*\*\*\*" prot., datë 17.12.2020 (administruar në Komision me nr. "\*\*\*\*" prot., datë 17.12.2020).

a. Një kredi në shumën 988.000 lekë të marrë më 2.7.2014. Sa i takon kësaj kredie u konstatua se:

- Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja më 31.3.2016, subjekti, midis të tjerash, ka deklaruar se: “Në korrik të vitit 2004 kam marrë një kredi në vlerë 1.000.000 lekë në ‘Raiffeisen Bank’ e cila është përdorur për rikonstruksionin e stallave të bagëtive në Tropojë...”. Gjatë procesit të rivlerësimit subjekti ka deklaruar se kredia bankare e deklaruar edhe në pyetësonin standard është në shumën prej 988.000 lekësh, data e fillimit të kredisë është 2.7.2014 dhe ajo është shlyer në muajin tetor të vitit 2014. Ndërsa lidhur me qëllimin e marrjes së saj, sqaroi se meqë në verën e vitit 2014 kishin filluar punimet për rikonstruksionin e banesës, ai dhe vëllezërit kishin menduar të shembnin stallat ekzistuese që ishin pranë banesës dhe t’i spostonin ato. Ndërtimi i stallave të reja me infrastrukturë moderne kishte kosto të lartë, afër 4 milionë lekë, të cilën familja nuk e përballonte të gjithën dhe meqë ai nuk kishte dhënë kontribut vetjak, kishte shfaqur mendimin dhe vullnetin që të jepte ndihmën e tij duke marrë kredi personale. Për këtë qëllim, ka marrë kredinë në fjalë, por ndërtimi i stallave të reja kërkonte leje ndërtimi, e cila, siç u bënë me dije nga autoritetet përgjegjëse, nuk mund t’u jepej, pasi toka e përfutur me ligjin nr. 7501 nuk ishte e regjistruar në ZVRPP (fakt i cili rezultoi i vërtetë gjatë hetimit administrativ pasi është regjistruar së fundmi). Në këto kushte, bënë modifikimin e stallave ekzistuese dhe nuk ndërtuan stalla të reja, prandaj vlera e marrë e kredisë nuk u përdor dhe u kthye duke bërë mbylljen e saj në tetor të vitit 2014.

- Sa i takon informacionit të “Raiffeisen Bank”<sup>54</sup> sipas të cilit kredia është marrë më 2.7.2014 në vlerën 988.000 lekë dhe është mbyllur me marrjen e kredisë së re në datën 13.1.2015, rezulton i pasaktë, pasi nga *statementi* bankar bashkëlidhur rezulton se subjekti ka depozituar *cash* vlerën 984.000 lekë në datën 24.10.2014. Në këto kushte, kjo kredi është marrë dhe është shlyer brenda vitit 2014, sikurse subjekti deklaroi.

b. Një kredi në shumën 92.990 lekë, marrë më 3.4.2015, e cila është përdorur për blerje aparati telefonik pranë “\*\*\*\*\*” sh.p.k. dhe likuiduar totalisht në datën 3.4.2019. Kjo kredi ka qenë aktive dhe me vlerë të mbetur 60.925 lekë në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting*, por nuk është deklaruar prej tij në këtë deklaratë. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektivit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me mosdeklarimin e kësaj kredie në deklaratën *Vetting*. Në parashtrimet e tij subjekti ka sqaruar se në datën 3.4.2015 në një nga pikat e “\*\*\*\*\*” sh.p.k. ka blerë një aparat celular me këste. Sipas tij, ky shpenzim ka qenë i padeklarueshëm, pasi nuk kalon vlerën prej 300.000 lekësh, për rrjedhojë edhe detyrimin që rrjedh prej këtij sendi si të përjashtuar nga detyrimi për deklarim, sepse në thelb ai ishte shpenzim nën 300.000 lekë.

Në vlerësim të sqarimeve të dhëna nga subjekti, në ligjin nr. 84/2016 parashikohet deklarimi i detyrimeve ndaj personave fizikë ose juridikë të mbetur pa shlyer deri në datën e deklarimit. Ndërsa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, parashikohet deklarimi i shpenzimeve mbi 300.000 lekë. Nisur nga këto parashikime subjekti duhet të kishte deklaruar këtë kredi në deklaratën *Vetting* si detyrim ndaj të tretëve në rubrikën e detyrimeve. Megjithatë, nisur nga vlera jo e konsiderueshme e saj, Komisioni çmon se kjo pasaktësi nuk përbën shkak për penalizim të subjektivit.

### **Pasuri të deklaruara të personit të lidhur Y.P., – vëllai i subjektivit të rivlerësimit**

**37.** Pasuria *Apartamenti me kod “\*\*\*\*”, me sip. 112.98 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie “\*\*\*\*”, vol. “\*\*\*\*”, faqe “\*\*\*\*”, z. k. “\*\*\*\*”, adresë – Yzberisht, rr. “\*\*\*\*\*”*. Ky apartament është blerë me të ardhurat e familjes të grumbulluar ndër vite nga punësimi i anëtarëve të familjes, si dhe të ardhurat nga ferma. Këto të ardhura na janë dhënë mua dhe vëllait tim Ylli Pjetërnikaj nga familja në vitin 2013. Vlera: 44.000 euro. Pjesa takuese: 100%. ILDKPKI-ja në lidhje me këtë

<sup>54</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 17.12.2020 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 17.12.2020).

pasuri ka konstatuar: dyshime lidhur me burimin e blerjes së apartamentit në “\*\*\*\*”, Tiranë, pasi në deklarin “para fillimit të detyrës 2013”, subjekti Ylli Pjetërnikaj ka deklaruar kursime *cash* në shumën 20.000.000 lekë, ku zotëron 50% dhe ndërkohë aplikon bashkë me vëllain Y.P., për kredi në shumën 4.500.000 lekë, duke pasur gjithashtu edhe kredi personale në shumën 500.000 lekë në vitin 2015.

### **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

**37.1** Nisur nga faktet: (i) subjekti ka qënë bashkëkredimarrës në kredinë e marrë për blerjen e pasurisë nga vëllai i tij Y.P.; (ii) në deklarinet pranë ILDKPKI-së në datë 31.3.2016 subjekti ka deklaruar se së bashku me vëllanë kanë blerë në vitin 2015 një apartament banimi në Tiranë, si dhe faktit që subjekti ka banuar në këtë pasuri për disa vite rresht së bashku me vëllanë e tij, nga ana e Komisionit janë kryer disa veprime hetimore me qëllim për të përcaktuar qartë lidhjen e subjektit me këtë pasuri dhe për të hequr çdo dyshim për një pasuri të mundshme të subjektit të rivlerësimit.

### **37.2 Nga aktet në dosje<sup>55</sup> rezultoi se në rend kronologjik janë kryer veprimet si vijojnë:**

- Sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar në datën 2.3.2011, rezulton e regjistruar në pronësi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. pasuria nr. “\*\*\*\*”, e llojit “apartament” me sip. 100.83 m<sup>2</sup>, me adresë në “\*\*\*\*”, Tiranë.
- Me kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme me kusht kreditimi nga banka me nr. “\*\*\*\*”, datë 10.11.2014<sup>56</sup>, shtetasi Y.P., (vëllai i subjektit) ka blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. apartamentin me sip. 100.83 m<sup>2</sup>, me çmim 44.000 euro. *Afati i vendosur për disbursimin e kredisë bankare me qëllim shlyerjen e vlerës së apartamentit është data 10.2.2015.*
- Pasuria është regjistruar në emër të shtetasit Y.P., në datën 21.11.2014. Nga kartela e pasurisë lëshuar në datën 3.12.2014 rezulton se pasuria është bllokuar në favor të palës shitëse “\*\*\*\*” sh.p.k. (për shkak se nuk ishte likuiduar tërësisht çmimi i shitjes). Pas pagesës së çmimit kontraktor, administratori i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me deklaratë noteriale datë 4.3.2015 ka lejuar ZVRPP-në të fshijë çdo hipotekë dhe inskriptim mbi pasurinë<sup>57</sup>.
- ASHK-ja ka konfirmuar<sup>58</sup> se shtetasi Y.P., figuron pronar në pasurinë e llojit “apartament” me sip. 100.83 m<sup>2</sup>, nr. pasurie “\*\*\*\*”.
- Në përgjigje të pyetësorit standard, në datën 4.12.2020, subjekti ka deklaruar: *“Në periudhën 26.12.2014 deri tani kam banuar në apartamentin i cili ndodhet në rr. “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*”, shk. “\*\*\*\*”, ap. “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*”. Ky apartament është në pronësi të shtetasit Y.P., i cili është vëllai im. Gjatë kësaj kohe kam qëndruar në apartament pa kundërshtim ose qira”.*
- Në DPV-në e vitit 2015, 2016 dhe në deklaratën *Vetting* është deklaruar adresa e kësaj pasurie si adresë vendqëndrimi tjetër.
- Në DPV-në e vitit 2016 është deklaruar tek pasuritë e personit të lidhur, në zotërim 100% të tij, në vlerën 44.000 euro.
- Në DPV-të e viteve 2017, 2018 dhe 2019 subjekti ka deklaruar si adresë vendqëndrimi tjetër adresën e kësaj pasurie.
- Në përgjigje të pyetësorit nr. 10 subjekti ka deklaruar se në periudhën 26.12.2014 deri në shkurt të vitit 2022 ka banuar në adresën rrugën “\*\*\*\*”, banesë në pronësi të vëllait, që është adresë e kësaj pasurie.
- Nga verifikimet e kryera në drejtim të ekzistencës së ndonjë konflikti të mundshëm interesi të subjektit për shkak të detyrës së tij me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe/ose përfaqësuesit ligjorë dhe ortakët e shoqërisë, prokuroritë ku subjekti ka ushtruar detyrën (prokuroritë pranë

<sup>55</sup> Shihni aktet në aneksin nr. 4/7, 28, 38 dhe 31 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>56</sup> Kjo kontratë është veprim juridik me kusht dhe përmbushja e saj varet nga vërtetimi i kushtit: miratimi dhe disbursimi i kredisë bankare.

<sup>57</sup> Deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 4.3.2015, para noteres G.S.

<sup>58</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 3.2.2021 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 4.2.2021).

gjykatave të shkallës së parë Kukës<sup>59</sup>, Lezhë<sup>60</sup>, Shkodër<sup>61</sup> e Tiranë<sup>62</sup>, konfirmuan se subjekti nuk ka hetuar çështje ku të kenë qenë pjesëmarrës me çfarëdolloj cilësie personat si më lart.

- Ndërsa duke iu referuar vlerave mesatare të tregut të shitblerjes së tregut të lirë për vitin 2014 të EKB-së, ku çmimi mesatar për Tiranën është 89.125 lekë/m<sup>2</sup>, rezulton se për apartamentin me sipërfaqe 112.98 m<sup>2</sup> vlera e referencës është 10.069.343 lekë. Pra vëllai i subjektit e ka blerë 44.000 euro ~ 6.164.840 lekë ose 0.4 herë më lirë sesa vlera mesatare e tregut.

**37.3** Bazuar në sa më sipër, u vërtetua se pasuria është blerë dhe regjistruar në emër të vëllait të subjektit, z. Y.P., dhe subjekti ka banuar duke deklaruar saktësisht dhe rregullisht adresën e banimit në këtë banesë nga viti 2015 deri në vitin 2022 (kur deklaroi nisjen e bashkëjetesës me znj. E.Sh., në një apartament në pronësi të bashkëjetueses, trajtuar në vijim).

**37.4** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjekti iu kërkua të japë sqarime në lidhje me konstatimin se vëllai i subjektit, person i lidhur sipas nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, e ka blerë 44.000 euro ~ 6.164.840 lekë ose 0.4 herë më lirë sesa vlera mesatare e tregut. Në parashtrimet e tij, subjekti i kërkoi Komisionit që në vlerësimin e tij të mbajë në konsideratë zonën kadastrale ku ndodhet pasuria, e cila sipas tij nuk duhet të trajtohet me referencat e qytetit të Tiranës por si zonë jashtë tij. Për këtë qëllim, ai ka paraqitur një relacion teknik “*Mbi sqarimin e çmimit të referencës, për pasurinë nr. “\*\*\*\*”, apartament me sipërfaqe 100.83 m<sup>2</sup>, e regjistruar në vol. “\*\*\*\*”, faqe “\*\*\*\*”, z. k. “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*”, në emër të shtetasit Y. P...”, të hartuar nga ekspertja L.B. Sipas këtij raporti z. k. “\*\*\*\*” ku ndodhet pasuria përfshihet në zonën e “\*\*\*\*”, që kategorizohet në zonën nr. “\*\*\*\*” të Tiranës sipas Bashkisë Tiranë. Pra në udhëzim nr. 2, datë 6.8.2014, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2014”, kjo zonë ka vlerën e referencës 65.000 lekë/m<sup>2</sup>. Gjithashtu, subjekti ka përcjellë edhe 4 kontrata të ngjashme, në të njëjtën ndërtesë dhe në të njëjtën periudhë kohe të blerjes si prej vëllait të tij.*

**37.5** Në vlerësim të sqarimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, Komisioni rilogariti çmimin e blerjes në raport me çmimet e referencës, nga ku rezultoi se sipas kësaj reference apartamenti i vëllait të subjektit ka vlerën e referencës prej 7.343.700 lekësh, ndërsa vlera e blerë prej tij është 6.164.840 lekë. Pra, çmimi i blerjes është rreth 0.16 herë më pak. Ndërkohë, nga evidentimi i çmimit të 4 kontratave të paraqitura nga subjekti, rezulton se edhe ato janë shitur me çmime të përafërta ose edhe më pak se vlera që e ka blerë vëllai i subjektit. Në këto kushte, nisur edhe nga zona ku ndodhet pasuria, një zonë periferike e qytetit të Tiranës, që referuar të dhënave publike ka qenë një zonë me infrastrukturë jo të zhvilluar në vitin 2014, në përfundim, Komisioni çmon se çmimi i blerjes së apartamentit nuk rezulton të jetë një çmim preferencial. Për më tepër nuk u evidentuan raste të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës me shitësin e pasurisë.

**37.6** Në lidhje me likuidimin e çmimit të shitjes dhe burimin e të ardhurave, u konstatua se:

Çmimi i shitjes është likuiduar edhe në mënyrën e parashikuar në kontratën me datë 10.11.2014, e cila parashikon se:

i) Kësti i parë 8.800 euro do të derdhet në llogarinë e noteres pranë “Raiffeisen Bank” brenda datës 20.11.2014. Likuidimi i këtij kësti është bërë në datën datën 12.11.2014, kur është depozituar në “Alpha Bank” nga shtetasi Y.P., në llogarinë e noteres, me përshkrimin “Y. P., derdh nga kursimet familjare”. Në datën 11.12.2014 kjo shumë është tërhequr nga llogaria e noteres G.Sh., dhe është depozituar në datën 12.12.2014 pranë “Alpha Bank” për llogari të

<sup>59</sup> Nr. “\*\*\*\*” prot., datë 2.9.2021 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 7.9.2021).

<sup>60</sup> Nr. “\*\*\*\*” prot., datë 4.8.2021 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 6.8.2021).

<sup>61</sup> Nr. “\*\*\*\*” prot., datë 7.9.2021 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 10.9.2021).

<sup>62</sup> Nr. “\*\*\*\*” prot., datë 10.9.2021 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 13.9.2021).

shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Sipas deklarimeve të subjektit dhe personit të lidhur ndër vite, deklarimeve pranë ILDKPKI-së në vitin 2016, në deklaratën *Vetting* dhe deklaratimet gjatë procesit të rivlerësimit, shuma e këstit të parë prej 8.800 euro e ka burimin në të ardhura/kursime familjare të deklaruara si gjendje *cash* në DPFD-në e vitit 2013 nga subjekti në shumën 20.000.000 lekë.

ii) Kësti i dytë në masën 35.200 euro do të paguhet përmes një kredie bankare të miratuar dhe disbursuar nga një nga bankat e nivelit të dytë.

### **37.7 Në lidhje me kredinë nga aktet në dosje<sup>63</sup>, rezulton se:**

- Në datën 24.12.2014 është lidhur kontratë kredie bankare nr. “\*\*\*\*” dhe hipoteke midis “Raiffeisen Bank” (kredidhënës) dhe shtetasit Y.P., (kredimarrës) e shtetasit Ylli Pjetërnikaj (bashkëkredimarrës), me objekt shumën 4.500.000 lekë, me qëllim përdorimin për blerje shtëpie. Në DIPP-në e vitit 2015 te seksioni “Të dhënat konfidenciale” deklaroi se: “*Jam bashkëkredimarrës me vëllain tim në kredinë e marrë në shumën 4.500.000 lekë në ‘Raiffeisen Bank’. Qëllimi i marrjes së kredisë është për blerje apartamenti nga vëllai im, shlyerjet e kësaj kredie bëhen po nga vëllai*”.

- Shuma e kredisë prej 4.500.000 lekësh është disbursuar në llogari të shtetasit Y.P., në datën 19.1.2015 në “Raiffeisen Bank”<sup>64</sup>. Kjo vlerë është transferuar në llogarinë e noteres G.Sh., brenda së njëjtës ditë, datë 19.1.2015, me përshkrim “kalim kësti i II për blerje shtëpie”. Në datën 26.1.2015, shuma prej 32.028 euro ka kaluar nga llogaria e noteres në llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

### **37.8 Sa i takon deklarimeve në lidhje me blerjen e pasurisë apartament objekt verifikimi, vërehet se:**

- Në DPV-në për vitin 2014 nuk janë kryer deklarime për apartamentin e blerë në dhjetor të këtij viti.

- Në DPV-në për vitet 2015 dhe 2016 është deklaruar apartamenti dhe burimi i krijimit me të ardhura familjare dhe kredinë.

- Në deklaratën *Vetting* subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar këtë apartament me burim vetëm të ardhura të akumuluar ndër vite nga familja, por nuk kanë deklaruar kredinë si burim.

- Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me mosdeklarimin e apartamentit të blerë nga vëllai i tij në DPV-në e vitit 2014 dhe mosdeklarimin e kredisë si burim krijimi në deklaratën *Vetting*. Në parashtrimet e tij subjekti ka sqaruar se në DPV-në e vitit 2014 nuk ka deklaruar blerjen e apartamentit nga ana e vëllait Y.P., pasi ai nuk klasifikohet në rrethin e personave të lidhur me subjektin deklarues. Sipas tij vetëm në vitin 2016, rrethi i personave të lidhur u ndryshua duke përfshirë çdo person të përmendur në certifikatën familjare. Më tej, ai ka shpjeguar se nga marrja e detyrës për herë të parë në datën 13.11.2013 deri në datën 18.8.2017 ka qenë në certifikatë familjare me vëllain Y.P. Gjatë kësaj periudhe, pavarësisht certifikatës familjare, ai nuk e ka konsideruar vëllain Y.P., si person të lidhur, mbështetur në legjislacionin në fuqi. Sipas subjektit, deklaratimet për të janë bërë vetëm për shkak të cilësisë si bashkëkredimarrës në kredi, prandaj në deklaratën periodike të vitit 2016 janë deklaruar ndryshimet e pasurisë për personin e lidhur Y.P., gjatë këtij viti. Ky deklaram është bërë për të sqaruar se kredia e marrë nga vëllai, në të cilën subjekti ishte bashkëkredimarrës, është shlyer në vitin 2016. Ndërsa në lidhje me mosdeklarimin e kredisë si burim krijimi në deklaratën *Vetting*, subjekti ka sqaruar se kjo ka ndodhur për shkak se kredia ishte shlyer përpara datës së deklaramit të deklaratës *Vetting* në datën 25.1.2017. Sipas subjektit, burimi i krijimit të apartamentit në thelb janë të ardhurat e familjes bujqësore, të cilat kanë shërbyer si burim për shlyerjen e kredisë.

<sup>63</sup> Shihni aktet në aneksin nr. 4.7 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>64</sup> Shkresë e “Raiffeisen Bank” nr. “\*\*\*\*” prot., datë 17.12.2020.



Në analizë të argumenteve të subjektit, Komisioni vlerëson se:

**a.** Në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, vëllai i subjektit nuk ka qenë person i lidhur me detyrim deklarimi në vitet 2014 dhe 2015. Nga ana tjetër, ky apartament ka qenë një pasuri në përdorim të subjektit dhe, si e tillë, vlerësohet se ka qenë e mjaftueshme për t’u konsideruar si detyrim i përmbushur, deklarimi rregullisht dhe saktësisht si adresë vendbanimi i kësaj pasurie nga ana e subjektit. Ndërkohë, blerja e apartamentit është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2015 dhe vëllai i tij si person i lidhur në DPV-në e vitit 2016.

**b.** Sa i takon mosdeklarimit e kredisë si burim në deklaratën *Vetting*, edhe pse Komisioni e vlerëson te drejte argumentin sipas të cilit burimi i krijimit të apartamentit në thelb janë të ardhurat e familjes bujqësore të cilat kanë shërbyer si burim për shlyerjen e kredisë, subjekti ka pasur detyrimin të deklaronte në deklaratën *Vetting* burimin e krijimit të pasurive ashtu siç kanë qenë faktikisht, për rrjedhojë duhet të deklaronte edhe kredinë si burim. Në këto rrethana duket se ka pasaktësi në deklaratën *Vetting*. Megjithatë, në vlerësimin përfundimtar të çështjes, në konsiderate të faktit që në DPV-në për vitet 2015 dhe 2016 subjekti dhe personi i lidhur e kanë deklaruar shprehimisht kredinë e marrë me qëllim për blerje apartamenti nga shtetasi Y.P., mosdeklarimi i kredisë specifikisht si burim më vete në deklaratën *Vetting* nuk ka qenë me qëllim fshehjen e ndonjë fakti apo rrethane dhe për këtë arsye, nuk u konsiderua si shkak për penalizim të subjektit.

### **37.8 Sa i takon likuidimit të kredisë nga ana e vëllait të subjektit Ylli Pjetërnikaj, u konstatua se:**

- Sipas të dhënave të “Raiffeisen Bank”<sup>65</sup>, kredia është mbyllur në datën 6.6.2016 nga derdhja *cash* e vlerës 4.500.000 lekë e shtetasi Y.P., me përshkrimin “*derdh për mbyllje kredie të ardhurat e familjes*”. Mbyllja e kredisë është deklaruar nga personi i lidhur në DPV-në e vitit 2016 nga kursimet e dhëna nga familja.

- Gjatë procesit të rivlerësimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi burimin e derdhjes *cash* në vlerën 4.500.000 lekë për mbylljen e kredisë në datën 6.6.2016 nga shtetasi Y.P., i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 4 deklaroi se sipas shpjegimeve të vëllait, për shkak të kushteve familjare në të cilat ai ndodhej, për mbylljen e kredisë kanë shërbyer të ardhura të familjes bujqësore. Në vijim, i referohet kursimeve *cash* të deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2013, si dhe të ardhurave të fermës për vitet 2015 dhe 2016 prej 1.900.000 lekësh.

- Megjithatë, ka qënë e paqartë përse personi i lidhur ka marrë kredi në dhjetor të vitit 2014, ndërkohë që ai dhe subjekti kanë pasur kursime familjare me burim gjendjen *cash* të deklaruar në DPFD-në e vitit 2013. Edhe te ardhurat nga ferma për vitet 2015 dhe 2016, sikurse rezultoi në përfundim të hetimit administrativ, kane qene te paqarta. Kështu, mbetet i paqartë burimi i shumës 4.500.000 lekë paguar *cash* në qershor të vitit 2016 nga personi i lidhur Y.P., për shlyerjen e parakohshme të kredisë. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me konstatimet e mësipërme.

- Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se shuma e mbetur *cash* me të ardhurat nga ferma (deklaruar si likujditet në DPFD 2013) në muajt e fundit të vitit 2014 nuk mjaftonte për të blerë apartamentin. Në këto kushte, sipas tij, aplikimi për kredi ishte e vetmja mënyrë. Në vijim, subjekti vijon të deklarojë se burimi i krijimit të shumës 4.500.000 lekë, me të cilën vëllai i tij ka shlyer kredinë, është pjesërisht shuma e deklaruar si gjendje *cash* në vitin 2013 në vlerën 20.000.000 lekë (nga e cila 50% ka qenë në bashkëpronësi të tij dhe vëllait Ylli Pjetërnikaj), me burim të ardhurat e fermës deri në këtë vit dhe pjesërisht të ardhurat nga ferma në vitet 2015 dhe 2016 në vlerën 1.900.000 lekë. Për të mbështetur këto deklarime subjekti vijon të japë të njëjtat argumente dhe i referohet dokumenteve shkresore në lidhje me të ardhurat nga bujqësia e blegtoria të paraqitura në parashtrimet për pasuritë banesë dhe stallat në fshatin “\*\*\*”,

<sup>65</sup> Shkresa e “Raiffeisen Bank” nr. “\*\*\*” prot., datë 17.12.2020.

Tropojë, trajtuar më sipër, si dhe raportit të vlerësimit të datës 28.12.2019, të ekspertes L.B., paraqitur bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, sipas të cilit të ardhurat nga ferma për vitet 2015 dhe 2016 kanë qenë në vlerën 3.956.600 lekë.

- Në përfundim të procesit, Komisioni çmon se situata e gjendjes *cash* (të deklaruar në DPF 2013) mbetur në fund të vitit 2014 kur është marrë kredia është e paqartë dhe mbetet objektivist e papërcaktuar për sa kohë në DPF-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar një likuiditet në *cash* të të gjithë familjes. Po kështu, është fakt që në vitin 2014 kur është marrë kredia, janë kryer pakësime të pjesës takuese të subjektit dhe vëllait të tij prej 10.000.000 lekësh për investimin në banesën në bashkëpronësi, blerjen e një automjeti nga subjekti apo shpenzime mobilimi të banesës së vëllait, të cilat gjithashtu janë deklaruar me burim likuiditetin në *cash* me të ardhura nga ferma. Në këto kushte, Komisioni gjendet në pamundësi për të konkluduar nëse të ardhurat nga ferma në fund të vitit 2014 kanë qenë të tilla që të evitohet marrja e një kredie nga personi i lidhur për blerjen e apartamentit. Ndërsa, sa i takon të ardhurave familjare siguruar nga ferma gjatë viteve 2015 dhe 2016, pavarësisht faktit se nuk u provua masa konkrete e këtyre të ardhurave, Komisioni nuk mund të arrijë në përfundimin se familja bujqësore nga e cila subjekti ishte shkëputur që në vitin 2013 nuk ka siguruar të ardhura në këto vite.

**37.9** Por, pavarësisht sa më sipër, me qëllim një vlerësim sa më objektiv në lidhje me të ardhura që kanë shërbyer për shlyerjen e menjehershme të kredisë nga personi i lidhur Y.P., në datën 6.6.2016, Komisioni nuk mund të anashkalonte provat e rrethanat si vijojnë:

- Sipas deklaratës noteriale nr. “\*\*\*”, datë 6.5.2016, paraqitur nga subjekti me deklaratën *Vetting*, deklaruesit A.P., (vëllai i subjektit) dhe N.J., (bashkëshorti i motrës së subjektit), deklarojnë se shuma 5.000.000 lekë është dhënë hua nga shtetasi A.P., shtetasit N.J., në muajin mars 2013 për aktivitetin si person fizik këtij të fundit dhe se kjo shumë i është kthyer *cash* në dorë shtetasit A.P., në datën 28.4.2016.

- Në DPF-në e vitit 2013, krahas deklarimeve për likuiditetin në *cash* krijuar ndër vite nga puna dhe ferma në vlerën 20.000.000 lekë, subjekti është shprehur “*dokumente justifikuese: kontratë huaje*”, deklarim i cili përbën një provë që huaja e marrë dhe e dhënë sipas deklaratës së sipërpërmendur nuk është një “sajesë” e subjektit me qëllim të paracaktuar dhe vetëm për efekt të deklaratës *Vetting*. Ndërkohë në sqarimet e në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka dhënë sqarime të detajuara në lidhje me këtë hua, dhënë nga familjarët e tij shtetasit N.J., në vitin 2003, duke deklaruar se për këtë hua nuk është nënshkruar një kontratë formale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me huamarrësin. Gjithashtu, subjekti nënvizon faktin se likuiditeti në *cash* i deklaruar në vitin 2013 prej 20.000.000 lekësh, nuk ka qenë fizikisht i gjithi në disponim të familjarëve të tij për shkak se shuma prej 5.000.000 lekësh i ishte dhënë hua shtetasit N.J.

- Sipas deklaratës noteriale nr. “\*\*\*”, datë 6.5.2016, në datën 28.4.2016 shtetasi N.J., ka shlyer huan në vlerën 5.000.000 lekë. Në datën 6.6.2016, pra rreth një muaj pas, vëllai i subjektit, z. Y.P., ka shlyer kredinë pranë “Raiffeisen Bank” në shumën 4.500.000 lekë, fakt që tregon se huaja e kthyer nga shtetasi N.J., (e cila ka qenë pjesë e likuiditetit *cash* deklaruar në vitin 2013 në vlerën 20.000.000 lekë me të ardhurat nga ferma) mund të ketë shërbyer edhe për shlyerjen e kredisë. Ndonëse subjekti nuk e ka ngritur një pretendim të tillë, ai në mënyrë të vijueshme ka këmbëngulur se për shlyerjen e kredisë kanë shërbyer të ardhura nga ferma. Ky fakt është konstatuar edhe nga ILDKPKI-ja, që në raportin e saj është shprehur: “*Nga kontrata e huas e paraqitur gjykoheq që shlyerja e kredisë të jetë bërë me shumën e kthyer të huadhënies vëllait A.P.,*”.

Në një vlerësim tërësor të rrethanave të sipërpërmendura, Komisioni çmon se ka vend për të gjykuar që huaja e kthyer prej shtetasit N.J., në datën 28.4.2016 ka shërbyer për të shlyer kredinë në vlerën 5.000.000 lekë në datën 6.6.2016 nga personi i lidhur Y.P. Gjithashtu, Komisioni vlerëson pozitivisht faktin që subjekti në deklaratën *Vetting* ka paraqitur deklaratën

noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 6.5.2016, ndonëse nuk ka kryer deklaramë në lidhje me huan apo kthimin e saj, për shkak se ai vetë personalisht nuk ka pasur lidhje me këtë hua (trajtuar në këtë paragraf dhe në paragrafin 44.4 të këtij vendimi).

**37.10.** Në deklaratën *Vetting* vëllai i subjektit Ylli Pjetërnikaj ka deklaruar: “*Mobilimi i apartamentit është bërë me të ardhurat e familjes, të grumbulluara ndër vite nga punësimi i anëtarëve të familjes, si dhe të ardhurat nga ferma. Këto të ardhura na janë dhënë mua dhe vëllait tim Ylli Pjetërnikaj nga familja në vitin 2013. Vlera: 2.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100%*”. Duke qenë se në përfundim të hetimit administrativ nuk u morën në konsideratë të ardhurat nga ferma, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me burimin e të ardhurave për mobilimin e apartamentit nga personi i lidhur, si dhe mbi mosdeklarimin e shpenzimeve të mobilimit në DPV-në e viteve 2014 – 2016. Në parashtrimet e tij subjekti ka deklaruar se ai nuk i ka deklaruar shpenzimet për mobilimin e apartamentit, pasi vëllai i tij nuk konsiderohet person i lidhur në kuptim të ligjit, pretendim i cili është i bazuar. Ndërsa në lidhje me burimin e shpenzimeve të mobilimit nga personi i lidhur, subjekti vijon të këmbëngulë se kanë shërbyer të ardhura nga ferma, deklaruar si likuiditet *cash* në DPFD-në e vitit 2013, në pjesë takuese 50% së bashku me vëllain e tij Y.P.

**37.11** Në përfundim të procesit, në një vlerësim tërësor të rrethanave arsyetuar si më sipër, Komisioni nuk ka pasur dyshime në lidhje me pasurinë objekt verifikimi për të cilën subjekti ka qenë koherent në deklaratimet periodike vjetore, deklaratën *Vetting* e në vijim, si dhe, krijoi bindjen se e vetmja lidhje e tij me këtë pasuri ka qenë bashkëpërdorimi me vëllain e tij binjak dhe pronarin e pasurisë Y.P., që nga viti 2015 (pas blerjes në muajin nëntor të vitit 2014) deri në vitin 2022 kur ka filluar të jetojë me bashkëjetuesen E.SH., deklaruar rregullisht prej tij sipas ligjit si adresë tjetër vendqëndrimi. Për më tepër, u vërtetua që menjëherë pas martesës së Y. P., kjo pasuri është përdorur për banim familjarisht prej tij, si vetmja pasuri e paluajtshme e tij<sup>66</sup>.

**38.** Pasuria *Garazh me kod “\*\*\*\*”, me sip. 15.50 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie “\*\*\*\*”, vol. “\*\*\*\*”, faqe “\*\*\*\*”, z. k. “\*\*\*\*”, adresa “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”*. Të ardhurat për blerjen e këtij garazhi janë dhënë nga shtetasja V. Ç., bashkëjetuesja (bashkëlidhur do të gjeni edhe mandatin e arkës me nr. veprimi “\*\*\*\*”). Vlera: 5.000 euro. Pjesa takuese: 100%. ILDKPKI-ja në lidhje me këtë pasuri ka konstatuar: Mungesë deklarimi e burimit financiar të shtetasës V.Ç., për blerjen e garazhit në emër të shtetasit Y.P., me vlerë 5.000 euro, si dhe e dokumentacionit justifikues ligjor lidhur me të.

## Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

**38.1** Nga dokumentacioni i paraqitur prej ASHK-së<sup>67</sup> konstatohet se:

- Me kontratë shitjeje nr. “\*\*\*\*”, datë 5.10.2016, është blerë pasuria garazh nga shtetasi Y. P., prej shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me çmim 5.000 euro, i cili do të derdhet në llogarinë bankare të noterit në “Alpha Bank”<sup>68</sup>. Nuk rezultoi që subjekti të ketë shqyrtuar çështje me palë pjesëmarrëse shoqërinë shitëse dhe/ose përfaqësuesit ligjorë apo ortakët e saj.
- Sipas mandatit bankar “depozitim për të tretë”, shtetasja V.C., në datën 14.10.2016 derdh në llogarinë e noterës G.Sh., pranë “Raiffeisen Bank”, shumën 5.000 euro.
- ASHK-ja ka konfirmuar<sup>69</sup> se shtetasi Y. P., figuron pronar në pasurinë e llojit “garazh” me sip. 15.5 m<sup>2</sup> me nr. pasurie “\*\*\*\*” dhe është regjistruar në datën 8.11.2016.

<sup>66</sup> Shih shkresat kthim përgjigje nga ASHK në dosjen e Komisionit

<sup>67</sup> Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. “\*\*\*\*” prot., datë 3.2.2021 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 4.2.2021).

<sup>68</sup> Nga përmbajtja e kësaj kontrate vërehet se noteri i ka informuar palët se çmimi kontraktor është më i ulët se çmimi minimal fiskal, si dhe për diferencën negative dhe palët kanë deklaruar se çmimi i deklaruar prej tyre përbën marrëveshjen e vërtetë të tyre dhe aplikimi i çmimeve të shitjes më të ulëta se minimali fiskal i përcaktuar me akte nënligjore është kushtëzuar nga ulja e ofertës dhe e mundësive për shitje. Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën e personit të lidhur njësoj si në deklaratën *Vetting*.

<sup>69</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 3.2.2021 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 4.2.2021).

**38.2** Në lidhje me burimin e krijimit, në deklaratën *Vetting* si burim krijimi të kësaj pasurie janë deklaruar të ardhurat nga shtetasja V.C. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, nëse pagesa e kryer nga shtetasja V.C., është bërë në kuadrin e një marrëdhënieje huaje apo dhurimi, subjekti sqaroi se<sup>70</sup> *vëllai i tij Y. P., bashkëjeton me shtetasen V.Ç., që nga dhjetori i vitit 2014 e në vijim. Ata kanë një fëmijë 5 vjeç së bashku dhe kanë jetuar bashkë që në momentin e marrjes në dorëzim të apartamentit. Ai ka shpjeguar se pavarësisht faktit që nuk kanë bërë një martesë formale, janë një familje dhe kanë pasuri të përbashkët të krijuar me kontributin e secilit prej tyre. Sipas tij pagesa e çmimit të garazhit nga bashkëjetuesja dhe nënshkrimi i kontratës nga Y.P., është rrjedhojë e një koordinimi familjar me njëri-tjetrin dhe është pasuri e tyre e përbashkët. Meqenëse ata janë një familje, nuk i kanë kushtuar rëndësi se në emër të kujt është regjistruar pasuria.*

**38.3** Në lidhje me burimin e krijimit të vlerës 5.000 euro, subjekti deklaroi se *pagesa e bërë nga shtetasja V.C., është kryer nëpërmjet transaksionit bankar të datës 14.10.2016 në llogarinë e saj bankare. Në këtë llogari ajo ka pasur të depozituar shumën 1.891.250 lekë që nga data 28.10.2009. Nga komunikimi me “Raiffeisen Bank”<sup>71</sup> rezultoi se, në datën 14.10.2016 shtetasja V.C., ka tërhequr nga llogaria e saj vlerën 651.297 lekë (ose 4.815 euro)<sup>72</sup>. Kjo vlerë duket se është pjesë e vlerës së transferuar në datën 27.10.2009 nga nëna e saj V.C., prej 1.891.250 lekësh, me përshkrimin “transferte për depozitë”, e cila daton që në vitin 2005.*

## **GJETJE TË TJERA**

**39.** Nga deklaratimet e vëllait të subjektit, z. Y.P., të administruara në dosjen e ILDKPKI-së, u konstatua se ai nuk ka kryer deklarime të pjesës së tij takuese në bashkëpronësi në shtëpinë e banimit në Tropojë, si dhe në të ardhurat nga ferma. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi. Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se vëllai i tij nuk konsiderohet subjekt i lidhur në kuptim të ligjit. Ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar pasuritë e tij të krijuara gjatë periudhës së vlerësimit 2013 – 2016. Më tej ai ka sqaruar se vëllai i tij është bërë vetë subjekt deklarues në vitin 2019 ku ka deklaruar pjesën takuese prej 1/10 në shtëpinë në Tropojë, tokën arë, kafshët me pjesë takuese 25%, apartamentin dhe garazhin në Tiranë me pjesë takuese 100%, si dhe pjesën e tyre takuese. Në mbështetje të pretendimeve të tij subjekti ka paraqitur deklaratën e vëllait Y.P., të vitit 2019. Në vlerësim të sqarimeve të subjektit, bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, persona të lidhur që mbartin detyrimin për deklarim janë bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë. Në këtë kuptim, vëllai i subjektit nuk ka qenë person i lidhur i ngarkuar me detyrimin për deklarim.

**40.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si adresë të gjendjes civile adresën *Njësia Administrative Nr. “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”, p. “\*\*\*\*”, shk. “\*\*\*\*”, ap. “\*\*\*\*”, Tiranë*, ndërsa si adresë banimi ka deklaruar *\*\*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, p. “\*\*\*\*”, shk. “\*\*\*\*”, ap. “\*\*\*\*”*. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit u konstatua se këto adresa i ka deklaruar nga DPV-ja e vitit 2015 e në vazhdim, deri në DPV-në e vitit 2018 (edhe në DPV-në e viteve 2019 dhe 2020). Në përgjigje të pyetësorit standard, ka deklaruar se në periudhën 13.11.2013 – 1.12.2013, pasi ka ardhur në Tiranë, ka banuar në adresën në rrugën *“\*\*\*\*”*, ku pronarë të apartamentit kanë qenë shtetasit V., dhe V.Ç., me të cilët vëllai i tij Y.P., ka lidhur kontratë qiraje në datën 30.4.2013<sup>73</sup>. Më pas ka banuar në *\*\*\*\** në banesën e vëllait. Më tej ai ka shpjeguar se në datën 20.5.2013 kanë bërë zhvendosjen e gjendjes civile nga Tropoja në Tiranë ku kanë deklaruar si

<sup>70</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

<sup>71</sup> Shkresë e “Raiffeisen Bank” nr. “\*\*\*\*” prot., datë 17.12.2020.

<sup>72</sup> BOA kursi i këmbimit mesatar i vitit 2016 lekë/euro është 135.27.

<sup>73</sup> Kontratë nr. “\*\*\*\*” rep., datë 30.4.2013, noter S.M.

adresë banimi banesën e marrë me qira si më sipër, e cila ka ngelur si e tillë edhe në vijim, edhe pas qëndrimit të tij në apartamentin e vëllait në “\*\*\*\*”. Mosndryshimi i kësaj adrese, sipas shpjegimeve, ka ndodhur sepse nuk i është kushtuar rëndësi një fakti të tillë, për sa kohë edhe qëndrimi me vëllain në një banesë është i përkohshëm dhe gjatë kësaj kohe nuk ka pasur apartament në pronësi që ta deklaronte si adresë banimi. Në përfundim të hetimit administrativ, nuk rezultuan problematika në lidhje me këtë adresë.

**41.** Në përgjigjet e pyetësorit standard subjekti ka deklaruar: “*Në periudhën 1.12.2013 deri më 26.12.2014 kam banuar në adresën: rruga “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*”, hyrja “\*\*\*\*”, apartamenti “\*\*\*\*”, Njësia Administrative Nr. “\*\*\*\*”, Tiranë. Pronari i këtij apartamenti ka qenë shtetasi T.Tj. Me këtë shtetas është lidhur kontrata e qirasë, me shkresë të thjeshtë. Kontrata ka qenë me afat të përcaktuar. Qiraja ishte në shumën prej 30.000 lekësh në muaj, e cila është paguar nga ana ime*”<sup>74</sup>. Gjatë hetimit administrativ u kryen verifikime<sup>75</sup> në lidhje me pronësinë e kësaj pasurie, nga ku rezultoi se në periudhën e marrjes me qira ka qenë në pronësi të shtetasit T. T., blerë nga pronari i mëparshëm Z.C. Në përfundim të hetimit administrativ nuk rezultuan problematika e dyshime në lidhje me këtë pasuri.

**42.** Nga vëzhgimi i llogarive bankare të z. Y.P., rezulton se në datën 16.7.2014, në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank” është transferuar vlera 1.500.000 lekë nga znj. L.P., me përshkrimin “*ia japim hua kunatit për sistemim banese*”. Gjatë hetimit administrativ, subjektit iu kërkua të japë sqarime e të provojë me dokumentacion burimin e ligjshëm të vlerës së dhënë hua z. Y. P., nga znj. L.P. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, subjekti sqaroi se qëllimi i transfertës së kësaj shume nga kjo shtetase në llogari të vëllait të tij (subjekti ka dhënë sqarime të detajuara edhe për burimin e ligjshëm të saj) ka qenë përdorimi i tyre si kapar për blerjen e një apartamenti nga shtetasi Y.P., por meqenëse marrëveshja nuk u arrit, kjo shumë iu kthye përsëri asaj. Për të vërtetuar këtë fakt ka paraqitur një *statement* bankar të shtetases Lirie Pjetërnikaj dhe deklaratë noteriale të shtetases A.B. Nga verifikimi i këtyre akteve rezultoi se:

- Shtetasja A.B., në deklaratën noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 23.12.2021, shprehet se shuma i është dhënë asaj *cash* nga shtetasi Y.P., në datën 18.7.2014 si kapar për blerjen e apartamentit të një të afërmi të saj. Në deklaratën noteriale ajo shprehet se palët nuk arritën të binin dakord prandaj shuma e mbajtur *cash* në banesën e saj ia ka dhënë djalit të saj, z. A. B., i cili ka bërë kalimin në llogarinë e shtetases L.P., brenda muajit korrik të vitit 2014.

- Nga *statementi* bankar i llogarisë së znj. L.P., rezulton se në datën 16.7.2014 ajo ka depozituar *cash* vlerën 1.500.000 lekë në llogarinë e saj dhe brenda ditës e ka transferuar këtë shumë në llogarinë e z. Y.P. Ndërsa në datën 29.7.2014 shtetasi A.B., (djali i A.B.) ka derdhur në llogarinë e saj vlerën 1.500.000 lekë, me përshkrimin “shlyerje borxhi”.

**43.** Nga verifikimi i të dhënave pranë RNSH-së nuk u gjenden veprime të dyshimta për të cilat nevojiteshin veprime të mëtejshme hetimore. Po kështu janë verifikuar udhëtimet sipas sistemit TIMS dhe nuk ka pasur të dhëna nga organet ligjzbatuese për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me personat me të cilët ka udhëtuar. Ndërsa, nga të dhënat e regjistrit të gjendjes civile<sup>76</sup> rezulton se në përbërjen familjare të subjektit ka qenë edhe vëllai i tij A. P., i cili ka ndryshuar emrin nga A., në A., dhe nga A., në A. Lidhur me këtë fakt subjektit iu kërkua të japë shpjegime të shoqëruara me dokumentacion mbi kohën dhe arsyen e ndryshimit të emrit (dy herë) nga personi në fjalë. Nga sqarimet e dhëna në përgjigje të pyetësorit nr. 4 dhe dokumentacioni i paraqitur rezultoi se: shtetasi A.P., ka ndryshuar emrin me vendim të Këshillit të Komunës “\*\*\*\*” në vitin 1997 nga “A.” në “A.” dhe e ka rikthyer emrin nga Zyra e Gjendjes Civile në vitin 2004 nga “A.” në “A.” dhe se këto ndryshime janë diktuar nga

<sup>74</sup> Bashkëlidhur ka depozituar kontratën e qirasë dhe deklaratën noteriale të shtetasit T.T., me nr. “\*\*\*\*”, datë 27.11.2020.

<sup>75</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 4.

<sup>76</sup> Certifikata për përbërjen familjare nga viti 1993 deri më 3.6.2010, dërguar nga subjekti bashkëlidhur pyetësorit nr. 2.

gabimet e institucioneve arsimore, ku për herë të parë në dokumentet shkollore është regjistruar me emrin A., ndërkohë që në dokumentet e gjendjes civile figuronte me emrin A., sikurse njihet nga komuniteti. Nga të dhënat konfidenciale të organeve ligjzbatuese, nuk evidentohen të dhëna për veprimtari të kundërligjshme të A./A.P.

#### **44. Në lidhje me gjendjen *cash***

**44.1** Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit konstatohet se: në DPFĐ-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar: “*Vlerë cash, të krijuara ndër vite nga puna dhe ferma. Vlera: 20.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Ndërsa në sqarimet e dhëna pranë ILDKPKI-së të datës 31.3.2016, ka deklaruar: “Nga kjo shumë, unë me vëllain tim shtetasin Y.P., kemi trashëguar gjysmën. Me anë të këtyre parave ne kemi blerë në vitin 2015 një apartament banimi në Tiranë, i cili është regjistruar në emër të shtetasit Y. P. Gjithashtu, kemi blerë një mjet tip ‘Golf’ në vlerë 4 mijë euro deklaruar nga ana ime në DPV/2014, si dhe kemi bërë disa punime tek banesa në Tropojë në vlerën prej 2.100.000 lekësh”*”. Siç vërehet ka një mospërputhje në deklarime pasi në DPFĐ subjekti ka deklaruar 50% të shumës 20.000.000 lekë ndërsa në deklarimet pranë ILDKPKI-së duket se pjesa e tij takuese është 25% ose 5.000.000 lekë.

**44.2** Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë mospërputhje. Në parashtrimet e tij subjekti ka parashtruar se sikurse ka deklaruar pranë ILDKPKI-së në datën 31.3.2016, ai dhe vëllai Y.P., në pjesë ideale të painedividualizuar kishin 50% të shumës së vlerës *cash*. Pra secili nga 4 vëllezërit kishte në pjesë ideale 25% të saj. Sipas tij, meqenëse vëllai Y.P., ishte në certifikate familjare dhe jetonte me subjektin, likuiditeti prej 20.000.000 lekësh është deklaruar duke nënkuptuar pjesën 50% ne bashkëpronësi të tij dhe Vëllait Y., dhe pjesën 50% ne bashkëpronësi të vëllezërve A., dhe A.P. Pra, subjekti qartëson se ai ka pasur vetëm 25% të kursimeve të deklaruara si pjesë ideale e likuiditetit në *cash* prej 20.000.000 lekësh, qëndrim i mbajtur edhe gjatë pyetjes pranë ILDKPKI-së në procesverbalin e datës 31.3.2016. Referuar këtij procesverbal si dhe duke marrë ne konsideratë edhe faktin që pjesa takuese e secilit prej bashkëpronarëve në pasurinë objekt verifikimi është 25%, Komisioni vlerëson se deklarimet e subjektit janë bindëse dhe se pjesa 50% e deklaruar në DPFĐ-në e vitit 2013, ka qenë në bashkëpronësi të subjektit dhe vëllait të tij Y.P., të cilët kane pasur 25% ose 5.000.000 lekë secili.

**44.3** Në asnjë prej DPV-ve të mëpashme për vitet 2014, 2015 dhe 2016, subjekti nuk ka deklaruar ndryshime si shtesa, pakësime apo gjendje likuiditeti në *cash*. Edhe në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi mosdeklarimin e pakësimit të gjendjes *cash* në vitin 2014, subjekti theksoi edhe një herë se shuma e deklaruar në deklaratën e fillimit të detyrës ishte arritur të grumbullohej ndër vite nga të ardhurat e familjes bujqësore, dhe se, ai nuk ka kontribuar në krijimin e saj. Në dhjetor të vitit 2014, duke e konsideruar veten të shkëputur nga ferma e të ardhurat e saj, ai nuk ka deklaruar ndryshime ndër vite. Kjo ka qenë sipas tij arsyeja që në DPV-në e vitit 2014 ka deklaruar vetëm ato shpenzime që prekin pjesën e tij takuese, sikurse është rikonstruksioni i shtëpisë së banimit në fshat dhe blerjen e automjetit në shumën 4.000 euro. Megjithatë, prej tij është pranuar që viti 2014 ka qenë viti i parë i deklarimit të tij dhe nuk kanë qenë të trajnuar apo udhëzuar, kanë ekzistuar edhe paqartësi në plotësimin e deklaratës, të cilat janë sqaruar edhe në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së. Në përfundim, deklarimet e subjektit konsiderohen bindëse në konsideratë edhe te faktit që në deklaratën *Vetting* e në vijim, nuk deklaruar gjendje likuiditeti në *cash* si dhe nuk është vertetuar që subjekti të ketë kryer investime me burim të ardhura familjare nga ferma.

**44.4** Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me konstatimin se nuk ka kryer deklarime në deklaratën e vitit 2016 dhe atë *Vetting* në lidhje me likuiditetin në *cash* për shkak të kthimit të huas prej 5.000.000 lekësh nga shtetasi N.J. Në parashtrimet e tij subjekti deklaroi se nuk ka kontribuar në krijimin e kësaj shume pasi nuk e ka administruar, individualizuar, poseduar apo gëzuar personalisht.

Ndodhur në këtë situatë faktike dhe juridike, pas emërimit të tij në dhjetor të vitit 2014, duke e konsideruar veten të shkëputur nga ferma, nga aktiviteti i saj, nga të ardhurat e saj, nuk ka deklaruar ndryshimet ndër vite, përderisa pjesa e tij takuese nuk ka ndryshuar. Kjo ka qenë arsyeja që nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2016 shumën e huas të kthyer nga kunati, shtetasi N.J. Sipas subjektit, shuma e huas e kthyer nga shtetasi N. J., vëllezërve A. P., dhe A., (A.,) Pjetërnikaj nuk ka rritur apo ndryshuar pjesën e tij takuese. Ai, duke marrë në konsideratë sqarimet e bëra nga dokumenti deklaratë noteriale nr. “\*\*\*”, datë 6.5.2016, nuk e ka deklaruar më huan për shkak se ajo ishte shlyer tek familjaret e tij përpara datës së deklarimit 25.1.2017, si dhe ajo shumë lidhej me pjesët takuese të vëllezërve A., dhe A.P. Në vlerësim të sqarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në përfundim të procesit, Komisioni i vlerësoi bindëse argumentet e subjektit, duke çmuar se ai nuk ka pasur asnjë lidhje me huan në vlerën 5.000.000 lekë e cila i është kthyer vëllezërve të tij nga shtetasi N.J., përpara plotësimit të deklaratës *Vetting*. Për më tepër, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* deklaratën noteriale nr. “\*\*\*”, datë 6.5.2016, e cila konfirmon marrëdhënien e huas midis këtij shtetasi dhe vëllait të subjektit.

#### **Analiza financiare për periudhën në detyrë, nëntor 2013 – 2016 dhe vlerësimi i Komisionit**

**45.** Në përfundim të hetimit administrativ me ndihmën e Njesisë së Shërbimit Ligjor, është kryer analiza financiare, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, nga ku duket se ka një balancë negative të vitit 2014 në vlerën 2.125.845 lekë për të përballuar pasuritë dhe shpenzimet, e cila vjen për shkak të moskonsiderimit të pjesës takuese të subjektit në investimin për vitin 2014 në vlerën 2.100.000 leke me të ardhura të ligjshme.

<b>Përshkrimi</b>	<b>13-11-13</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
<b>PASURI</b>	<b>(276)</b>	<b>2,521,510</b>	<b>(20,196)</b>	<b>345</b>
Shtëpi banimi me sip. 460 m2 dhe ndërtesat e përdorura për bagëti në afërsi të banesës me sip. 140 m2 & 40 m2, e ndodhur në fshatin J* S*, T*, në bashkëpronësi me familjarët e tjerë. Pjesa takuese 25%.		2,141,294		
Tokë arë me sip. 24 dynym e 690 m2, e përfutuar me ligjin nr. 7501 datë 19.07.1991, fshati J* S*, Nj. Ad. Ll*, T*. Pjesa takuese 30%.				
Tokë livadh me sip. 1,000 m2 fshati Sh*, Nj. Adm. Ll*, kontrate me kusht, me shkresë të thjeshtë. Pjesa takuese 100%				
Automjet tip P* 307, me targë A*, blerë me kontratë nr.* rep., nr.* kol., dt.*. Cmimi i paguar nga te ardhurat e familjes, 4,000 euro. Ky automjet përdoret nga vëllai i subjektit. Pjesa takuese 100%				
Automjet tip V*, me targë A*, blerë me kontratë nr.* rep., nr.* kol., dt.*. Cmimi i paguar nga te ardhurat e familjes të akumuluar ndër vite, të deklaruar në ILDKPKI në vitin 2013. Pjesa takuese 100%		560,440		
150 krrerë dele, të krijuara nga viti 1990 nga prindërit dhe vëllezërit, të ndodhura në fshatin "J* S*", Nj. Adm. Ll*. Pjesa takuese 50%				
5 lopë të krijuara nga viti 1990 nga prindërit dhe vëllezërit, të cilat ndodhen në fshatin "J* S*" Nj. Adm. Ll*. Pjesa takuese 25%.				
Bletë 56 koshere, të krijuara nga viti 1990 nga prindërit dhe vëllezërit, të cilat ndodhen në fshatin "J* S*" Nj. Adm. Ll*. Pjesa takuese 25%.				
Gëlqere, 50 m3, e trashëguar, e krijuar në vitin 2004, e cila ndodhet në fshatin "J* S*" Nj. Adm. Ll*. Pjesa takuese 25%				
Apartament me sip. 112.98 m2, me nr. Pasurie *, zk *, adresa Y*, rr. "T* D*", në përdorim të subjektit por në pronësi të vëllait të tij. Blerë nga diferenca e të ardhurave të akumuluar ndër vite nga familja, pas rikonstruksionit dhe blerjes së mjetit V*.				
Garazh me sip. 15.5 m2 me nr. Pasurie *, zk * të ndodhur në Y*. Në pronësi të vëllait, z. Y* P*.				
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë dhe CASH	-276	-180,224	-20,196	345
Gjendje kursimesh cash	-	-	-	-
Total likuiditete	455	-179,769	-199,965	-199,620
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>158,000</b>	<b>539,077</b>	<b>(73,081)</b>
Kredi bankare në shumën 988,000 lekë sipas kontratës së kredisë bankare të datës *.		0		
Kredi bankare në shumën 500,000 lekë sipas kontratës së kredisë bankare të datës *.			447,968	(52,898)
Kredi bankare në shumën 92,990 lekë sipas kontratës së kredisë bankare të datës *; shlyer në datë *. Perdorur për blerje telefoni ne N*.			81,109	(20,183)
Derdhje nga E* Sh* në llog e Y* P* ne R*		38,000	10,000	
Derdhje nga V* C* në llog e Y* P* ne R*		120,000		
<b>PASURI NETO</b>	<b>(276)</b>	<b>2,363,510</b>	<b>(559,272)</b>	<b>73,426</b>
<b>TË ARDHURA dokumentuar</b>	<b>103,201</b>	<b>958,581</b>	<b>1,283,255</b>	<b>1,192,296</b>
Të ardhura të subjektit nga paga si pedagog në Fakultetin e Drejtësisë për vitin 2014 dhe 2016			217,669	188,376
Të ardhura si autor shkrimi në revistën juridike, në shkollën e Magistraturës për vitin 2015			23,562	
Paga si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, nga data 08.11.2013-03.12.2014	103,201	899,100		
Paga si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, nga data 03.12.2014-31.12.2016		59,481	1,042,024	1,003,920
Të ardhura si bashkëautor në botime shkencore me shtëpinë botuese "Fan Noli" për vitet 2011-2013				
Të ardhura nga ferma dhe nga bashkëfamiljarët e tij. Pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit 25%.				
<b>SHPENZIME</b>	<b>68,479</b>	<b>720,916</b>	<b>463,888</b>	<b>353,922</b>
Shuma e transferuar në llogarinë e vëllait Y* P* dt.* dhe dt.*.		32,000	140,000	
Shpenzime qeraje për apartamentin në pronësi të z. T* T*, në vlerë 30.000 leke/muaj, për periudhën 01.12.2013-26.12.2014.	30,000	360,000		
Shpenzime interesi për kredinë 988,000 lekë prane R*		30,283		
Shpenzime interesi për kredinë 500,000 lekë prane R*			33,692	51,777
Shpenzime interesi për kredinë 92,990 lekë prane R*			8,959	11,077
Shpenzime jetese	23,504	219,998	224,276	235,092
Shpenzime udhëtimi	14,975	78,636	56,961	55,976
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>34,998</b>	<b>-2,125,845</b>	<b>1,378,640</b>	<b>764,948</b>

**45.1** Në lidhje me të ardhurat nga ferma të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e likuiditetit në cash prej 20.000.000 lekësh deklaruar në DPFDP të vitit 2013 me pjesë takuese 50%, likuiditet i përdorur për investimin në në pjesën takuese të subjektit prej 2.100.000 leke, edhe në përfundim të procesit Komisioni ndodhet në të njëjtat kushte e rrethana sikurse është gjendur gjatë hetimit administrativ. Por, gjatë procesit të vendimarrjes, Komisioni çmoi që në



vlerësimin përfundimtar të peshës specifike që ka balanca negative prej 2.125.845 lekë sipas standardit kushtetues të parashikuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të shpjegimit bindshëm të pasurisë, duhet të udhëhiqet edhe nga parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit referuar nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 si dhe jurisprudencës së KPA në disa prej vendimeve të tij. Konkretisht në vendimin nr. “\*\*\*\*”, dt.17.03.2022 që i përket subjektit H. K., KPA shprehet se *kjo dispozitë ligjore obligon organet e rivlerësimit që në mënyrë diskrecionale, por të arsyetuar e shpjeguar, të shqyrtojnë procesin e rivlerësimit të një subjekti duke konsideruar zbatimin e këtyre parimeve të së drejtës administrative të aplikueshme.*

**45.2** Në këto kushte, bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat e rezultuara gjatë procesit të rivlerësimit analizuar hollesisht në këtë vendim veç e veç dhe në tërësi, e duke u krahasuar me deklaratimet e subjektit apo aktet shkresore të administruara, në respektim të plote të:

(i) nenit 14 të Kodit të Procedurave Administrativ që sanksionon parimin e objektivitetit, sipas të cilit *gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe u japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative;*

(ii) nenit 12 të Kodit të Procedurave Administrative që sanksionon parimin e proporcionalitetit, i cili parashikon ndër të tjera se *veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe është i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj si dhe në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.*

Komisioni çmon se është rasti tipik ku lind arsyeshem nevoja për konsiderimin e balancës negative prej 2.125.845 lekë, nën dritën e këtyre parimeve, balancë e cila ka ardhur për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të vërtetojë në mënyrë të plotë e konkrete të ardhurat e ligjshme të familjes së origjinës nga bujqësia dhe blegtoaria deklaruar si gjendje *cash* në DPFDF 2013.

**45.3** Në përfundim të procesit Komisioni çmoi se balanca negative prej prej 2.125.845 lekë nuk mund të çojë në penalizim të subjektit të rivlerësimit, arsyetuar si vijon:

**Së pari**, referuar të dhënave që vërtetojnë ushtrimin e aktivitetit bujqësor e blegtoral të familjes bujqësore (trajtuar në mënyrë të detajuar në paragrafët 26 – 26/11 të këtij vendimi) si:

(i) vetëpunësimet në bujqësi të anëtarëve të familjes të cilët kanë realizuar të ardhura nga ferma bujqësore;

(ii) subvencionet që shteti i ka dhënë familjes bujqësore;

(iii) faktin që mungesa e pagimit të taksës së tokës deri në vitin 2014 nuk ka qenë për shkak të subjektit apo familjarëve të tij;

(iv) faktin që vetëm pas vitit 2014 në legjislacion u përfshi skema e rimbursimit e TVSH-së për fermerin nëpërmjet së cilës fermerët kërkonin rimbursim të TVSH-së duke deklaruar të ardhurat nga shitjet e tyre;

(v) anëtarët e familjes nuk kanë qenë subjekte deklaruese që mbartnin detyrimin e deklarimeve në lidhje me investimet dhe të ardhura të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e tyre;

Komisioni nuk mund të arrijë në përfundimin që familja bujqësore ka krijuar me të ardhura të paligjshme likuiditetin *cash* në vlerën 20.000.000 lekë deklaruar nga subjekti në DPFDF-në e vitit 2013, në pjesë takuese 50 %, e cila siç rezultoi nga hetimi ka qenë në bashkëpronësi me vëllain e tij Y.P., (shih arsyetimin në paragrafët 44/1 dhe 44/2 të vendimit).

**Së dyti**, likuiditeti i deklaruar në DPFDF-në e vitit 2013 me burim të ardhurat nga ferma, është krijuar ndër vite kur subjekti nuk ka qenë në detyrë dhe as subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, pasi në pjesën më të madhe të kohës ka qenë i mitur (në vitin 2005 ka mbushur 18 vjeç), ndërkohë që në periudhën 2006 – 2010 ka ndjekur studimet e larta, e më pas ka vijuar Shkollën e Magjistraturës deri kur është diplomuar në vitin 2014. Pra, gjatë gjithë periudhës që janë përfutuar të ardhura për krijimin e likuiditetit prej 20.000.000

lekësh, subjekti ka qenë i mitur, nxënës, student e, në këto kushte, përjashtohet çdo mundësi përfitimi e kësaj shume për shkak të ndonjë aktiviteti të paligjshëm të tij. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë të dhënë nga organet ligjzbatuese apo të dhëna nga cilido burim tjetër për veprime të kundërligjshme të subjektit, të tilla që do të krijonin dyshime për investime të subjektit në pasuri me të ardhura të paligjshme gjatë vitit 2014, dhe jo vetëm.

**Së treti**, likuiditeti prej 20.000.000 lekësh deklaruar në DPF-D-në e vitit 2013 nuk është deklaruar dhe nuk është përdorur si burim për krijimin e ndonjë pasurie të subjektit të rivlerësimit me përjashtim të një autoveture të blerë në vitin 2014 në vlerën 4.000 euro dhe investimeve për rikonstruksionin e banesës ku subjekti është bashkëpronar në ¼ e saj, në vlerën 2.100.000 lekë. Edhe në deklaratat në vijim pas plotësimit të deklaratës *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar pasuri të tjera të luajtshme, të paluajtshme, apo likuiditete, me burim krijimi nga të ardhurat e fermës.

**Së katërti**, sa i takon banesës me adresë në fshatin “\*\*\*\*” Tropojë, të cilës i përket dhe pjesa më e madhe e investimit gjatë vitit 2014 në vlerën 2.100.000 lekë, në përfundim të procesit nga ana e Komisionit nuk ka pasur dyshime, referuar fakteve dhe rrethanave si vijojnë:

(i) Pas hetimeve të thelluara në lidhje me origjinën dhe ndërtimin e banesës dhe dy stallave të bagëtive, u vërtetua që subjekti është bashkëpronar me ¼ pjesë të pandarë të pasurisë (deklaruar saktësisht në deklaratën *vetting*) si pjesëtar i familjes Pjetërnikaj dhe jo si përfitues primar i pronësisë/bashkëpronësisë. Pavarësisht kësaj, në konsideratë të detyrimeve ligjore, subjekti ka kryer deklarime në DPF-D 2003, DPV për vitin 2014 dhe atë *vetting* në lidhje me këtë pasuri e cila u vërtetua të jete përfituar në mënyrë të ligjshme nëpërmjet procedurave të legalizimit.

(ii) deklarimet e subjektit gjatë procesit kanë qenë në koherencë të plotë me deklarimet vjetore dhe ato pranë ILDKPKI-së, dhe në çdo rast subjekti ka bërë përpjekje maksimale për të sqaruar në mënyrë shteruese paqartësitë dhe pasaktësitë e evidentuara për shkak të vetë kompleksitetit të çështjes sa i takon pjesës së tij takuese, sipërfaqeve të investimeve sipas periudhave përkatëse dhe vlerës se tyre (arsyetuar hollësisht në këtë vendim).

(iii) Nuk u evidentuan veprime juridike të çdo lloji, si marrëveshje, kontrata noteriale ose jo, apo transaksione bankare, që të lidhin subjektin e rivlerësimit me objektet pjesë përbërëse e pasurisë.

(iv) Në vitin 2014 kur është kryer dhe deklaruar rikonstruksioni i banesës dhe është viti i parë që subjekti ka qenë në detyrë, ai nuk banonte në pasurinë objekt verifikimi pasi u vërtetua që fizikisht është larguar në mënyrë të përhershme nga fshati “\*\*\*\*” Tropojë me fillimin e detyrës si prokuror në dhjetor të vitit 2013, ndërkohë që në muajin prill 2013 është shkëputur dhe ligjërisht nga trangu familjar së bashku me vëllain e tij Y.P., me të cilin u vërtetua të ketë banuar në apartamentin e tij në Tiranë, duke kryer deklarime të sakta në lidhje me përdorimin e kësaj pasurie dhe adresës së banimit. Për më tepër, nuk ka të dhëna që pasuria në fshatin “\*\*\*\*” Tropoje të jetë përdorur me ndonjë destinacion tjetër përveç atij për banim nga familjarë të subjektit, sikurse është konfirmuar edhe nga kryeplaku i fshatit “\*\*\*\*”, Njësia Administrative “\*\*\*\*”.

Për rrjedhojë, në lidhje me banesën dhe dy godinat/stalla bagëtish në fshatin “\*\*\*\*” Tropojë, nuk janë evidentuar deklarime të pasakta me pasojë fshehjen e qëllimshme të ndonjë fakti e rrethane.

**Së pesti**, nuk ka pasur dyshime sa i takon investimit tjetër prej 4000 eurosh po gjatë vitit 2014 për blerjen e një autoveture Volsvagen deklaruar në DPV për vitin 2014, pasi nga analiza financiare e vitit 2014, ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të tij të ligjshme për blerjen e këtij mjeti.

**45.4** Në përfundim, bazuar në sa më sipër Komisioni krijoi bindjen se nuk ka dyshime për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo deklarime të reme me qëllim fshehje të të ardhurave të paligjshme të përdorura si burim në investime, dhe as veprime që çenojnë besimin e tij në publik. Për të arritur në këtë përfundim, Komisioni i është referuar edhe qëndrimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) S vs Albania, në paragrafin 96 të cilit, ndër të tjera citohet: “...gjykata vlerëson se në bazë të një vlerësimi të përgjithshëm të rrethanave të veçanta të çështjes, shkarkimi i kërkueses, bazuar në thelb në faktin se ajo nuk ishte në gjendje të provonte se burri i saj kishte paguar tatimin mbi disa nga të ardhurat e tij nga aktivitetet e ligjshme në dy dekadat e mëparshme dhe në mungesë të ndonjë treguesi për keqbesim ose shkelje të qëllimshme nga vetë aplikanti, ishin në disproporcion me qëllimet legjitime të ndjekura nga procesi i verifikimit”.

**45.5** Për pasojë, Komisioni krijoi bindjen se balanca negative prej 2 125 845 lekësh dhe shkaqet që e kanë shkaktuar atë nuk çenojnë qëllimin e ligjit 44/2016, sipas të cilit, nëpërmjet deklarimeve ndër vite dhe në atë *Vetting*, synohet të evidentohen subjekte që kanë fshehur pasuri apo kanë krijuar pasuri me të ardhura të dyshimta. Si e tillë, kjo balancë nuk mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit Pjetërnikaj, si një masë e nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj, si dhe, për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

### **Metodologjia e kryerjes së analizës financiare**

**46.** Për efekt të pasqyrimin të metodologjisë së ndjekur, trajtuar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni në analizën financiare është bazuar në dokumentacionin e administruar dhe të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja, deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, deklaratat *Vetting*, pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe korrespondenca e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike, duke marë në konsideratë:

- Të ardhurat e ligjshme të subjektit sipas vërtetimeve për të ardhurat *neto* dërguar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ.
- Shpenzimet pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ.
- Gjendjen e likuiditeteve<sup>77</sup> në banka, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

### **Kontrolli i figurës**

**47.** DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2006. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. “\*\*\*\*” prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Ylli N., Pjetërnikaj, i deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. “\*\*\*\*”, datë 5.2.2017. Sipas raportit, subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj: (i) ka plotësuar në mënyrë të plotë, të saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) për të nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të kimit të organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Ylli N., Pjetërnikaj.

<sup>77</sup> Shkresë e “Raiffeisen Bank” nr. “\*\*\*\*” prot., datë 17.12.2020.

## Hetimi i Komisionit

**48.** Komisioni, në vijim, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Konkretisht:

- Pas kërkimit të përditësimit të informacionit, institucionet ligjzbatuese nuk kanë evidentuar të dhëna për subjektin e rivlerësimit.

- Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë<sup>78</sup> informacionin e ardhur nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para, nga të cilat rezultoi se për subjektin e rivlerësimit ishin regjistruar tri kallëzime penale, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Konkretisht, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ishin regjistruar materialet hetimore si më poshtë<sup>79</sup>:

**a.** Materiali hetimor nr. “\*\*\*\*” i vitit 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal<sup>80</sup>, për të cilin Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në datën 30.1.2018 ka vendosur për mosfillimin e procedimit penal. Ndaj vendimit të mosfillimit është ushtruar ankim dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur<sup>81</sup> mospranimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të mosfillimit. Nga ana e ankuesit është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>82</sup>.

**b.** Materiali hetimor nr. “\*\*\*\*” i vitit 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për të cilin Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 8.2.2019 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti nuk përbën veprë penale. Ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nuk është ushtruar ankim<sup>83</sup>.

**c.** Materiali hetimor nr. “\*\*\*\*” i vitit 2017, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për të cilin Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 11.9.2017 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ndaj vendimit të mosfillimit është ushtruar ankim nga ana e kallëzuesit dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur mospranimin e kërkesës së kërkesit, si të pabazuar në ligj<sup>84</sup>. Ndaj këtij vendimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila ka vendosur lënien e tij në fuqi<sup>85</sup>. Edhe ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës është ushtruar rekurs dhe aktualisht çështja gjyqësore ndodhet për shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë<sup>86</sup>.

- SPAK-u informoi<sup>87</sup> se nuk rezulton që në emër të subjektit Ylli Pjetërnikaj të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Ndaj tij është regjistruar kallëzimi nr. “\*\*\*\*” i vitit 2017 dhe në lidhje me këtë kallëzim, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, në datën

<sup>78</sup> Me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 8.7.2021 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 12.8.2021).

<sup>79</sup> Shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. “\*\*\*\*” prot., datë 23.6.2021 (pjesë e shkresave të përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme).

<sup>80</sup> Shpërdorimi i detyrës. Kallëzues R.V.

<sup>81</sup> Vendimi nr. “\*\*\*\*”, datë 18.7.2019.

<sup>82</sup> Me vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 7.2.2020.

<sup>83</sup> Shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. “\*\*\*\*” prot., datë 8.2.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 10.2.2022).

<sup>84</sup> Me vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 23.11.2017, vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 28.1.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 3.2.2022).

<sup>85</sup> Referuar shënimit në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, vendosur në dispozicion nga kjo gjykatë, me shkresën si më lart. Vendimi i Gjykatës së Apelit mban nr. “\*\*\*\*”, datë 17.1.2018.

<sup>86</sup> Informacion i dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 28.1.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 3.2.2022).

<sup>87</sup> Me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 9.6.2021 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 10.6.2021).

13.2.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ndaj vendimit të mosfillimit nuk rezulton të jetë ushtruar ankim<sup>88</sup>.

- Nga hetimi nuk u gjet ndonjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Në përfundim të procesit, Komisioni, në kushtet që nga hetimi i kryer: (i) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (ii) nuk u evidentuan rrethana që cenonin figurën e subjektit sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës – çmon se subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të gërmës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

### **Vlerësimi i aftësive profesionale**

**49.** Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj, bazuar në: (i) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 20.7.2018; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **Raporti për analizimin e aftësive profesionale kryer nga KLP-ja**

**50.** Raporti është hartuar bazuar në: formularin e vetëvlerësimit profesional; tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëvlerësimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; pesë dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënat nga burimet arkivore. Në përfundim, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, ka vlerësuar pozitivisht subjektin e rivlerësimit në lidhje me:

### **Aftësitë profesionale**

#### *a) Njohuritë ligjore*

Subjekti shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit. Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret. Kështu, menjëherë pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre. Ai identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme.

#### *b) Arsyetimi ligjor*

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë prokurori dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme. Tek aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se nga ana e tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit dhe provat e mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore.

### **Aftësitë organizative**

#### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Nga analiza e 5 çështjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i subjektit është brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit

<sup>88</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 2.3.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 3.3.2022.

procedural penal, Kushtetutës dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurori, subjekt rivlerësimi, ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet.

#### *b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Ylli Pjetërnikaj, merr pjesë në gjykim si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

#### *c) Aftësia për të administruar dosjet*

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe disponimin e gjykatës.

### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### *a) Etika në punë*

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

#### *b) Integriteti*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

#### *c) Paanësia*

Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit dhe nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak të dokumentuar, që vënë në dyshim paanësinë. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

### **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### *a) Aftësitë e komunikimit*

Nga 3 dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosjet e rëna në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

#### *b) Aftësia për të bashkëpunuar*

Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve të këtij raporti, nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë.

#### *c) Gatishmëria për t'u angazhuar*

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t'u angazhuar, subjekti Ylli Pjetërnikaj rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, të cilat janë përshkruar më sipër.

### **Informacioni i marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar:**

**51.** Tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të dhënat arkivore të administruara nga KLP-ja, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLP-ja në raportin e saj dhe nuk ka pasur nevojë për hetime të mëtejshme si dhe informacion i marrë nga denoncimet e publikut.

## Denoncimet nga publiku

**52.** Ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar 23 denoncime (disa prej të cilëve nga i njëjti person për të njëjtën çështje ose për çështje të ndryshme) dhe një denoncim i paraqitur pranë ONM-së. Referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, janë kryer verifikime për denoncimet si vijojnë:

### Denoncime nga shtetasja E.C.<sup>89</sup>

**53.** Në denoncimin e saj kjo shtetase informon se është kreditore në favor të së cilës është lëshuar një urdhërezekutimi me debitor shtetasin Xh.B. Ajo ka informuar se me kallëzimin penal nr. “\*\*\*\*”, datë 27.8.2019, ka kërkuar ndjekjen penale për shtetasin Xh.B., për veprën penale “kanosje për shkak të detyrës”, duke ngritur pretendime se prokurori Ylli Pjetërnikaj ka vendosur mosfillimin e procedimit penal pa kryer hetime të plota dhe se ky vendim nuk i është dërguar asaj por i është dërguar përmbarueses.

**53.1** Me qëllim verifikimit e këtyre pretendimeve, gjatë hetimit administrativ u administrua informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>90</sup>, nga ku u evidentuan vendimmarrjet e organit të akuzës dhe gjykatës pas administrimit të kallëzimit penal. Nga analiza e akteve të administruara në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se:

- Në lidhje me pretendimin se vendimi i mosfillimit duhet t’i ishte drejtuar kreditorës (pra denoncueses) dhe jo përmbarueses gjyqësore, u konstatua se ky pretendim nuk qëndron, pasi kallëzimi penal është bërë nga përmbaruesja, ndaj dhe vendimi i mosfillimit i është dërguar asaj, konform pikës 2 të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale.

- Në lidhje me pretendimin për moskryerje hetimesh, nga analiza e akteve të dosjes penale u konstatua që subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, vendim i cili është prishur nga gjykata duke urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore të mëtejshme, ku në fund të këtyre hetimeve i kallëzuarit është marrë në përgjegjësi penale.

**53.2** Në vijim të procesit të rivlerësimit, subjektit iu kërkuar të japë sqarime mbi mungesën e hetimeve nga ana e tij dhe rrethanat që çuan në ndryshimin e qëndrimit të tij në lidhje me shtetasin Xh.B. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 10 subjekti sqaroi se ka vendosur brenda afatit 15-ditor mosfillimin e procedimit penal. Sipas tij, gjatë këtij afati nuk kryhen veprime hetimore, por vetëm verifikuese, dhe deklaroi se prej tij duke qenë se veprimet e pretenduara si kanosje nuk përbëjnë elementet e figurës së veprës penale “kanosje për shkak të detyrës”, nuk është vlerësuar kryerja e veprimeve të tjera verifikuese. Ndërkaq, pasi gjykata e ka shfuqizuar këtë vendim, procedimi penal nr. “\*\*\*\*” është regjistruar nga organi i akuzës për veprën penale “pengime për ekzekutimin e vendimit të gjykatës”. Në përfundim të hetimit është kërkuar dërgimi për gjykim për këtë veprë penale, por subjekti thekson se shkak i akuzës përbëhet nga fakte të tjera që nuk kanë qenë objekt vendimmarrjeje nga ana e tij, ndërsa për veprat penale të fyerjes dhe të kanosjes për shkak të detyrës është mbajtur i njëjti qëndrim nga prokurori në vijim.

**53.3** Në përfundim të hetimit administrativ, pavarësisht shpjegimeve të dhëna nga subjekti, me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkuar të japë sqarime në lidhje me faktin se nuk ishin kryer veprime hetimore në lidhje me kallëzimin penal nr. “\*\*\*\*”, datë 27.8.2019, me qëllim evidentimin e elementeve të veprës penale “pengime për ekzekutimin e vendimit të gjykatës”, që sikurse ka rezultuar nga ecuria e mëtejshme e procedimit, kanë qenë të domosdoshme, duke çuar në gjykimin e të kallëzuarit.

---

<sup>89</sup> Denoncime nr. “\*\*\*\*” prot., datë 10.12.2019; nr. “\*\*\*\*” prot., datë 18.11.2019; dhe nr. “\*\*\*\*” prot., datë 12.12.2019, nga shtetasja E.C.

<sup>90</sup> Shkresat nr. “\*\*\*\*” prot., datë 15.2.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 17.2.2022) dhe nr. “\*\*\*\*” prot., datë 8.3.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 8.3.2022).

**53.4** Në parashtrimet e tij, ashtu sikurse edhe në deklaratimet gjatë hetimit administrativ, subjekti ka kundërshtuar këtë konstatim, duke sqaruar se nga aktet procedurale të administruara deri në atë moment procedural, nuk është pretenduar apo paraqitur provë ose *indicie* që shtetasi Xh. B., të ketë penguar ekzekutimin e detyrimit, pra nuk ishin ngritur pretendime lidhur me figurën e veprës penale “pengime për ekzekutimin e vendimit të gjykatës”, parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal, ndërkohë që gjykata gjatë shqyrtimit të ankimit ka marrë në vlerësim edhe pretendime të tjera të ngritura nga palët.

**53.5** Në analizë të sqarimeve të subjektit, referuar kallëzimit penal të përmbarueses, vërehet se ajo ka bërë kallëzim penal për veprën “kanosje për shkak të detyrës” dhe i vetmi pretendim i paraqitur përpara prokurorit deri në vendimin e mosfillimit të procedimit penal ka qenë ai për veprën penale “kanosje për shkak të detyrës”. Megjithatë, nga përmbajtja e kallëzimit penal vërehet se në të kallëzuesja ka përshkruar fakte e rrethana mbi procedurën e përmbarimit me ekzekutim vullnetar, me palë kreditoren E.C., debitor Xh.B., dhe përmbaruesen gjyqësore F.I., çka mund të shërbente si *indicie* për të kryer verifikime të mëtejshme mbi shkakun që i kishte çuar drejt konfliktit këta shtetas. Nga ana tjetër, subjekti me të drejtë pretendon se brenda afatit 15-ditor, afat gjatë të cilit kryen vetëm veprime verifikuese, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me veprën e kallëzuar, duke mos u vlerësuar kryerja e veprimeve të tjera verifikuese. Për më tepër, u vërtetua që për veprat penale të fyerjes dhe kanosjes për shkak të detyrës, është mbajtur i njëjti qëndrim nga prokurori në vijim.

**53.6** Pavarësisht sa më sipër, në përfundim të procesit çmohet se vlerësimi nga Komisioni i rrethanave që mund të çonin subjektin drejt identifikimit të elementeve të një tjetër vepre penale të ndryshme nga ajo e kallëzuar, do të zëvendësonte logjikën e prokurorit dhe bindjen e tij të brendshme, ndërkohë që sipas nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” *vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektesinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet, qëndrim i cili është mbajtur edhe nga KPA*<sup>91</sup>.

#### **Denoncim nga shtetasja S.Sh.**<sup>92</sup>

**54.** Në këtë denoncim, denoncuesja ngrinte pretendime se subjekti i rivlerësimit nuk kishte kryer veprime hetimore lidhur me afatin e përfundimit të hetimeve dhe nuk ishte njoftuar në lidhje me ecurinë e kallëzimit të paraqitur prej saj në vitin 2017 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kundër Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shtetases G.P., për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”<sup>93</sup>.

<sup>91</sup> Shihni vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 23.10.2020, të Kolegjit për subjektin F.V., sipas së cilit: “*Kolegji çmon se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky lidhet me vlerësimin e çmimin e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit*”. Në rastin konkret, pikërisht vlerësimi i aftësive profesionale të magjistratit, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjyqësore përkatëse, duke arsyetuar mbi provat e të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit, prandaj edhe Kolegji vlerëson se konkluzioni se subjekti ka dhënë një zgjidhje të gabuar, duke deklaruar pafajësinë e njërit prej të gjykuarve, është një konkluzion në tejkalim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk mund të përdoret për të kryer vlerësimin e tij.

<sup>92</sup> Denoncimet nr. “\*\*\*\*” prot., datë 23.1.2018 dhe nr. “\*\*\*\*” prot., datë 4.5.2018.

<sup>93</sup> Denoncuesja (kallëzuesja) ka qenë punonjëse pranë Ministrisë së Financave dhe pasi asaj i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka vendosur: (i) detyrimin e palës së paditur Ministria e Financave që ta transferojë paditësen në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtë kategori; dhe (ii) detyrimin e palës së paditur Ministria e Financave t’i paguajë pagën e këtij pozicioni prej datës 8.12.2013 e në vazhdim. Paditësja, nëpërmjet përmbaruesit gjyqësor, ka kërkuar ekzekutimin e këtij vendimi gjykate të bërë titull ekzekutiv dhe përmbaruesi gjyqësor ka kryer veprimet përmbarimore për ekzekutimin e tij. Meqenëse vendimi nuk është ekzekutuar, përmbaruesja ka depozituar kallëzimin penal të sipërpërmendur ndaj Sekretares së Përgjithshme të kësaj Ministrie.



**54.1** Me qëllim verifikimin e këtyre pretendimeve, gjatë hetimit administrativ u administrua nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë fashikulli i procedimit penal<sup>94</sup>, ku u evidentuan veprimet procedurale të kryera nga subjekti që nga data 24.7.2017, kur ka regjistruar procedimin penal nr. “\*\*\*\*”, datë 24.7.2017, për veprën penale “pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës” e deri kur është zëvendësuar nga një prokuror tjetër, si dhe kërkesat/ankesat e kallëzueses S.Sh.

**54.2** Në përfundim të hetimit administrativ, nga analiza e akteve të dosjes penale duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë vendim për kërkesat e kallëzueses dhe nuk i ka kthyer përgjigje në ndonjë formë tjetër. Po kështu, nuk ka kryer asnjë veprim hetimor të dokumentuar në dosje. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime e të paraqesë dokumente në lidhje me këto konstatime.

**54.3** Në parashtrimet e tij, subjekti ka përshkruar të gjitha veprimet që kanë rezultuar nga aktet e fashikullit të procedimit penal (të kryera prej tij si prokuror i çështjes deri në dhjetor të vitit 2017 kur ka dorëzuar dosjen), konkretisht si vijojnë:

- në zbatim të urdhrin të prokurorit janë pyetur nga OPGJ-ja shtetaset G.P., dhe S.Sh.;
- në datën 14.7.2017 OPGJ-ja me anë të procesverbalit për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve ka administruar dosjen përmbartimore nr. “\*\*\*\*”, datë 3.4.2015, me palë Ministria e Financave dhe shtetasja S.Sh.;
- në datën 26.7.2017 nga OPGJ-ja është administruar shkresa nr. “\*\*\*\*” prot., e Ministrisë, me masat e marra për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë;
- në datën 18.7.2017 me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., OPGJ ka administruar praktikën e mbajtur nga Ministria e Financave lidhur me ecurinë e çështjes me paditëse S.Sh.;
- në datën 6.11.2017 OPGJ me anë të procesverbalit të këqyrjes dhe marrjes së dokumenteve ka administruar praktikën e mbajtur nga Ministria e Financave për ekzekutimin e vendimit gjyqësor për shtetasen S.Sh.;
- në datën 30.5.2018 janë dërguar provat shkresore nga shtetasja S.Sh.;
- në datën 10.9.2018 OPGJ-ja ka përpiluar relacionin mbi mënyrën e përfundimit të hetimit penal, duke sugjeruar pushimin e hetimeve;
- në datën 19.11.2018 është vendosur pushimi i procedimit penal; ndaj këtij vendimi është bërë ankim dhe vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 23.1.2019 dhe nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 18.3.2019.

**54.4** Në lidhje me kërkesat dhe memot e shtetases S.Sh., subjekti ka informuar se, me anë të shkresës nr. “\*\*\*\*” prot., datë 25.5.2018, kjo shtetase ka ridërguar memo dhe prova shkresore: memo e datës 19.7.2017; memo e datës 1.8.2017; *email* i datës 15.8.2017; memo e datës 19.9.2017; *email* i datës 17.10.2017, *email* i datës 31.10.2017. Më tej ai ka sqaruar se dy prej memove, të datës 19.7.2017 dhe 19.9.2017, nuk janë protokolluar në sekretarinë e institucionit të prokurorisë, ndërsa të gjitha *email*-et janë dërguar në adresën “\*\*\*\*” dhe se janë bërë pjesë e fashikullit nga OPGJ. Po kështu, me anë të kërkesës së saj nr. “\*\*\*\*” prot., datë 8.8.2017, drejtuar OPGJ-së, është kërkuar të depozitohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Po kështu, në fashikullin e procedimit penal gjendet edhe kërkesa me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 7.12.2017, e shtetases S.Sh., drejtuar prokurorit të çështjes për informacion lidhur me ecurinë e procedimit. Sipas tij, kjo kërkesë nuk ka marrë përgjigje pasi ai ka qenë në fazën e dorëzimit të fashikujve të procedimit penal, pasi me urdhrin nr. “\*\*\*\*”, datë 9.1.2018, është bërë caktimi i tij në grupin e magjistratëve të komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme për vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, ndërkohë që ka qenë pjesë e këtij grupi që në muajt e parë të krijimit të tij me urdhrin nr. “\*\*\*\*”, datë 17.10.2017. Në datën 21.2.2018 drejtuesi i prokurorisë ka përpiluar vendimin për zëvendësimin e prokurorit, duke caktuar si prokuror z.

---

<sup>94</sup> Dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 25.2.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 25.2.2022).

E.I., për hetimin e procedimit penal. Sipas subjektit nuk është e qartë nëse për *email*-et e dërguara është vënë në dijeni OPGJ-ja dhe se sipas tij rezulton se memot nuk janë protokolluar zyrtarisht në sekretarinë e gjykatës. Ai sqaron se këto memo janë bërë pjesë e fashikullit të procedimit penal vetëm pas depozitimit të tyre në sekretarinë e institucionit me anë të shkresës nr. “\*\*\*\*” prot., datë 25.5.2018, nga shtetasja S.Sh., dhe se ai në cilësinë e prokurorit nuk është vënë në dijeni për ekzistencën e tyre.

**54.5** Nga verifikimi i akteve të dosjes penale vërehet se sa i takon veprimeve hetimore të kryera, pas regjistrimit të procedimit penal në datën 24.7.2017, në datën 4.9.2017 (pra pas pushimeve verore) subjekti ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e disa veprimeve hetimore, në zbatim të të cilit konstatohet se krahas veprimeve të kryera dhe të dokumentuara përpara regjistrimit të procedimit janë kryer dhe dokumentuar një sërë veprimesh hetimore me procesverbalet e datës 6.11.2017 për marrje praktike dokumentare; në datën 26.7.2017 është administruar dokumentacion nga Ministria e Financave lidhur me masat mbi ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë etj. Në këto kushte konstatimi mbi mungesën e dokumentimit të veprimeve hetimore nuk qëndron.

**54.6** Në analizë të parashtimeve dhe dokumenteve të subjektit në lidhje me mosmarrjen e vendimit për kërkesat e kallëzueses dhe moskthimin e përgjigjeve në ndonjë formë tjetër rezulton se:

i) Në dosje gjenden të protokolluara kërkesë e datës 7.12.2017, protokolluar me nr. “\*\*\*\*”, ku kërkohet informacion për gjendjen e procedimit penal; kërkesë e datës 8.8.2017 protokolluar me nr. “\*\*\*\*”, për administrim prove në fashikullin hetimor. Për të dyja këto kërkesa nuk ka vendim apo përgjigje drejtuar ankueses sipas nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale. Pretendimi i subjektit se mungesa e përgjigjes ka ardhur për shkak se ai ka qenë në fazën e dorëzimit të fashikujve të procedimit penal, pasi me urdhrin nr. “\*\*\*\*”, datë 9.1.2018 ishte caktuar në grupin e magjistratëve të Prokurorisë së Përgjithshme, nuk qëndron, pasi ai është zëvendësuar si prokuror i çështjes me urdhrin e drejtuesit të prokurorisë së datës 21.2.2018, e deri në këtë moment ai ka qenë përgjegjës i saj.

ii) Në dosje është e protokolluar shkresa me lëndë “ridërgohen memo dhe prova shkresore” me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 25.5.2018, ku dërgohen memo dhe prova shkresore, të cilat ajo thekson se ia ka dërguar nëpërmjet *email*-it OPGJ A.P., si: memo e datës 19.7.2017; memo e datës 1.8.2017; *email* i datës 15.8.2017, drejtuar OPGJ A.P.; memo e datës 19.9.2017, drejtuar subjektit Ylli Pjetërnikaj; *email* i datës 17.10.2017 drejtuar subjektit; *email* i datës 31.10.2017, drejtuar OPGJ-së. Është e vërtetë që kjo shkresë është protokolluar pasi çështja i ka kaluar një tjetër prokurori, por nisur nga datat, të gjitha memot janë dërguar brenda periudhës që çështja ka qenë në trajtim e sipër nga subjekti dhe nuk ka vendim apo përgjigje drejtuar ankueses sipas nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale<sup>95</sup>. Pretendimet e subjektit, se nuk është vënë në dijeni për ekzistencën e memove të shtetasës S.Sh., dhe se është e paqartë nëse OPGJ-ja ka marrë dijeni, mbeten në nivel deklarativ.

**54.7** Në përfundim të procesit, Komisioni çmoi se ndonëse subjekti në periudhën e paraqitjes së kërkesave/memove ka qenë në një fazë tranzicioni pasi me urdhrin nr. “\*\*\*\*”, datë 9.1.2018 ishte caktuar në Prokurorinë e Përgjithshme dhe kjo mund të ketë ndikuar në sa është konstatuar nga Komisioni, në cilësinë e prokurorit të çështjes në çdo rast ai duhet të kishte disponuar me vendim sipas nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale.

---

<sup>95</sup> Neni 110 i Kodit të Procedurës Penale: “1. Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim. 2. Organi procedues shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve”.

## Denoncim nga av. A.Gj.<sup>96</sup>

**55.** Denoncuesi, me profesion avokat, ngre pretendime se prokurori i çështjes, subjekti Ylli Pjetërnikaj, në procedimin penal në ngarkim të shtetasit K.R., ka kryer shkelje të vazhdueshme procedurale, ka shfaqur njëanshmëri të theksuar, ka shkelur të drejtat procedurale të të pandehurit dhe pavarësisht se kanë kërkuar në mënyrë të përsëritur vënien në dispozicion të akteve përkatëse të dosjes, i kanë marrë ato në mënyrë të cunguar. Gjithashtu, pretendon se nga ana e prokurorit i është mohuar e drejta për të sjellë prova dhe dëshmitarë. Gjatë hetimit administrativ, nga aktet e administruara<sup>97</sup> nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, u konstatua se:

**55.1.** Në lidhje me mohimin e të drejtave procedurale, nga vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake rezulton se përfaqësuesi i të pandehurit K.R., kërkoi plotësimin e hetimeve me veprime hetimore shtesë dhe kjo kërkesë nuk është pranuar nga gjykata, e cila ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes nr. “\*\*\*” me të pandehur shtetasin K.R., i cili akuzohet për veprat penale “vrasja me paramendim” e mbetur në tentativë, “mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”. Ky vendim është i formës së prerë, pasi është i paankimueshëm.

**55.2** Pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë janë paraqitur nga personi nën hetim nëpërmjet avokatit të tij A.Gj., një sërë kërkesash, për dy prej të cilave subjekti nuk ka disponuar me vendim dhe as nuk ka përgjigje drejtuar kërkuesit nga prokuroria. Konkretisht, kërkesat për të cilat nuk ka vendim janë: (i) kërkesë për t’u kryer ballafaqimi ndërmjet personit nën hetim dhe një personi tjetër që kishte dijeni për ngjarjen; (ii) kërkesë për kthimin e automjetit të sekuestruar personit nën hetim, pasi automjeti nuk ishte i tij, por i kunatës së tij, së cilës i nevojitet mjeti për të çuar në shkollë e kopsht fëmijët e mitur, duke arsyetuar se kthimi i automjetit nuk pengon vazhdimin e hetimeve, nuk është provë kyçe në zbardhjen e ngjarjes.

**55.3** Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me faktin që nuk ka disponuar me vendim për kërkesat e drejtuar nga avokati sipas përcaktimeve të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale. Në parashtrimet e tij subjekti ka kundërshtuar pretendimin e denoncuesit se nuk ka disponuar me vendim lidhur me kërkesat e mësipërme të avokatit duke argumentuar si vijon:

**55.4** Lidhur me kërkesën për ballafaqim të drejtuar nga avokati, subjekti ka sqaruar se me anë të kërkesës me nr. “\*\*\*”, datë 18.11.2020, mbrojtësi A.Gj., ka kërkuar kryerjen e veprimeve hetimore të ballafaqimit ndërmjet viktimës O.S., dhe shtetasit Gj.P., si dhe ballafaqimi ndërmjet shtetasve Gj.P., dhe E.F. Kjo kërkesë sipas subjektit është trajtuar me anë të vendimit të prokurorit të datës 18.1.2021 “*Lidhur me kërkesën për kryerjen e hetimeve shtesë*”, ku është vendosur mospranimi i kërkesës për kryerjen e ballafaqimit ndërmjet personave të sipërpërmendur sepse shtetasi Gj.P., ishte marrë si i pandehur për veprën penale “deklarim i rremë”.

**55.5** Sa i takon kërkesës për kthimin e automjetit, subjekti ka sqaruar se në datën 4.9.2020 shtetasja O.H., ka paraqitur kërkesë për kthimin e mjetit. Në cilësinë e prokurorit të çështjes është urdhëruar prej tij oficeri i policisë gjyqësore të vlerësojë nevojën e vazhdimin të mbajtjes nën sekuestro të këtij mjeti. Me anë të shkresës nr. “\*\*\*” prot., datë 20.9.2020 është njoftuar shtetasja O.H., se ishte i nevojshme vazhdimi i mbajtjes në sekuestro të provës materiale, automjetit. Kthimi i përgjigjes me shkresë është në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, sepse sekuestrimi si mjet për kërkimin e provës rregullohet si institut më vetë. Personi, të cilit

<sup>96</sup> Shihni denoncimin datë 10.2.2021 – denoncues.

<sup>97</sup> Vendimi nr. “\*\*\*”, datë 18.3.2021; shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nr. “\*\*\*” prot., datë 25.1.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*” prot., datë 27.1.2022) dhe shkresa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, nr. “\*\*\*” prot., datë 28.1.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*” prot., datë 2.2.2022).

i është sekuestruar prova materiale, mund të kundërshtojë një vendim të tillë, në bazë të nenit 212 të Kodit të Procedurës Penale, titulluar “Kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit”. Sipas subjektit, kthimi i përgjigjes lidhur me kërkesën e paraqitur për kthimin e mjetit nuk mund të trajtohet në formë vendimi në bazë të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, sepse sekuestrimi i provës është bërë me vendim prokurori, i cili është i ankimeshëm në gjykatë. Prokuroria në momentin që prova materiale nuk ishte e nevojshme për hetimin, ka urdhëruar kthimin e saj.

**50.3.3** Në datën 6.1.2021 është urdhëruar kthimi i tij shtetas O.H., dhe në datën 13.1.2021 ky urdhër është ekzekutuar nga Komisariati i Policisë Lezhë.

**55.6** Në analizë të parashtrimeve të subjektit, nga verifikimi i akteve të dosjes penale, konstatohet se pretendimet e denoncuesit që subjekti nuk është shprehur në lidhje me kërkesat e tij nuk qëndrojnë, pasi: (i) lidhur me kërkesën për ballafaqim të avokatit të datës 18.11.2020 subjekti ka disponuar me vendimin e datës 18.1.2021, ku është vendosur mospranimi i kërkesës për kryerjen e ballafaqimit; (ii) lidhur me kërkesën për kthimin e automjetit vlerësohet se referuar nenit 212<sup>98</sup> të Kodit të Procedurës Penale kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit bëhet përmes ankimit në gjykatë.

### **Denoncim nga shtetasja S.T.<sup>99</sup>**

**56.** Denoncuesja ngre pretendime se prokurori Ylli Pjetërnikaj mbylli hetimin penal ndaj përmbauesit E.O., dhe ekspertit H.D. Nga verifikimi, rezultoi se i gjithë shpjegimi dhe dokumentacioni bashkëlidhur ka të bëjë vetëm me procesin civil dhe nuk ka asnjë shpjegim në lidhje me procesin penal të cilit i referohet denoncuesi. Megjithatë me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime e dokumente nga dosja penale në lidhje me veprimet hetimore të kryera prej tij, për sa bëhet fjalë në këtë denoncim.

**56.1** Në parashtrimet e tij subjekti ka sqaruar se është ngarkuar për ushtrimin e ndjekjes penale lidhur me kallëzimin penal nr. “\*\*\*\*”, datë 8.9.2017, ku ndër kallëzuesit ishte edhe shtetasja S. T (M.), të cilët ankoheshin ndaj përmbauesit E.O. Sipas tij, ndër veprimet hetimore të kryera lidhur me këtë kallëzim janë: pyetja si persona që kanë dijeni për veprën penale shtetasi E. O., si dhe personat që kanë bërë kallëzim penal; është administruar me anë të procesverbalit të këqyrjes dhe marrjes së dokumenteve kopje e dosjes përmbaimore me nr. “\*\*\*\*”, viti 2016; në datën 16.10.2017 është vendosur mosfillimi i procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. “\*\*\*\*”, datë 8.9.2017, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Më tej, subjekti ka sqaruar se nga të dhënat e administruara rezultonte se përmbauesi gjyqësor kishte vepruar në përputhje me legjislacionin procedural civil. Veprimet e tij procedurale janë verifikuar edhe nga gjykatat, të cilat kanë rrëzuar kërkesëpadinë “Për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe kundërshtimin e veprimeve përmbaimore”. Në mbështetje të pretendimeve të tij subjekti ka paraqitur dosjen e procedimit penal përkatës.

**56.2** Në analizë të parashtrimeve, nga aktet e dosjes së procedimit penal konstatohet se subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal të shtetas S. T., etj., që lidhej me një procedurë përmbaimore gjyqësor, për të cilën pretendohet se përmbauesi gjyqësor kishte kryer ekzekutimin në kundërshtim me vendimet e gjykatës. Me qëllim verifikimit e materialit kallëzues nga ana e subjektit është administruar praktika e procedurës së përmbaimit, nga analiza e së cilës nuk kanë rezultuar elemente të figurës së veprës penale. Vendimi është gjetur i drejtë edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 22.2.2018. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika në drejtim të aftësive profesionale.

<sup>98</sup> “Kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit 1. I pandehuri, personi tek i cili janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë në kërkimin e tyre, mund të bëjë ankim në gjykatë, e cila merr vendim të arsyetuar brenda 10 ditëve. 2. Kundër vendimit të gjykatës lejohet ankim brenda 5 ditëve. Gjykata e Apelit jep vendim të arsyetuar brenda 10 ditëve nga marrja e akteve. 3. Ankimi nuk e pezullon zbatimin e vendimit”.

<sup>99</sup> Shihni denoncimin nr. “\*\*\*\*” prot., datë 18.12.2017.

## Denoncime nga av. E.Gj.<sup>100</sup>

**57.** Denoncuesi është përfaqësues i tre personave të proceduar penalisht B.Z., F.Xh., dhe F.F. N. Ai ngre pretendime se nuk ka informacion në lidhje me ecurinë e procedimeve penale, pavarësisht kërkesave të drejtuara prej tij prokurorit të çështjes, subjektit Ylli Pjetërnikaj. Me qëllim verifikimin e këtyre pretendimeve, gjatë hetimit administrativ Komisioni kërkoi informacion<sup>101</sup> nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në lidhje me kërkesat/ankesat e paraqitura nga denoncuesi dhe si është vendosur në lidhje me to, informacion nga i cili, rezultoi se:

**57.1** Në lidhje me shtetasin F.Xh., të mbrojtur nga av. E.Gj., (denoncuesi), avokati ka depozituar:

- Një memo me objekt *“Kërkoj të informohem në cilësinë e mbrojtësit ligjor të zgjedhur nga shtetasi F. Xh...”*<sup>102</sup>. Nga ana e prokurorisë nuk është dërguar informacion çfarë është vendosur në lidhje me këtë memo/kërkesë sipas nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale.
- Një kërkesë ankimore në lidhje me mospërbushjen e detyrës funksionale nga ana e prokurorit të çështjes Ylli Pjetërnikaj<sup>103</sup>. Nuk ka informacion çfarë është vendosur në lidhje me këtë kërkesë ankimore.
- Një ankesë në lidhje me mosveprimin e prokurorit, për të cilën Drejtuesi i Prokurorisë ka kërkuar informacion nga prokurori. Mbi fletën e informacionit si më lart drejtuar nga subjekti Drejtuesit të Prokurorisë, ky i fundit ka vendosur shënimin: *“Z. Pjetërnikaj, për mendimin tim duhet t’i vihen në dispozicion mbrojtësit aktet e kërkuara dhe info mbi procedurën”*.
- Nuk rezulton të ketë një vendim në lidhje me kërkesat/memot e parashtruara nga avokati.

**57.2** Në lidhje me shtetasin B.Z., avokati ka depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në datën 26.11.2021 kërkesë drejtuar prokurorit Ylli Pjetërnikaj për t’iu mundësuar dhënia e akteve (ato që nuk përbëjnë sekret hetimor) dhe një ankesë drejtuar drejtuesit të prokurorisë në datën 17.12.2021, në të cilën ka parashtruar se ende nuk ka marrë një përgjigje me vendim në lidhje me kërkesën në fjalë dhe ka kërkuar që të merren masa nga drejtuesi i prokurorisë. Në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga prokuroria, nuk rezulton ndonjë vendim në lidhje me kërkesën dhe ankesën e parashtruar nga avokati.

**57.3** Në lidhje me shtetasin F.F.N., të mbrojtur nga av. E.Gj., (denoncuesi), në datën 8.10.2021<sup>104</sup> rezultoi se:

- Avokati ka depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë një memo ku në cilësinë e mbrojtësit të këtij shtetasi, kërkon të informohet në lidhje me aktet procedurale të dosjes që i përket procedimit penal të filluar ndaj tij, i cili sipas njoftimeve në media dyshohet të ketë qëlluar me armë një shtetas. Në datën 8.11.2021 ai ka depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë kërkesën për detyrimin e prokurorisë ta informojë atë në cilësinë e mbrojtësit ligjor, në lidhje me aktet procedurale të dosjes.
- Nga dokumentacioni i dërguar në Komision nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, nuk rezulton të ketë një vendimmarrje në lidhje me memon e avokatit dhe nuk ka informacion mbi disponimin e gjykatës në lidhje me kërkesën drejtuar gjykatës.
- Në datën 22.11.2021 avokati ka depozituar përsëri në prokurorinë në fjalë kërkesë<sup>105</sup> për t’u informuar në cilësinë e mbrojtësit në lidhje me aktet procedurale të dosjes dhe prokuroria i ka

<sup>100</sup> Shihni denoncimet: nr. “\*\*\*\*” prot., datë 28.12.2021; nr. “\*\*\*\*” prot., datë 20.12.2021; nr. “\*\*\*\*” prot., datë 6.1.2022.

<sup>101</sup> Me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 17.1.2022; shkresa nr. “\*\*\*\*” prot., datë 5.2.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 27.1.2022).

<sup>102</sup> Depozituar në datën 22.10.2021, regjistruar në prokurori me nr. “\*\*\*\*” prot.

<sup>103</sup> Datë 26.11.2021, regjistruar në prokurori me nr. “\*\*\*\*” prot.

<sup>104</sup> Regjistruar në prokurori me nr. “\*\*\*\*” prot.

<sup>105</sup> Regjistruar në Prokurori me nr. “\*\*\*\*”.

kthyer përgjigje<sup>106</sup>, duke e sqaruar se: “*Momentet procedurale, në të cilat jepen kopje të akteve të një procedimi penal, janë përcaktuar në mënyrë taksative nga legjislacioni procedural penal, duke pasur në fokus garantimin e respektimit të parimeve themelore të procedimit penal. Kështu, në nenin 34/a/ë të Kodit të Procedurës Penale është parashikuar se: ‘1. Personi nën hetim ose i pandehuri ka të drejtë ... ë) të njihet me materialet e çështjes, sipas parashikimeve të këtij Kodi...’.* Parashikimet e këtij kodi janë bërë në nenet 34, 34/a, 34/b/1/b, 279/1, 327 të tij. Kështu, në zbatim të nenit 34/b/1/b të Kodit të Procedurës Penale, njohja me aktet, provat e nevojshme dhe arsyet e ndalimit apo arrestimit të tij, bëhet në momentet e para procedurale, nëse personi është i arrestuar, apo ndaluar. Ndërsa në bazë të neneve 34, 34/a, 279/1, 327 të Kodit të Procedurës Penale, personi nën hetim do të njihet me aktet e tjera hetimore në momentin e njoftimit të akuzës si dhe përfundimit të hetimeve. Është e qartë që nuk jemi në asnjë nga këto momente procedurale ...”.

- Më pas, në datën 22.12.2021 avokati në fjalë (denoncuesi) në cilësinë e mbrojtësit ligjor të shtetasit F.N., ka depozituar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë ankesën drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë, për mosveprimin e prokurorit. Me shënim në këtë shkresë, Drejtuesi i Prokurorisë ka kërkuar të informohet në lidhje me këtë kërkesë/ankesë dhe prokurori e ka informuar Drejtuesin në lidhje me sa është kërkuar<sup>107</sup>.

- Në datën 29.12.2021 subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj ka njoftuar përfundimin e hetimeve, në pikën 16 të të cilit është përcaktuar: “*I komunikoj të pandehurve të drejtat si më poshtë: 1. Të njihet me aktet e të marrë kopje. 2. Brenda 10 ditëve të paraqesë memorie e dokumente. 3. T’i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë. 4. Të bëjë deklarime apo të kërkojë të merret në pyetje”.*

- Përveç përgjigjes së sipërcituar të prokurorisë së datës 1.12.2021, drejtuar avokatit, nuk ka asnjë vendim në lidhje me kërkesat/ankesat drejtuar prokurorisë për sa më lart.

**57.4** Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektivit iu kërkuar të japë sqarime në lidhje me konstatimin, duket se për asnjë nga kërkesat e parashtruara nga avokati, si më lart, subjekti nuk është shprehur me vendim, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2 të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale. Në parashtrimet e tij, në mënyrë të përmbledhur subjekti ka informuar se:

**57.5** Për shtetasin F.Xh., në lidhje me kërkesën nr. “\*\*\*”, datë 22.10.2021 të mbrojtësit E. Gj., për marrjen e kopjeve të akteve të procedimit, sigluar nga drejtuesi i prokurorisë pa datë siglimi për OPGJ M.D., sipas tij, në kushtet kur kopjet e akteve i ishin njohur mbrojtësit, në seancën gjyqësore të datës 14.12.2021, dhe për të cilat ai nuk kishte shfaqur asnjë kundërshtim, ka vlerësuar të panevojshme kthimin e përgjigjes. Sa i takon kërkesës ankimore drejtuar drejtuesit të prokurorisë në lidhje me mospërmbushjen e detyrës funksionale nga prokurori i çështjes subjekti deklaroi se nuk është njohur me ndonjë vendimmarrje, dhe se lidhur me këtë ai ka paraqitur informacion tek drejtuesi i prokurorisë se pretendimet për mosdhënien e kopjes së akteve nuk qëndronin pasi ata ishin njohur në seancën gjyqësore të datës 14.12.2021.

**57.6** Për shtetasin B.Z., në parashtrimet e tij, subjekti ka informuar se mbrojtësi E.Gj., ka paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë kërkesën nr. “\*\*\*”, datë 26.11.2021, drejtuar prokurorit të çështjes për dijeni drejtuesit të prokurorisë. Rezulton se kjo kërkesë është firmosur nga drejtuesi i prokurorisë, por nuk ka shënuar datën e firmës dhe kujt ia ka përcjellë. Më anë të kësaj kërkesë kërkohej informacion mbi gjendjen e procedimit si dhe kopje të akteve. Ndërsa në datën 17.12.2021 është protokolluar ankesa me nr. “\*\*\*” prot., e bërë nga mbrojtësi E.Gj., drejtuar drejtuesit të prokurorisë, i cili ka sigluar ankesën: “*të informohem*”, duke mos shënuar datën e siglimit, ku bashkëlidhur kësaj ankese është kërkesa e datës 26.11.2021, e paprotokolluar. Më tej subjekti ka informuar se në datën 22.12.2021

<sup>106</sup> Shkresa nr. “\*\*\*” prot., datë 1.12.2021.

<sup>107</sup> Shihni shkresën datë 10.1.2022, pjesë e dokumentacionit të dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

kishte përpiluar aktet e njoftimit të akuzës dhe përfundimit të hetimit të cilat i janë njoftuar të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, dhe se vetëm në këtë datë kishte marrë dijeni për kërkesat, ankesat e mbrojtësit. Në kushtet kur ai i kishte paraqitur aktet në seancën gjyqësore të datës 28.12.2021, dhe i kishte vënë në dispozicion të personit nën hetim dhe avokatit, ishte e panevojshme vënia në dispozicion e këtyre kopjeve përsëri.

**57.7** Për shtetasin F.F.N., në parashtrimet e tij subjekti ka informuar se mbrojtësi i të pandehurit është njohur me aktet e dosjes në datën 13.1.2022, pas njoftimit të përfundimit të hetimeve. Lidhur me këtë fakt ai ka sqaruar se në kushtet e ruajtjes së sekretit hetimor me shkresën nr. “\*\*\*\*”, datë 1.12.2021 i është kthyer përgjigje avokatit duke e njoftuar për administrimin e aktit të përfaqësimit si dhe faktin se organi i prokurorisë do të garantojë respektimin e të drejtave procedurale, më tej nuk i është bërë e ditur pasi ndodheshin në kushtet e sekretit hetimor pasi i pandehuri ishte në kërkim ndërkombëtar. Ndërsa në datën 22.12.2021 ka paraqitur ankesën nr. “\*\*\*\*”, datë 22.12.2021 drejtuar drejtuesit të prokurorisë, për dijeni institucioneve të tjera të drejtësisë, me anë të së cilës ankohej lidhur me mosveprimin e prokurorit të çështjes për të mos i dhënë informacion për procedimin penal. *Në datën 7.1.2022 jam njohur me këtë ankesë, për të cilën drejtuesi i prokurorisë kërkonte informacion. Në datën 10.1.2022 kam përpiluar një informacion të detajuar drejtuesit të prokurorisë lidhur me veprimet procedurale të kryera dhe arsyet e mosdhënies së informacionit të kërkuar. Për shkak se i pandehuri ishte në kërkim, dhe me datë 17.12.2021 kisha kërkuar deklarinimin e ikjes së tij nga gjykata.*

**57.8** Në analizë të parashtrimeve vërehet se subjekti argumenton mungesën e vendimeve të organit të prokurorisë mbi memot dhe kërkesat e avokatit mbrojtës (kryesisht për njohje me aktet), me faktin se është njohur me to në seanca gjyqësore në fazën e gjykimit ose në rastin e fundit me sekretin hetimor. Pretendime të tilla vlerësohen të pabazuara, pasi në zbatim të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale organi procedues duhet të shprehet me vendim për kërkesat dhe memoriet e palëve duke arsyetuar mbi shkaqet e pranimit apo refuzimit të tyre.

#### **Denoncim nga av. G.N.<sup>108</sup>**

**58.** Denoncuesi është mbrojtës ligjor i të pandehurit N.M.Ll., i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 101/2 i Kodit Penal “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç”. Ai ngre pretendime se në procedimin penal nr. “\*\*\*\*”, regjistruar në datën 19.5.2021, nga ana e prokurorit të çështjes Ylli Pjetërnikaj janë kryer shkelje procedurale, si vijojnë: nuk i ka dhënë asnjë përgjigje dhe nuk ka dalë me vendim për asnjë nga kërkesat e tij lidhur me ecurinë e hetimeve; ka neglizhuar dhe nuk e ka njohur as me aktet e fashikullit të hetimit të paraqitura në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, bashkë me kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim; ka thirrur avokat kryesisht, megjithëse denoncuesi kishte njoftuar organin procedues se kishte akt përfaqësimi nga i pandehuri dhe as këtij avokati nuk i ka lënë kohë të njihet me aktet para se të nënshkruante njoftimin e akuzës; Gjykata e Apelit Shkodër është shprehur me vendim të formës së prerë se arrestimi i të mbrojturit prej tij dhe i të pandehurve të tjerë është i paligjshëm.

**58.1** Gjatë hetimit administrativ, me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncuesit, Komisioni administroi<sup>109</sup> një kopje të njësuar me origjinalin të dosjes gjyqësore, duke përfshirë edhe fashikullin hetimor që i përket këtij procedimi, nga analizimi i akteve të së cilës rezulton se:

**58.2** Në lidhje me pretendimin mbi paligjshmërinë e arrestimit të të mbrojturit prej tij: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka kërkuar “vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurisë” për të dyshuarit e veprës penale si më sipër, një prej të cilëve është personi i mbrojtur nga denoncuesi. Prokurori që ka nënshkruar kërkesën

<sup>108</sup> Shihni denoncimin nr. “\*\*\*\*” prot., datë 18.11.2021.

<sup>109</sup> Me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 28.1.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 2.2.2022).

nuk ka qenë subjekti Ylli Pjetërnikaj<sup>110</sup>. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur<sup>111</sup> pranimin e kërkesave të prokurorisë<sup>112</sup>. Gjykata e Apelit Shkodër e ka vlerësuar të paligjshëm arrestin në flagrancë të të dyshuarve<sup>113</sup>.

**58.3** Në lidhje me pretendimin se prokurori ka thirrur avokat kryesisht, megjithëse denoncuesi kishte njoftuar organin procedues se kishte akt përfaqësimi nga i pandehuri, rezultoi se janë administruar tri procesverbale të mbajtura nga oficeri i policisë gjyqësore A.U., në datat 28.7.2021, 2.8.2021 dhe 3.8.2021, për njoftimin e avokatit G.N., për t'i njoftuar vendimin për marrjen e personit si të pandehur dhe njohjen me aktet e procedimit penal me të pandehurin N.Ll., por ai nuk është paraqitur<sup>114</sup>. Në datën 3.8.2021, prokurori ka marrë vendim për caktimin e mbrojtësit kryesisht për të pandehurin në fjalë. Në arsyetimin e vendimit është sqaruar fakti i njoftimeve të sipërpërmendura dhe se avokati nuk është paraqitur.

**58.4** I pandehuri N.Ll., nuk ka pranuar të nënshkruajë letrën e të drejtave të të pandehurit dhe as procesverbalin e të pandehurit, datë 3.8.2021. Në këtë të fundit është shprehur se: *“Akuzën e kupton, e ka të qartë, nuk e pranon”* dhe *“Shpjegime do të jap në prani të avokatit të zgjedhur nga ana ime apo familjarëve të mi. Unë sot nuk nënshkruaj asnjë dokument”*. Procesverbali është nënshkruar nga mbrojtësi i caktuar kryesisht. Në këto kushte, pretendimi i ngritur nuk qëndron.

**58.5** Pretendimi se subjekti nuk ka dalë me vendim për kërkesat e tij lidhur me ecurinë e hetimeve dhe nuk e ka njohur as me aktet e fashikullit të hetimit të paraqitura në gjykatë, në seancën për dërgimin e çështjes në gjyq, rezultoi se në dosje janë administruar disa kërkesa të avokatit dhe nuk ka vendime të prokurorit në lidhje me to, si dhe gjykata e ka kthyer çështjen për hetime të paplota. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i kërkohet të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim. Në parashtrimet e tij në lidhje me këtë konstatim, subjekti sqaron se procedimi penal ishte regjistruar më 19.5.2021 nga prokurorja R.F., (me emër personi) dhe se në datën 22.6.2021 ai e kishte zëvendësuar këtë prokurore, duke vijuar me ushtrimin e ndjekjes penale. Sipas tij, duke qenë se çështja duhej të dërgohej në gjykatë deri në datën 19.8.2021, pra duke pasur rreth një muaj kohë, ai ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore me përparësi. Më tej, subjekti ka sqaruar se mbrojtësi G.N., ka paraqitur kërkesën me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 14.6.2021, me anë të së cilës ka kërkuar marrjen në pyetje të personave që mund të kenë dijeni rreth faktit penal. Ndërsa në datën 17.6.2021 ka paraqitur kërkesën me nr. “\*\*\*\*” prot., me anë të së cilës ai kërkonte kryerjen e veprimeve të tjera hetimore në vazhdim të kërkesës së sipërpërmendur. Të dyja këto shkresa janë sigluar (pa datë) nga drejtuesi i prokurorisë për prokuroren R.F. Kjo e fundit nuk është shprehur për këto shkresa ndërsa janë bërë pjesë e fashikullit të procedimit penal nga oficeri i policisë gjyqësore, pas momentit të njoftimit të akuzës dhe njoftimit të përfundimit të hetimeve vetëm pas bërjes së dorëzimeve nga prokurorja R.F. Lidhur me vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake për plotësimin e hetimeve, subjekti ka informuar se organi i prokurorisë ka mbajtur qëndrim kundërshtues gjatë seancës, por ky vendim është i paankimueshëm. Në vendimin për plotësimin e hetimeve, gjykata ka urdhëruar ripyetjen e viktimës së fëmijës së mitur.

---

<sup>110</sup> Ka qenë prokurore R.F.

<sup>111</sup> Vendimi nr. “\*\*\*\*”, datë 20.5.2021.

<sup>112</sup> Ndër të tjera, ka vendosur “vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë të kryer nga policia gjyqësore ndaj të dyshuarit N.Ll., dyshuar për veprën penale... dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg me afat 1-mujor...”.

<sup>113</sup> Vendimi nr. “\*\*\*\*” regj., datë 22.6.2021.

<sup>114</sup> Në njoftimin e parë, avokati është përgjigjur se ka bërë kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit për të pandehurin dhe nuk mund të shkojë. Në njoftimin e dytë të bërë përmes telefonit celular, avokati është përgjigjur se në orën 10:00 ka gjyq në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe se në orën 12:00 do të paraqitet pranë IEVP Shënkoll, Lezhë (ku mbahet në paraburgim i pandehuri), por gjatë gjithë ditës nuk është paraqitur. Në procesverbalin e tretë sqarohet fakti se njoftimi është bërë përmes telefonit celular, por në atë kohë telefonin e kishte të fikur.



**58.6** Në sqarimet e dhëna nga subjekti vërehet se ai argumenton mungesën e vendimeve të organit të prokurorisë me faktin se dy kërkesat ishin depozituar në periudhën kur çështja ishte nën hetim nga prokurorja e mëparshme dhe se ajo nuk ishte shprehur lidhur me to dhe, përveç kësaj, ato janë bërë pjesë e fashikullit pas njoftimit të akuzës. Pavarësisht se këto fakte janë të vërteta, në zbatim të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, organi procedues duhet të shprehet me vendim për kërkesat dhe memoriet e palëve, duke arsyetuar mbi shkaqet e pranimit apo refuzimit të tyre.

### **Denoncim anonim<sup>115</sup>**

**59.** Në këtë denoncim ngrihen pretendime se subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj, gjatë kohës kur ka qenë drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka shpërdoruar detyrën dhe fondet publike duke paguar një OPGJ të kësaj Prokurorie (E.Ç., bashkëshort i ish-Prokurores së Përgjithshme Arta Marku) pa kryer asnjë punë. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit u komandua nga Prokurorja e Përgjithshme në atë kohë, znj. Arta Marku, në drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodrës në maj të vitit 2018, megjithëse ai nuk plotësonte kriteret ligjore. Me qëllim verifikimin e këtyre pretendimeve, nga ana e Komisionit u kryen disa veprime hetimore të pasqyruara në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, nëpërmjet të cilave u administruan informacione e dokumente shkresore nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Prokuroria e Përgjithshme<sup>116</sup>, nga ku u konstatua se:

**59.1** Nga informacioni i përcjellë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër rezultoi se OPGJ E.Ç., ka punuar në seksione të ndryshme të kësaj Prokurorie, konkretisht: në periudhën 1.6.2018 – 30.6.2019 ka punuar çdo ditë 8 orë/ditë; në muajt nëntor dhe dhjetor 2018 ka qenë i gatshëm 7 ditë në secilën prej tyre; në muajt janar 2019 - korrik 2019 ka qenë i gatshëm 8 – 14 ditë në muaj; gjatë periudhës qershor 2018 – korrik 2019 rezultoi që OPGJ E.Ç., ka hetuar 2 procedime.

**59.2** Prokuroria e Përgjithshme informoi se për vitin 2019 nuk rezultoi t'i jetë deleguar asnjë dosje për hetim këtij oficeri. Ndërkohë, informon se ka urdhra regjistrimi që nuk janë arkivuar fizikisht në kryesekretari apo urdhra regjistrimi të prokurorëve që nuk e kanë të pasqyruar oficerin që i delegohet dosja për hetim. Po kështu, sipas po këtij informacioni, ka dy shkresa ku është përmendur emri i shtetasit E.Ç., për vitin 2019, shkresa që kanë lidhje me të njëjtin procedim. Në këtë shkresë sqarohet se nuk rezultoi të ketë një urdhër të drejtuesit për përjashtimin e plotë apo të pjesshëm nga ngarkesa e punës, raport mjekësor apo çdo akt tjetër që lidhet me angazhimin në punë të OPGJ-së në fjalë. Nga sistemi elektronik i hyrje-daljeve në institucion për periudhën 1.12.2018 – 20.7.2020 nuk rezultoi asnjë hyrje-dalje e z. E.Ç.

**59.3** Nga korrespondenca e mbajtur mes Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe z. E. Ç., gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2019 ai ka pasur në hetim 16 procedime dhe ka qenë i gatshëm çdo muaj. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2019, ai nuk ka qenë i pajisur me kartë elektronike për hyrjen në godinën e Prokurorisë e, rrjedhimisht, ka hyrë nga dera që ishte e hapur për publikun.

**59.4** Ndaj subjektit nuk është iniciuar ndonjë procedim disiplinor.

**59.5** Ligji nr. 97/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 42, germa “gj” e tij përcakton se: Drejtuesi i Prokurorisë drejton, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e Policisë Gjyqësore nën juridiksionin e tij.

<sup>115</sup> Shihni denoncimin nr. “\*\*\*\*” prot., datë 24.5.2021.

<sup>116</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 4.2.2022, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 7.2.2022); shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 20.4.2022, nga Prokuroria e Përgjithshme (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 20.4.2022); shkresë e Prokurorisë së Rrethit Shkodër nr. “\*\*\*\*” prot., datë 10.7.2020, drejtuar OPGJ-së E.Ç., dhe informacioni i dërguar nga ky i fundit Prokurorisë në fjalë me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 24.7.2020.

Në pikën “k”, kjo dispozitë përcakton se Drejtuesi i Prokurorisë *mbikëqyr respektimin e etikës së prokurorit dhe planifikimin e punës së tyre, si dhe përmbush angazhimet ligjore për vlerësimin profesional të prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore.*

**59.6** Nisur nga fakti se mbikëqyrja e veprimtarisë së OPGJ-ve është përgjegjësi e drejtuesit të Prokurorisë, i cili bën edhe vlerësimin profesional të tyre dhe merr masa për shpërndarjen e drejtë të çështjeve, gjatë hetimit administrativ subjektit iu kërkua të japë sqarime e të provojë me dokumente angazhimin e OPGJ-së E.Ç., çështjet konkrete të ngarkuara dhe prezencën e tij të pandërprerë në Prokurori përgjatë gjithë periudhës që subjekti ka qenë drejtues. Në përgjigje të pyetësorit nr. 10, subjekti ka deklaruar se është njohur me një pretendim të tillë edhe nga portalet, pasi është larguar nga detyra e drejtuesit. Sipas tij, referuar raportit vjetor për vitin 2019, ngarkesa e këtij OPGJ-je ishte mesatare. Ai ka informuar Komisionin se për të reflektuar ndryshimet ligjore të vitit 2017 në Kodin e Procedurës Penale lidhur me varësinë funksionale të OPGJ-ve, ka nxjerrë një sërë urdhrash: në datën 1.2.2019 ka urdhëruar caktimin e çdo OPGJ-je pranë një prokurori përkatës; në datën 10.2.2017 është urdhëruar, ndër të tjera, përpilimi i listëprezencës për çdo punonjës nga ana e kryesekretares, ku në asnjë rast kjo e fundit nuk i ka bërë me dije ndonjë problematikë; në datën 10.7.2019 është urdhëruar, ndër të tjera, përdorimi i kartës elektronike, por nuk ka dijeni nëse drejtuesi i mëpasshëm ka marrë masa për zbatimin e këtij urdhri. Ai ka informuar Komisionin se ky OPGJ në korrik - gusht të vitit 2019 është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur praktikën e përcjellë nga Prokuroria Shkodër – e paraqitur edhe pranë Komisionit nga kjo Prokurori – raportin vjetor të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për vitin 2018, ku paraqitet, ndër të tjera, edhe ngarkesa në punë e OPGJ-së E.Ç., me 39 çështje; urdhrin nr. “\*\*\*”, datë 26.10.2018, sipas të cilit, ndër të tjera, OPGJ E.Ç., është caktuar në seksionin për hetimin e krimeve kundër jetës, shëndetit etj; urdhrin nr. “\*\*\*”, datë 1.1.2019, sipas të cilit, ndër të tjera, OPGJ E.Ç., caktohet në seksionin për krimin ekonomik-financiar etj.; urdhrin nr. “\*\*\*”, datë 1.2.2019, sipas të cilit, ndër të tjera, OPGJ E.Ç., është caktuar pranë prokurores Sh.M.; urdhrin nr. “\*\*\*”, datë 10.7.2019, ku, ndër të tjera, urdhërohet përdorimi i kartës elektronike gjatë hyrje-daljeve në institucion; korrespondencën mes Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

**59.7** Nga sqarimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se subjekti në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka nxjerrë një sërë urdhrash me karakter administrativ mbi mbarëvajtjen e punës në institucionin që ai drejton dhe respektimin e orarit zyrtar, duke përcaktuar qartësisht dhe zyrtarët përgjegjës për zbatimin e tyre, si dhe urdhra për ndarjen e OPGJ-vë nëpër seksione dhe pranë prokurorëve. Nga aktet e paraqitura qoftë nga Prokuroria Shkodër, qoftë nga vetë subjekti, nuk rezultojnë të jenë raportuar problematika nga prokurorët apo zyrtarët përgjegjës për hyrje-daljet. Ndërkohë, çmohet se marrëdhëniet e punës janë jashtë tagrit të vlerësimit të Komisionit.

**Denoncim anonim i depozituar pranë ONM-së<sup>117</sup>, ku ngrihen disa pretendime të karakterit administrativ, profesional dhe pasuror, analizuar rast pas rasti, si më poshtë vijon:**

**60.** Në denoncim grihen pretendime në lidhje me emërimet dhe transferimet e subjektit në kundërshtim me ligjin. Në lidhje me këto pretendime, i pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka informuar<sup>118</sup> se në datën 7.6.2018 është komanduar nga Prokurori i Përgjithshëm si drejtues në Prokurorinë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për shkak të problematikave në qarkun Shkodër në atë periudhë, si dhe prej faktit se drejtuesi i komanduar i mëparshëm u komandua në Prokurorinë për Krime të Rënda. Ai ka informuar gjithashtu se pas qëndrimit për afër një vit ka kërkuar nga KLP-ja ndërprerjen e komandimit. Subjekti sjell në vëmendje të Komisionit

<sup>117</sup> Përcjellë në rrugë elektronike nga ONM-ja, me *email*-in e datës 11.4.2022.

<sup>118</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 10 në dosjen e Komisionit.

ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit në periudhën tranzitore deri në krijimin e KLP-së ishte Prokurori i Përgjithshëm ai që bënte caktimin në pozicione të përkohshme të magjistratëve, ndërkohë që ligji nuk parashikonte kritere për caktimin në pozicione të përkohshme. Në zbatim të këtij ligji është bërë edhe caktimi i tij i përkohshëm në detyrën e drejtuesit të Prokurorisë Shkodër. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur: urdhrin nr. “\*\*\*\*”, datë 26.3.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm Arta Marku, për caktimin e tij të përkohshëm si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë; urdhrin nr. “\*\*\*\*”, datë 6.6.2018, për ndërprerjen e caktimit të përkohshëm si prokuror në Prokurorinë Tiranë.

**60.1** Në analizë të sqarimeve të subjektit, referuar ligjit nr. 96/2016, vërehet se në nenin 47 përcaktohen kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë<sup>119</sup>, ndërkohë që ligji nuk ka parashikuar kritere të veçanta për t’u caktuar në pozicion të përkohshëm. Nga ana tjetër, në nenin 160, pika 4<sup>120</sup> të këtij ligji, gjatë periudhës tranzitore caktimi në pozicione të përkohshme i ishte lënë si kompetencë Prokurorit të Përgjithshëm. Në rastin konkret, subjekti pretendon se është komanduar nga Prokurori i Përgjithshëm si drejtues në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, por nuk ka paraqitur urdhrin përkatës. Subjektit iu kërkua të paraqesë urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm për caktimin e tij të përkohshëm si drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në parashtrimet e tij, subjekti ka paraqitur urdhrin nr. “\*\*\*\*”, datë 6.6.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për caktimin në pozicion të përkohshëm”, sipas të cilit ai është caktuar përkohësisht drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

**60.2** Në përfundim të hetimit administrativ nuk ka pasur dyshime në lidhje me emërimet dhe transferimet e subjektit, pasi në Prokurorinë e Shkodrës ai është caktuar drejtues në pozicion të përkohshëm.

**60.3** Pretendimi tjetër i ngritur lidhet me zvarritjen e çështjes CEZ dhe, sipas denoncuesit, subjekti nuk paraqitej në gjykatë, duke gjetur argumente të ndryshme, derisa i erdhi koha e komandimit në Shkodër. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka kundërshtuar këtë pretendim, duke deklaruar se ka qenë prezent në të gjitha seancat gjyqësore për të cilat ka marrë dijeni. Konkretisht, ai ka informuar se në seancën e datës 20.3.2018 nuk ka qenë e pranishme prokurorja A.S., e as avokati dhe është vendosur të njoftohet prokuroria dhe avokati për seancën e datës 3.4.2018. Kjo seancë është shtyrë për njoftimin e e prokurorit Ylli Pjetërnikaj dhe avokatit, duke caktuar seancën e radhës në datën 17.4.2018. Në këtë seancë, gjyqtari ka vendosur shtyrjen e seancës për njoftimin e prokurorit E.B., dhe avokatit, duke caktuar seancën e radhës më 2.5.2018. Ai ka informuar se në këto seanca nuk janë paraqitur prokurorët, për shkak se drejtuesi nuk kishte përcaktuar ende proceduralisht prokurorin që do të ndiqte procedimin. Subjekti ka sqaruar se nuk ka qenë prezent në seancën e datës 29.5.2018 për shkak të pjesëmarrjes në një trajnim në Belgjikë, në datat 29 - 30 maj 2018. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur:

- kopje të pjesëve të procesverbaleve të seancave gjyqësore që iu përkasin viteve 2017, 2018 dhe 2019, ku vërehet se prokurorët që kanë përfaqësuar çështjen në gjykim kanë qenë të

---

<sup>119</sup> 6. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë, në pozicionin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë së shkallës së parë ose të dytë, nëse: a) ka ushtruar funksionin e magjistratit jo më pak se shtatë vjet, gjatë së cilës të paktën katër vjet në të njëjtën shkallë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar; b) përmbush treguesit e kërkuar për aftësi organizative dhe drejtuese, të tilla si: i) përvoja si zëvendëskryetar, kryetar i një seksioni ose magjistrat për çështjet e shtypit; ii) përvoja në pozicione drejtuese në administratën publike ose të drejtësisë, ose përvoja si anëtar i Këshillit, që ka përfunduar të paktën tre vjet më parë; iii) njohuri për strukturat organizative dhe modele të ndryshme të drejtimit, si magjistrat në skemën e delegimit ose inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; c) nuk ka qenë anëtar i Këshillit në tri vitet e fundit.

<sup>120</sup> Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm mund të vendosin caktimin në pozicione të përkohshme të magjistratëve për të mundësuar ushtrimin e detyrave dhe funksionimin e institucioneve të drejtësisë.

ndryshëm, ndërkohë vërehet se është kërkuar njoftimi i prokurorit Ylli Pjetërnikaj në tri seanca, përkatësisht të datave 3.4.2018, 29.5.2018 dhe 12.6.2018;

- axhendën e vizitës studimore Bruksel, Belgjikë 31 maj - 1 qershor 2018.

**60.4** Duke qenë se subjekti ka paraqitur vetëm kopje të pjesëve të procesverbaleve të seancave gjyqësore që iu përkasin viteve 2017, 2018 dhe 2019, ka qenë e paqartë sa është numri i seancave të zhvilluara për këtë çështje ku subjekti nuk ka marrë pjesë. Për këtë arsye, subjektit iu kërkuar të paraqesë kopje të procesverbaleve të seancave gjyqësore nga dosja gjyqësore, për të vërtetuar nëse ka raste të tjera të mungesës së prokurorit dhe shkaqet. Në parashtrimet e tij, subjekti ka paraqitur shkresën kthim përgjigjeje nr. “\*\*\*\*”prot., datë 18.4.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila përcjell katër procesverbale të nxjerra nga dosja gjyqësore nr. “\*\*\*\*”, e cila është aktualisht në gjykim, konkretisht të datave 2.5.2018, 15.5.2018, 29.5.2018 dhe 12.6.2018. Nga përmbajtja e tyre konstatohet se: në seancën gjyqësore të datës 2.5.2018, prokurori Ylli Pjetërnikaj ka qenë i pranishëm; në seancën gjyqësore të datës 15.5.2018 ka qenë i pranishëm; në seancën gjyqësore të datës 29.5.2018, prokurori Ylli Pjetërnikaj nuk ka marrë pjesë dhe ka njoftuar gjykatën për mosparaqitjen e tij, pasi ndodhet në seminar jashtë shtetit; në seancën gjyqësore të datës 12.6.2018 nuk është paraqitur për shkak se me urdhrin nr. “\*\*\*\*”, datë 6.6.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm, ai është caktuar drejtues Prokurorie në Shkodër. Nga dokumentet e paraqitura vlerësohet se pretendimet e ngritura nuk qëndrojnë, pasi nuk konstatohen mungesa të pajustificuara të subjektit në seancat gjyqësore.

**60.5** Ngrihen pretendime se çështjet e kallëzuara nga Ministria e Drejtësisë për drejtoritë e burgjeve dhe institucione të tjera janë pushuar nga subjekti pa kryer asnjë hetim të thelluar. Gjatë hetimit administrativ, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë informoi<sup>121</sup> se: *“Nga verifikimet e kryera nga data 1.1.2015 deri në datën 31.12.2019 nuk rezulton të ketë asnjë rast për kallëzime penale të bëra nga Ministria e Drejtësisë ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe/ose IEVP-ve apo punonjësve të tyre, të hetuara nga prokurori Ylli Pjetërnikaj”*. Bazuar në korrespondencën zyrtare, pretendimi i ngritur nga denoncuesi rezultoi i pabazuar.

**60.6** Pretendohet se prokurori Ylli Pjetërnikaj ka kryer shkelje flagrante në lidhje me dënimin dhe burgosjen e dy shtetasve me iniciale B. SH. dhe T. D., të kallëzuar nga kunata e tyre, kallëzim i cili rezultoi i rremë e më pas ata u dëmshpërblyen nga shteti për burgim të padrejtë.

**60.7** Gjatë hetimit administrativ, Komisioni administroi dosjen e çështjes së hetuar nga prokurori<sup>122</sup>, nga shqyrtimi i akteve të së cilës janë evidentuar të gjitha veprimet hetimore e procedurale të subjektit që nga data 11.1.2016, kur shtetasja R.S., ka bërë kallëzim penal, pasi në adresën e saj të Facebook-ut kishin mbërritur mesazhe kërcënuese nga shtetasi Sh.B., pasqyruar në mënyrë të hollësishme në rezultatet e hetimit administrativ. Në përfundim të hetimit administrativ, në mënyrë të përmbledhur rezultuan rrethanat dhe veprimet hetimore, si më poshtë:

**60.8** Në datën 11.1.2016, shtetasja R.S., ka bërë kallëzim penal, pasi në adresën e saj të Facebook-ut kishin mbërritur mesazhe kërcënuese nga shtetasi Sh.B.

**60.9** Në datën 3.2.2016, subjekti Ylli Pjetërnikaj ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “përndjekje”, parashikuar nga neni 121/a/1 i Kodit Penal.

**60.10** Pas kryerjes së një sërë veprimesh hetimore, në datën 5.2.2016, prokurori Ylli Pjetërnikaj ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuuohet vepra penale, shtetasve Sh.B., dhe D.T. Po në këtë datë, prokurori ka urdhëruar ndalimin e këtyre dy shtetasve, të cilët dyshohen për kryerjen e veprës penale “përndjekje” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 121/a/1 dhe

<sup>121</sup> Me shkresën nr. “\*\*\*\*”prot., datë 21.4.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 22.4.2022).

<sup>122</sup> Vënë në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 21.4.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 22.4.2022).

25 të Kodit Penal. Pas ndalimit, këta shtetas kanë deklaruar para OPGJ-së së komisariatit të policisë se ndalimi është i paligjshëm, i bërë në rrethanat e një kallëzimi të rremë.

**60.11** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dërguar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën e prokurorit Ylli Pjetërnikaj për vlerësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” ndaj dy të dyshuarve si më lart. Kjo gjykatë vendosi vleftësimin si të ligjshëm të ndalimit për të dy personat nën hetim, ndërsa për sa i përket masës së sigurimit ajo ka vendosur: (i) caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj personit nën hetim Sh.B. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit, me ndryshimin që masa e sigurimit “arrest në burg” të jetë me afat deri në datën 25.3.2016. Ndaj këtij vendimi është bërë rekurs dhe Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij. Me vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 25.3.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, duke zgjatur kështu edhe afatet e paraburgimit; (ii) caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” ndaj personit nën hetim D.T. Gjykata e Apelit ndryshoi masën e sigurimit, duke i caktuar personit nën hetim D.T., masën e sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

**60.12** Subjekti Ylli Pjetërnikaj ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë “Kërkesë për paraqitjen e të dhënave kompjuterike” (kërkesa nuk e ka datën se kur është paraqitur) nga subjekti *Facebook*.

**60.13** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. “\*\*\*\*”, datë 18.3.2016, vendosi pranimin e kërkesës së prokurorit dhe marrjen e të dhënave kompjuterike nga shoqëria *Facebook*.

**60.14** Në datën 3.5.2016, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimeve për një afat tremujor, duke filluar nga data 5.5.2016 deri në datën 5.8.2016, duke arsyetuar se hetimi i këtij procedimi penal nuk u përfundua në afatin e caktuar, për arsye se nuk është arritur të ekzekutohet vendimi i mësipërm i gjykatës dhe, për këtë arsye, për kryerjen e hetimeve të mëtejshme është kërkuar zgjatje e afatit të hetimeve prej 3 muajsh.

**60.15** Pas administrimit të përgjigjes në datën 24.10.2016 nga subjekti *Facebook*, në seancën e datës 27.10.2016, prokurori i kërkoi gjykatës tërheqjen e akuzës për dy të pandehurit dhe kalimin e akteve pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe gjykata vendosi deklarimin të pafajshëm të të pandehurve. Nga përgjigja e ardhur nga kompania *Facebook* rezultoi se adresa e *Facebook-ut* nga e cila dërgoheshin mesazhet, është regjistruar nga numri i telefonit që në procesverbalin e marrjes në pyetje, kallëzuesja ka deklaruar se ka qenë i saj dhe se e ka përdorur vetëm ajo. Gjithashtu, ka rezultuar se i pandehuri Sh.B., në kohën e hapjes së llogarisë në *Facebook* me emrin H.D., ka qenë në Itali, ndërkohë IP-ja e hapjes është në Shqipëri gjatë gjithë kohës.

**60.16** Subjekti Ylli Pjetërnikaj në datën 26.10.2016 ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal ndaj shtetasës R.S., për veprën penale “kallëzim i rremë”, parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal. Në datën 17.1.2017 ka vendosur dërgimin në gjykatë të kësaj çështjeje penale dhe ka kërkuar deklarimin fajtor të së pandehurës R.S., për kryerjen e veprës penale të sipërpërmendur dhe dënimin e saj me 3 vite burgim.

**60.17** Në dosje janë administruar disa kërkesa të avokatit mbrojtës të shtetasit Sh.B., drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë: (1) kërkesë për marrjen e kopjes së akteve të hetimit paraprak në ngarkim të shtetasit të mbrojtur prej tij; (2) kërkesë për marrjen e provave (të listuara në kërkesë), ku është ngritur dhe pretendimi se nga ana e prokurorit nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore për këtë ngjarje të inskenuar nga një person i jashtëm ose drejtpërdrejt nga R.S., e cila i ka manipuluar të gjithë dëshmitarët e të akuzuarit, si dhe organin e prokurorisë. Në dosje nuk ka të administruar asnjë përgjigje të prokurorisë drejtuar avokatit në lidhje me

këto kërkesa, por rezulton se avokati e ka parashtruar edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për kryerjen e veprimeve të sipërlistuar<sup>123</sup>.

**60.18** Gjithashtu, nga avokati i personit nën hetim Sh.B., janë depozituar në prokurori edhe tri kërkesa për njohjen me aktet e hetimit paraprak<sup>124</sup>, si dhe një kërkesë për pavlefshmërinë e veprimeve procedurale të datës 27.7.2016, të kryera nga OPGJ-ja pa praninë e mbrojtësit. *Pretendohet se në IEVP-në ku ndodhej i pandehuri, ai është kontaktuar dhe i është kërkuar që të nënshkruajë pa prezencën e avokatit të zgjedhur prej tij, i cili ndodhej në një proces gjyqësor.*

**60.19** Përveç sa më sipër, gjatë hetimit administrativ u kryen verifikime edhe në lidhje me pretendimin e denoncuesit se personat ndaj të cilëve u vendos pafajësia janë dëmshpërblyer nga shteti për burgim të padrejtë, nga ku rezultoi se: (a) Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë informoi se z. Sh.B., ka paditur Ministrinë e Financave dhe Degën e Thesarit Tiranë, me objekt padie *“detyrimin e të paditurit ... për të kompensuar paditësin Sh.B., për burgim të padrejtë 263 ditë paraburgim, nga data 8.2.2016 deri në datën 27.10.2016; detyrimin e të paditurit Ministria e Financave për të dëmshpërblyer shpenzimet gjyqësore”*. Në këtë proces, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka qenë person i tretë; (b) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur<sup>125</sup>: (i) *pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë; (ii) detyrimin e palëve të paditura të kompensojnë paditësin Sh.B., për ditët e qëndrimit në kushtet e arrestit në burg për periudhën 8.2.2016 - 27.10.2016, konkretisht 262 ditë x 2500 lekë/ditë = 655.000 lekë (...)*. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë<sup>126</sup>.

**60.20** Me qëllim për të hedhur dritë mbi përshtatshmërinë e masës së sigurimit “arrest me burg”, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi caktimin e kësaj mase në raport me kriteret e parashikuara në nenet 228 - 230 të Kodit të Procedurës Penale. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 10, subjekti ka informuar mbi veprimet hetimore të kryera prej tij në lidhje me kallëzimin e shtetasës R. S., si: është administruar përmbajtja e mesazheve; është këqyruar faqja *Facebook* e kallëzueses; është këqyruar faqja *Facebook* e shtetasit F.S., (vëllai i kallëzueses) dhe është pyetur ky shtetas; është pyetur i fejuari i kallëzueses, shtetasi E.T., dhe janë ballafaquar shtetasit R.S., F.S., dhe K.B., motra e tyre dhe gruaja e shtetasit Sh.B.; ka kërkuar marrjen e të dhënave kompjuterike drejtuar shoqërisë *Facebook*. Sipas subjektit, nga provat e administruara provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm fajësia e të pandehurve dhe Gjykata ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për shtetasin Sh.B., ndërsa për shtetasin D.T., “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Subjekti deklaroi se ky vendim është verifikuar disa herë nga e njëjta gjykatë apo gjykatat e shkallëve më të larta, të cilat e kanë lënë në fuqi.

**60.21** Sa i takon ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të posaçme të parashikuara nga neni 228 i Kodit të Procedurës Penale për caktimin e masës së sigurimit, subjekti ka deklaruar se dëshmitarët dhe procesverbalet e këqyrjes së komunikimeve në *Facebook* krijojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistencën e veprës penale të përndjekjes dhe se nuk kishte asnjë *indicie* që ato ishin të krijuara nga kallëzuesja, por, meqenëse shtetasi Sh.B., jetonte në Itali, kjo deduktonte rrezikun e ikjes si kusht i posaçëm në kuptim të paragrafit të tretë të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas tij, duke vlerësuar kriteret e përcaktuara në nenin 229 të Kodit të Procedurës Penale, është konkluduar që të kërkohet caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, duke mbajtur në konsideratë rrethanat e kryerjes së veprës penale, rëndësinë e faktit (në shumë raste të tjera, pasoja e ardhur është vdekja e viktimës), karakterin e vazhdueshëm të

<sup>123</sup> Kërkesë e datës 6.5.2016, me objekt “sigurimi i provës”.

<sup>124</sup> Kërkesë e datës 22.4.2016 për marrjen e kopjes për aktet e hetimit paraprak; kërkesë e datës 29.7.2022 për njohjen me aktet e hetimit paraprak deri më 30.7.2016; kërkesë e datës 29.7.2016 për njohjen me aktet e hetimit paraprak të kryera pa praninë e mbrojtësit, veprime të kryera në datën 27.7.2016.

<sup>125</sup> Vendimi nr. “\*\*\*\*” (“\*\*\*\*”), datë 31.5.2017.

<sup>126</sup> Vendimi nr. “\*\*\*\*”, datë 14.11.2019.

veprës penale, masën e dënimit penal. Pas administrimit të të dhënave nga subjekti *Facebook*, provë determinante sipas tij, nga ku rezultoi që adresa IP i përkiste kallëzueses, ai tërhoqi akuzën në seancë gjyqësore dhe regjistroi ndaj të pandehurës procedimin penal për kryerjen e veprës penale “kallëzim i rremë”.

**60.22** Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës, duke i kërkuar të japë sqarime në lidhje me konstatimet, nga ku duket se:

- Pavarësisht se në deklarinimin e dhënë nga F.S., (vëllai i kallëzueses R.S.) ai ka mbështetur kallëzimin e rremë të bërë nga ajo, duke çuar në konkluzion të gabuar prokurorinë dhe gjykatat që vendosën masat e sigurimit për dy të pandehurit, subjekti ka regjistruar procedim penal vetëm për shtetasen R.S. Shtetasi F.S., në një prej procesverbaleve të marrjes në pyetje si person që mund të tregojë rrethana të dobishme për hetimin, është shprehur se: *“Unë nuk kam dyshime, por jam plotësisht i bindur se pas këtij profili është shtetasi Sh.B... Këtë e them me bindje, pasi për këtë problem kam diskutuar vetë me Sh., dhe më ka pranuar që këtë adresë e ka hapur vetë ai... ”*. Pra, pavarësisht se u provua që ky person ka mbështetur kallëzimin e rremë të kryer nga kallëzuesja dhe ka dhënë deklaratat të rreme para oficerit të policisë gjyqësore, ndaj tij subjekti nuk ka regjistruar asnjë procedim penal dhe as nuk ka iniciuar ndonjë hetim.

- Veprimet hetimore të subjektit, pas të cilave ka kërkuar masën e sigurisë “arrest me burg”, janë kryer duke marrë në konsideratë vetëm kallëzimin e shtetasës në fjalë, duke mos marrë parasysh kërkesat e avokatit të të pandehurit Sh.B., për kryerje të veprimeve të tjera hetimore, të cilat mund të çonin në zbardhjen e së vërtetës.

- Në dosjen hetimore mungojnë përgjigjet ndaj kërkesave të avokatit mbrojtës të shtetasit Sh.B.

-Për sa ka rezultuar deri në këtë moment të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, duke mos kryer hetimin e plotë në lidhje me këtë çështje, si dhe duke mos respektuar të drejtën e përfaqësuesit të të pandehurit për të pasur kopje të fashikullit hetimor, duket se ka shkelur të drejtën për liri të të pandehurit, për shkak të mbajtjes në burg në mënyrë të kundërligjshme. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës që të japë sqarime në lidhje me konstatimet e mësipërme.

**60.23** Në parashtrimet e tij, subjekti ka argumentuar se:

- Në lidhje me konstatimin e parë se shtetasi F.S., ka mbështetur kallëzimin e rremë dhe se ndaj tij nuk është iniciuar ndonjë hetim, subjekti ka sqaruar se nga provat e administruara nuk rezulton që shtetasi F.S., të ketë pasur dijeni që shtetasja R.S., ka krijuar prova dhe ka bërë kallëzim të rremë për ngjarjen, por përfytyrimi i tij për ngjarjen ishte përfytyrim i gabuar i krijuar nga motra e tij.

- Në lidhje me mosmarrjen parasysh të kërkesave të avokatit të të pandehurit për kryerje veprimesh hetimore (kërkesë e datës 22.4.2016, marrë dijeni nga subjekti më 1.5.2016), si: pyetja e personit nën hetim, ballafaqimin e tij me disa shtetas, kryerje ekspertimi të komunikimeve elektronike etj., se për sa kohë ato janë bërë prezente edhe në seancën gjyqësore të datës 09.05.2016 dhe kjo kërkesë është rrëzuar nga gjykata, kthimi i përgjigjes nuk është vlerësuar i nevojshëm, pasi ballafaqimet e kërkuara, për sa kohë shtetasit e kërkuar ishin pyetur edhe më parë apo ishin ballafaquar, ballafaqimi tjetër nuk do të ishte efektiv. Ndërsa kryerja e ekspertimit të komunikimeve elektronike nuk do të ishte e mundur teknikisht të realizohej.

- Në lidhje me mungesën e përgjigjeve ndaj kërkesave të avokatit të të pandehurit, subjekti deklaroi se nuk qëndrojnë. Sipas tij, nga aktet e fashikullit të procedimit rezulton se në faqen 244 të tij është paraqitur kërkesa e shtetasit Sh.B., nëpërmjet mbrojtësit të tij, Y.K. Kjo kërkesë mban datën 29.7.2016, por rezulton se nuk është protokolluar nga sekretaria e institucionit të prokurorisë. E njëjta kërkesë rezulton edhe në faqen 225 të fashikullit, me anë të së cilës kërkohet njohja me aktet e hetimit të kryera pa praninë e mbrojtësit për të pandehurin Sh. B.

Ndërsa në faqen 226 rezulton kërkesa e datës 27.7.2016 për njohjen me aktet e hetimit paraparak. Kjo kërkesë rezulton e protokolluar nga sekretaria e prokurorisë. Nga akti i kërkesës për gjykim rezulton se avokati Y.K., ka nënshkruar “*Mora dijëni sot, në datën 30.7.2016*” dhe ka vendosur nënshkrimin e tij. Në datën 26.7.2016 është përpiluar procesverbali për njohjen e akteve nga i pandehuri Sh.B., ndërsa në datën 30.7.2016 është nënshkruar nga avokati Y.K. Pra, në këtë datë, avokati është njohur me të gjitha aktet e fashikullit të hetimit. Gjithashtu, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është paraqitur kërkesa nr. “\*\*\*\*” prot., datë 6.5.2016, nga mbrojtësi Y.K., me anë të së cilës ka kërkuar dorëzimin e vendimit të prokurorit për zgjatjen e afateve të hetimit datë 4.5.2016, si dhe kërkesa për pezullimin e hetimeve për shkak se autori nuk njihet. Ai në këtë kërkesë pretendonte se, pavarësisht se rezulton që është njohur me vendimin për zgjatjen e afateve të hetimit, nënshkrimi i aktit për marrjen dijëni nuk vërtetonte se ishte njohur me përmbajtjen. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më 14.6.2016, është paraqitur kërkesa nr. “\*\*\*\*”, me të cilën ka kërkuar leje të veçantë për të paraburgosurin, e cila është pranuar me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 14.6.2016, për miratimin e lejes së veçantë për të marrë pjesë në varrim.

- Në mbyllje të parashtrimeve të tij, subjekti ka deklaruar se organi i prokurorisë ka respektuar të drejtën për liri dhe siguri të shtetasit Sh.B., dhe se veprimet procedurale e hetimore të kryera prej tij janë në përputhje edhe me standardet e vendosura nga GJEDNJ-ja. Lidhur me vlerësimin e “ligjshmërisë” së paraburgimit, subjekti sjell në vëmendje të Komisionit parashikimet e KEDNJ-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. Sipas tij, nuk ka pasur asnjë neglizhencë në veprimet e tij, madje ka qenë i angazhuar maksimalisht në kryerjen e sa më shumë veprimeve hetimore. Më tej ka sqaruar se nga diskutimet edhe me gjykatën vlerësohej se prova e vetme, e cila do të zbardhte të vërtetën, do të ishte letërporosia për ndihmë juridike nga SHBA-ja dhe, sipas tij, procedura e ndjekur në këtë rast për të marrë të dhënat e kërkuara nga *Facebook* është një procedurë e aplikuar për herë të parë nga shteti shqiptar. Ndërsa, në lidhje me dëmshpërblimin për burgim të padrejtë të shtetasit Sh.B., subjekti ka deklaruar se në ushtrimin e detyrës së tij si prokuror ky rast është i vetmi, ku i pandehuri ka përfituar kompensim për burgim të padrejtë. Po kështu, ai ka deklaruar se ka qenë nga prokurorët që ka përballuar ngarkesën më të lartë që në vitin e parë të punës, me afro 440 materiale e deri në vitin 2022 me 618 materiale. Për të vërtetuar këto pretendime, subjekti ka paraqitur vërtetime nga prokuroritë e rretheve gjyqësore Lezhë dhe Tiranë.

#### **60.24** Nga analiza e sqarimeve të subjektit vlerësohet se:

- Për sa pretendohet lidhur me arsyet e mosnësisjes së një procedimi penal ndaj shtetasit F.S., për kallëzim të rremë, është në tagrin e prokurorit ngritja e akuzës dhe çdo vlerësim tjetër përtej kësaj do të zëvendësonte logjikën e prokurorit dhe bindjen e tij të brendshme.

- Lidhur me kërkesat e avokatit për kryerje të veprimeve hetimore shtesë dhe për marrje të akteve të fshikullit, sqarimet e subjektit nuk vlerësohen bindëse dhe nuk përligjin mungesën e vendimmarrjes nga ana e prokurorit në zbatim të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale.

- Në lidhje me dëmshpërblimin e shtetasit Sh.B., për burgim të padrejtë, ku duket se ka subjekti ka shkelur të drejtën për liri të të pandehurit për shkak të mbajtjes në burg në mënyrë të kundërligjshme, nga hetimi administrativ ka rezultuar se masa e sigurimit personal “arrest në burg” për shtetasin Sh.B., është kërkuar nga subjekti dhe është vlerësuar si e ligjshme nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit, ndërkohë që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Pra, vendimmarrja e subjektit lidhur me masën e sigurimit “arrest me burg” të kërkuar prej tij i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor të të gjitha shkallëve dhe nuk është ndryshuar. Nga ana tjetër, ka qenë vetë subjekti që pas administrimit të letërporosisë nga *Facebook*-u ka kërkuar tërheqjen e akuzës në lidhje me shtetasin Sh.B. Për më tepër, nga vërtetimet e prokurorive të rretheve gjyqësore Tiranë dhe Lezhë nuk referohen raste të tjera të kësaj natyre.



Në përfundim të procesit, referuar këtyre fakteve dhe rrethanave, Komisioni nuk mund të arrijë në konkluzionin që subjekti ka cenuar të drejtën për liri të shtetasit Sh.B.

**60.25** Në denoncim ngrihen pretendime se subjekti mbajti në burg një ekspert për disa muaj vetëm se ai nuk pranoi t'i bënte aktin e ekspertimit, sikurse e kërkonte prokurori, derisa gjykata i dha pafajësi e në përfundim u dëmshpërblye nga shteti për burgun e padrejtë. Gjatë hetimit administrativ, me qëllim vlerësimin e pretendimeve të denoncuesit, Komisioni administroi dosjen e çështjes së hetuar nga prokurori<sup>127</sup>, aktet e së cilës janë shtjelluar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ. Në përfundim të hetimit administrativ, nga informacioni<sup>128</sup> i marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në vitet 2015 – 2022 nuk rezultojnë padi ndaj Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për “kompensim për burgim të padrejtë” apo “shpërblim dëmi” dhe nga viti 2017 e në vijim nuk rezulton të ketë kërkesëpadi të depozituar nga shtetasi Ramazan Veseli ndaj Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këto kushte, pretendimet e denoncuesit në lidhje me ekspertin Ramazan Veseli nuk u provuan, si dhe në veprimet e subjektit nuk rezultuan parregullsi që cenojnë aftësitë e tij profesionale.

**60.26** Në denoncim është ngritur pretendimi se: *“Ky prokuror është hetuar dhe është marrë në pyetje disa herë nga prokurorë të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, por gjithmonë ka dalë pa u lagur nga hetimi me ndërhyrjen e ‘tutorëve’ të tij politikë. Kjo verifikohet shumë thjesht duke marrë një kopje të të gjitha vendimeve të mosfillimit dhe pushimit në Prokurorinë e Krimeve të Rënda”*. Denoncuesi i referohet një vendimi të marrë nga prokurorja M.K., për subjektin. Sikurse është referuar te “Kontrolli i figurës”, SPAK-u ka informuar Komisionin se në emër të subjektit Ylli Pjetërnikaj nuk ka ndonjë procedim penal. Ndaj tij është regjistruar kallëzimi nr. “\*\*\*\*”, viti 2017 dhe, në lidhje me këtë kallëzim, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda në datën 13.2.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ndaj vendimit të mosfillimit nuk rezulton të jetë ushtruar ankim<sup>129</sup>.

**60.27** Denoncuesi ka ngritur pretendimin se me emërimin e tij si drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër ai emëroi vajzën e tezes së Prokurores së Përgjithshme si zëvendësdrejtuese të kësaj prokurorie dhe si shefe të Task-Forcë, si dhe punësoi të gjithë fafesisin e saj në Prokurorinë Shkodër. Nga verifikimet e kryera në lidhje me këtë pretendim rezultoi se:

**60.28** Në nenin 44, pika 3 e ligjit nr. 97/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se: *“Zëvendësdrejtuesi i prokurorisë emërohet nga radhët e drejtuesve të seksioneve, të cilët: a) janë vlerësuar “shumë mirë” në tri vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale; b) kanë të paktën pesë vjet përvojë si prokurorë, nga të cilat të paktën tre vjet në të njëjtin nivel; c) zëvendësdrejtuesi i prokurorisë emërohet për një mandat dyvjeçar, me të drejtë riemërimi nga drejtuesi i prokurorisë, pasi të ketë marrë mendimin e mbledhjes së prokurorëve të prokurorisë. Mendimi i mbledhjes së prokurorëve nuk është i detyrueshëm për drejtuesin”*.

**60.29** Prokurorja Sh.M., është emëruar për herë të parë si prokurore në vitin 2008 pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në vitet 2009 – 2013 ka qenë prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pukë, ndërsa në vitin 2014 është emëruar prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër<sup>130</sup>.

<sup>127</sup> Dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 22.4.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 22.4.2022).

<sup>128</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 22.4.2022, nga Prokuroria Tiranë (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 22.4.2022); shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 20.5.2022, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 23. 5.2022).

<sup>129</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 2.3.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 3.3.2022).

<sup>130</sup> DIPP-të e publikuara në *Open Data Albania*.

**60.30** Pas kërkesës së Komisionit për sqarime të mëtejshme lidhur me këtë çështje, në përgjigjet e pyetësorit nr. 10, subjekti ka informuar se me urdhrin e datës 26.10.2018 ka urdhëruar emërimin e prokurores Sh.M., në detyrën e zëvendësdrejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila më parë ishte drejtuese e seksionit për krimin ekonomik-financiar, korrupsionin dhe krimin kompjuterik, emëruar nga drejtuesi i mëparshëm. Më tej, subjekti ka sqaruar se zëvendësdrejtuesi i mëparshëm A.M., kishte paraqitur dorëheqjen nga ky pozicion dhe se ai në cilësinë e drejtuesit kishte njoftuar mbledhjen e prokurorëve, duke u kërkuar paraqitjen e kandidaturave, thirrje së cilës nuk i ishte përgjigjur asnjë prokuror. Sipas tij, meqenëse prokurorja Sh.M., ishte nga radhët e drejtuesve të seksioneve, ishte emëruar në detyrë në vitin 2009 dhe kishte tri vlerësime “shumë mirë”, kishte urdhëruar emërimin e saj në bazë të nenit 44/3 të ligjit nr. 97/2016. Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur: kërkesën për heqjen dorë nga detyra e zëvendësdrejtuesit të shtetasit A.M., të datës 20.10.2018; vendimin e datës 22.10.2018 të drejtuesit Ylli Pjetërnikaj për pranimin e kërkesës për heqje dorë nga detyra e zëvendësdrejtuesit të prokurorisë të z. A.M.; thirrjen e mbledhjes së prokurorëve të datës 22.10.2018 + procesverbalin e mbledhjes; urdhrin nr. “\*\*\*\*”, datë 26.10.2018, të drejtuesit të prokurorisë Ylli Pjetërnikaj për emërimin e prokurores Sh.M., si zëvendësdrejtuese e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

**60.31** Nisur nga sqarimet dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti, duke mbajtur në konsideratë parashikimet e ligjit nr. 97/2016, nuk konstatohen mangësi në procedurën dhe kriteret e emërimit të zëvendësdrejtueses Sh.M., nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, pasi ajo vinte nga radhët e drejtuesve të seksioneve dhe kishte më shumë se pesë vite përvojë pune si prokurore.

**60.32** Ngrihen pretendime në lidhje me shkeljet në procedurat e hedhjes së shortit. Gjatë hetimit administrativ, me qëllim vlerësimit të pretendimeve të ngritura në këtë denoncim, u kërkuar informacion nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nga ku rezultoi se:

**60.33** Prokuroria e Përgjithshme informoi se<sup>131</sup> për këtë periudhë pranë saj është regjistruar ankesa e prokurores M.F., e cila ka parashtruar një sërë problematikash, si: refuzimi i drejtuesit për të shpërndarë çështjet me short; nxjerrja nga ana e tij e urdhrave të kundërligjshëm që pengojnë dhe zvarrisin hetimin; shfrytëzimi nga ana e tij e pozicionit për të dënuar qëndrimet profesionale që bien ndesh me urdhrat e tij të kundërligjshëm etj. Në përgjigjen e tij, ky institucion e ka informuar prokuroren se pas verifikimeve të kryera, aktet e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër janë vlerësuar të drejta dhe se mungojnë kushtet ligjore për fillimin e procedimit disiplinor ndaj tij, ndërkohë që për vetë prokuroren ka pasur një vendim të Prokurorit të Përgjithshëm për fillimin e një procedimi penal ndaj saj.

**60.34** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër<sup>132</sup> informoi se: *“Në dhjetor 2018 janë mbajtur 3 procesverbale të hedhjes së shortit manual; në janar 2019 janë mbajtur 9 procesverbale të hedhjes së shortit manual; në shkurt 2019 janë mbajtur 7 procesverbale të hedhjes së shortit manual; në mars 2019 janë mbajtur 17 procesverbale të hedhjes së shortit manual; në prill 2019 janë mbajtur 12 procesverbale të hedhjes së shortit manual; në prill 2019 janë mbajtur 13 procesverbale të hedhjes së shortit manual; në maj 2019 janë mbajtur 4 procesverbale të hedhjes së shortit manual; në korrik 2019 është mbajtur 1 procesverbal i hedhjes së shortit manual; është një procesverbal i vitit 2019 pa datë, që përmban vetëm emrin e prokurorit dhe tri materialet që i kalojnë atij”*.

<sup>131</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 27.4.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 27.4.2022).

<sup>132</sup> Me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 15.4.2022, Komisioni kërkoi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dokumentacionin e hedhjes së shorteve për periudhën janar 2018 – dhjetor 2019. Me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 5.5.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 9.5.2022), kjo prokurori përcolli fletë të printuara nga sistemi CAMS dhe procesverbale të shortit manual për periudhën në fjalë.

**60.35** Asnjë nga procesverbalet e mësipërme nuk është nënshkruar nga drejtuesi i prokurorisë, por janë nënshkruar nga drejtuesit e seksioneve përkatëse.

**60.36** Sa i takon ligjit të zbatueshëm:

- Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 53 të tij përcakton që caktimi i prokurorit të çështjes kryhet me short në mënyrë elektronike. Procesi i shpërndarjes së çështjeve drejtohet dhe mbikëqyret nga drejtuesi i prokurorisë, i cili siguron paanshmërinë, pavarësinë dhe efikasitetin e punës së prokurorisë, duke marrë parasysh nevojën për shpërndarjen e drejtë të ngarkesës mes prokurorëve.

- Në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. “\*\*\*\*”, datë 29.12.2016 “Për rishpërndarjen e çështjeve në prokurori” përcaktohet se:

*“1. Shpërndarja e çështjeve që paraqiten në prokurori, si rregull, realizohet me anë të shortit elektronik.*

*2. Në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm përjashtohen nga hedhja në short këto çështje:*

*a. Materialet e referuara për hetim, pas orarit zyrtar, në ditët e pushimit dhe ditët e festave zyrtare.*

*b. Referimet dhe kallëzimet që kërkojnë veprime të menjëhershme.*

*Materialet e parashikuara në shkronjat ‘a’ e ‘b’ të kësaj pike në parim i kalojnë për shqyrtim prokurorit të planifikuar për periudhën e gatishmërisë nga drejtuesi i prokurorisë, por kur janë në numër të madh mund t’u nënshtrohen procedurave të shortit, sipas rregullave të parashikuara në këtë udhëzim.*

*c. Çështjet e pushuara, pezulluara apo të mosfilluara më parë, për të cilat më vonë është vendosur rifillimi i ndjekjes penale, i kalojnë menjëherë prokurorit që e ka ndjekur fillimisht hetimin. Në raste të veçanta, kur prokurori që ka hetuar rastin ndodhet me leje, është transferuar ose heq dorë, çështja i caktohet një prokurori tjetër në përputhje me pikën 1 më sipër. Drejtuesi i prokurorisë drejton dhe mbikëqyr procesin e shpërndarjes së çështjeve, duke siguruar paanshmërinë, pavarësinë dhe efikasitetin e punës së prokurorisë që drejton. ...Drejtuesi i prokurorisë siguron paanshmërinë, pavarësinë dhe efikasitetin e punës së prokurorisë, duke marrë parasysh nevojën për shpërndarjen e drejtë të ngarkesës mes prokurorëve”.*

**60.37** I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi arsyen e përjashtimit të çështjeve nga shorti elektronik dhe mbi arsyen e mosfirmosjes nga ana e tij të procesverbaleve të shortit manual, në përgjigjet e pyetësorit nr.10, subjekti ka deklaruar se me marrjen e detyrës i ka kushtuar një vëmendje të veçantë këtij aspekti e, për këtë arsye, ka përpiluar model-procesverbalet, për hedhjen në short elektronik dhe manual të procedimeve, kallëzimeve apo çështjeve që lidheshin me ekzekutimet. Sipas tij, referuar udhëzimit nr. “\*\*\*\*”, datë 29.12.2016, të PP, materialet përkatëse, pasi nënshkruheshin nga drejtuesi i përcillej kërkesë-formulari, së bashku me materialin kryesekretares, e cila kishte detyrimin, në kushtet e mungesës së kancelares, për realizimin e shortit elektronik apo manual. Ajo njoftonte prokurorët, prokurorin e regjistrit dhe drejtuesin e seksionit për orarin e zhvillimit të tij. Prezenca e prokurorëve dokumentohej përmes procesverbalit të përpiluar nga drejtuesi i seksionit dhe nënshkruhej nga të gjithë pjesëmarrësit. Sipas tij, drejtuesi i prokurorisë nuk mund të nënshkruajë një procesverbal për shkak të mospjesëmarrjes në këtë veprim procedural-administrativ, ndërkohë që akti procedural-administrativ formular “Për hedhjen në short” është akti procedural, me anë të të cilit drejtuesi urdhëron hedhjen në short dhe në të është nënshkrimi i tij. Sipas subjektit, kjo është një procedurë standarde në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Subjekti ka informuar Komisionin se, për të zbatuar me përpikëri parashikimet ligjore për shpërndarjen e çështjeve me short, ka nxjerrë urdhrin e datës 30.10.2018 “Për koordinimin e punës në kryesekretari për mbajtjen e regjistrave manualë dhe elektronikë”.

**60.38** Po kështu, subjekti ka dhënë detaje të hollësishme në lidhje me procedimet penale në gjykim, nëse për shkaqe procedurale ishte i nevojshëm zëvendësimi i prokurorit, duke sqaruar se në këtë rast ato nuk mund të hidheshin në short elektronik, për shkak se ky sistem nuk e ka një opsion të tillë e, në këto kushte, zgjidhja e vetme ishte shorti manual. Po kështu, sipas tij, shorti manual ishte një mënyrë për të bërë edhe balancimin e ngarkesës së prokurorëve. Subjekti thekson se në të gjitha rastet shorti manual është bërë duke njoftuar paraprakisht prokurorët dhe drejtuesit e seksioneve përkatëse dhe të gjithë të pranishmit kanë nënshkruar. Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur dokumente tip: formular për përjashtimin nga shorti të kallëzimit penal nr. “\*\*\*\*”, datë 14.7.2019; formular për hedhjen në short (elektronik) të kallëzimit penal nr. “\*\*\*\*” datë 2019; formular për hedhjen në short (manual) të përfaqësimit në gjykim të procedimit penal me të pandehur; procesverbale për hedhjen e shortit manual të nënshkruar nga prokurorët e pranishëm dhe drejtuesi i seksionit; urdhra për përjashtim prokurorësh të ndryshëm nga shorti me qëllim balancimin e ngarkesës; urdhra për përjashtim fashikujsh procedimi penal nga shorti; vendim për zëvendësimin e prokurorit V. S., me prokuroren M.F., për shkak të zgjedhjes së tij anëtar i KLP-së.

**60.39** Nga analiza e sqarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur prej tij vërehet se në të gjitha rastet e shortit manual të referuara ky short është hedhur në prani të prokurorëve të seksionit përkatës dhe është mbajtur procesverbal, i cili është nënshkruar nga drejtuesi i seksionit përkatës. Në rastet e përjashtimit të prokurorëve të ndryshëm apo fashikujve të procedimeve penale të ndryshme nga shorti elektronik, në çdo rast kjo është bërë me urdhër të drejtuesit të prokurorisë në funksion të shpërndarjes së barabartë të ngarkesës ndërmjet prokurorëve, që do të bëhet përmes shortit manual mes prokurorëve të tjerë të seksionit.

**60.40** Përveç sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti konstatohen tri raste të përjashtimit të fashikujve të procedimit penal nga shorti elektronik dhe manual dhe caktimin në vijim të tyre pa short duke iu caktuar një prokurori, sipas urdhrave më poshtë:

i) Me urdhrin nr. “\*\*\*\*”, datë 26.4.2019, “Për përjashtimin e fashikujve të procedimit penal nga shorti”, është urdhëruar përjashtimi i fashikujve të procedimit penal, për të cilat ushtrimi i ndjekjes penale është ushtruar nga prokurori A.B., nga shorti elektronik dhe manual i ndarjes së çështjeve në seksionin në të cilin ai bën pjesë, për shkak të barazisë së shpërndarjes së ngarkesës ndërmjet prokurorëve dhe caktimin e prokurorit A.S., për ushtrimin e ndjekjes penale të këtyre procedimeve penale.

ii) Me urdhrin nr. “\*\*\*\*”, datë 26.4.2019, “Për përjashtimin e fashikujve të procedimit penal nga shorti”, është urdhëruar përjashtimi i fashikujve të procedimit penal, për të cilat ushtrimi i ndjekjes penale është ushtruar nga prokurori F.L., nga shorti elektronik dhe manual i ndarjes së çështjeve në seksionin në të cilin ai bën pjesë, për shkak të barazisë të shpërndarjes së ngarkesës ndërmjet prokurorëve dhe caktimin e prokurorit A.S., për ushtrimin e ndjekjes penale të këtyre procedimeve penale;

iii) Me urdhrin nr. “\*\*\*\*”, datë 26.4.2019, “Për përjashtimin e fashikujve të procedimit penal nga shorti”, është urdhëruar përjashtimi i fashikujve të procedimit penal, për të cilat ushtrimi i ndjekjes penale është kryer nga prokurori V.S., i cili është zgjedhur anëtar i KLP-së nga shorti elektronik dhe manual i ndarjes së çështjeve në seksionin në të cilin ai bën pjesë, për shkak të barazisë të shpërndarjes së ngarkesës ndërmjet prokurorëve dhe caktimin e prokurores M. F., për ushtrimin e ndjekjes penale të këtyre procedimeve penale.

**60.41** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime përse këto çështje nuk u janë shpërndarë me short prokurorëve të tjerë, duke paraqitur dokumente që vërtetojnë ngarkesën në punë të këtyre prokurorëve. Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar në mënyrë të përmbledhur se ka urdhëruar përjashtimin e fashikujve të procedimeve penale të

mësipërme nga shorti manual dhe elektronik, për të garantuar barazinë në shpërndarjen e ngarkesës ndërmjet prokurorëve. Konkretisht, sipas tij, në lidhje me prokurorët F.L., dhe A. B., me urdhrin nr. “\*\*\*”, datë 8.4.2019, ka urdhëruar këta dy prokurorë për ekzekutimin e të gjitha vendimeve të formës së prerë, dhe me urdhrat nr. “\*\*\*”, datë 9.4.2019 dhe nr. “\*\*\*”, datë 12.4.2019, janë adresuar problematikat në lidhje me ekzekutimet dhe është normuar mënyra e zgjidhjes së tyre nga prokurorët A.B., dhe F.L. Në këto kushte, për shkak të volumit të tyre të madh të punës, lindte e nevojshme që ngarkesa e tyre e çështjeve t’u shpërndahej prokurorëve të tjerë, konkretisht prokurorit A.S., i cili sapo kishte nisur punë në këtë institucion pas mbarimit të komandimit dhe nuk kishte ngarkesë.

**60.42** Edhe në lidhje me caktimin e prokurores M.F., është përdorur e njëjta logjikë. Në datën 11.4.2019, prokurori V.S., është zgjedhur anëtar i KLP-së. Zgjedhja si anëtar i KLP-së përbënte shkak për zëvendësimin e tij me një prokuror tjetër në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin në gjykim të procedimeve penale, konkretisht prokurores M.F., e cila ishte pa ngarkesë.

**60.43** Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur shkresën kthim përgjigjeje nr. 16/3 prot., datë 13.4.2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

**60.44** Nga analiza e sqarimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se ai në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë ka urdhëruar përjashtimin e fashikujve të procedimeve penale, për të garantuar barazi në ngarkesën e çështjeve, ku dukshëm nga dokumentet e paraqitura ngarkesa e prokurorëve Ll., dhe B., është disa herë më e madhe se e S., e po kështu edhe ngarkesa e prokurores M.F.

**60.45** Një tjetër pretendim i ngritur në denoncim lidhet me faktin se shtëpia e deklaruar nga subjekti si shtëpi e vëllait Y.P., është e vetë subjektit ku ai jeton, së bashku me bashkëjetuesen e tij të padeklaruar, znj. E.Sh.

**60.46** Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka kryer disa verifikime në lidhje me banesën në pronësi të vëllait të subjektit Ylli Pjetërnikaj, e cila rezultoi në pronësi të vëllait të subjektit Y.P., ku subjekti ka banuar për disa vite dhe ka deklaruar sipas ligjit këtë pasuri si adresë banimi dhe banesë në përdorim (trajtuar në paragrafin 37).

**60.47** Në lidhje me shtetasen E.Sh., u pyet subjekti i rivlerësimit, i cili në përgjigje të pyetësorëve ka dhënë shpjegime të detajuara në lidhje me njohjen, fejesën dhe bashkëjetesën me këtë shtetase dhe ka paraqitur: akte të emërimit në funksionin e gjyqtarit të shtetasës E. Sh.; deklaratimet e saj pranë ILDKPKI-së, si: DPDFD 2020, DPV 2020 dhe 2021, në të cilat deklarohet si adresë vendbanimi ajo në rrugën “\*\*\*\*\*”, në pronësi të prindërve<sup>133</sup>; kontratë kredie nr. “\*\*\*”, datë 7.9.2021, në emër të shtetasës E.Sh., e marrë për blerjen e apartamentit ku bashkëjetojnë nga shkurti i vitit 2022; kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme nr. “\*\*\*”, datë 12.8.2021.

**60.48** Nga verifikimet e kryera, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, bazuar në të gjitha informacionet e administruara<sup>134</sup>, në përfundim të hetimit administrativ, në mënyrë të përmbledhur rezultoi se:

---

<sup>133</sup> Nga sistemi elektronik i ASHK-së rezultoi se në rrugën “\*\*\*\*\*”, në pronësi të shtetasve F., dhe F.Sh., (prindërit e znj. E.Sh.) është regjistruar pasuria e llojit “apartament”, me adresë: ndërtesa nr. “\*\*\*”, shk. “\*\*\*”, ap. 1 “\*\*\*”, Tiranë.

<sup>134</sup> Shihni hyrje-daljet në sistemin TIMS; të dhënat bankare të subjektit; përgjigjet e pyetësorëve nr. 3 dhe 4; shkresën e ILDKPKI-së nr. “\*\*\*” prot., datë 26.4.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*” prot., datë 26.4.2022); shkresën e shoqërisë “\*\*\*\*\*” sh.p.k. nr. “\*\*\*” prot., datë 18.4.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*” prot., datë 20.4.2022); shkresën nga “Raiffeisen Bank” sh.a., nr. “\*\*\*” prot., datë 26.4.2022 (administruar në Komision me nr. “\*\*\*” prot., datë 26.4.2022).

- Me shtetasen E.Sh., subjekti ka pasur njohje që prej vitit 2012 dhe janë fejuar në vitin 2014, kur kanë bërë dhe udhëtime sipas të dhënave të sistemit TIMS.

- Shtetasja E.Sh., ka kryer derdhje në vlera të vogla në vitet 2014-2015 në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit.

- Që prej dhjetorit të vitit 2014 dhe përgjatë periudhës së fejesës, deri në fillim të vitit 2022, subjekti ka banuar në apartamentin në pronësi të vëllait të tij me adresë në rrugën “\*\*\*\*”, deklaruar prej tij si adresë vendbanimi në deklaratimet periodike, ndërsa shtetasja E.Sh., përpara nisjes së bashkëjetesës ka banuar në apartamentin në pronësi të prindërve të saj, të ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, deklaruar prej saj në deklaratimet periodike për vitet 2020 dhe 2021, pasi është bërë subjekt deklarues.

- Ata kanë nisur bashkëjetesën në fillim të vitit 2022, në apartamentin me sip. 97.54 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*” në pronësi të shtetasës E.Sh., të blerë prej saj në gusht të vitit 2021, me burim një kredi bankare.

**60.49** Në përfundim të hetimit administrativ, pretendimi i ngritur në denoncim në lidhje me shtetasen E.Sh., nuk u gjend i bazuar.

#### **Denoncim nga shtetasja Sh.M.<sup>135</sup>**

**61** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, pranë Komisionit u administrua në datën 13.4.2023 denoncimi i shtetasës Sh.M. Në denoncimin e saj, kjo shtetase ngre pretendime për shkelje të ligjit nga ana e subjektit të rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj, duke referuar dosjet e “\*\*\*\*” në Lezhë, trajtuar nga prokurori Ylli Pjetërnikaj etj. Me vendimin nr. 3, datë 14.04.2023, trupi gjykues vendosi t’i kërkojë sqarime subjektit në lidhje me pretendimet e ngritura në këtë denoncim, duke i’u komunikuar me *email* të datës 14.04.2023. Në parashtrimet e tij, subjekti informoi Komisionin se pas kërkesës së tij drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me të cilën ka kërkuar informacion lidhur me materialet kallëzuese dhe procedimet penale ndaj shtetasve/subjekteve tregtare me emrin “\*\*\*\*”, kjo prokurori e ka informuar se në lidhje me shtetasin me emrin “\*\*\*\*” janë të regjistruara procedimet penale nr. “\*\*\*\*” dhe nr. “\*\*\*\*”, të cilat janë në fazën e hetimit. Sipas tij, për këto procedime ai është duke ushtruar ndjekjen penale në cilësinë e prokurorit. Gjithashtu, ndaj shtetasve me mbiemër “\*\*\*\*”, më 15.7.2021, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për referimin penal nr. “\*\*\*\*”. Bashkëlidhur shkresës, gjendet edhe vendimi i mosfillimit për referimin “\*\*\*\*”.

**61.1** Nga përmbajtja e vendimit të mosfillimit konstatohet se shtetasi K.M., ka bërë kallëzim penal ndaj shtetasve A.U., dhe T.U., për të cilët ka pretenduar se e kanë mashtruar për blerjen e një apartamenti. Pra, ishte lidhur kontrata e porosisë, ishte likuiduar çmimi i shitjes, ndërkohë që kallëzuesit nuk i ishte dorëzuar apartamenti. Sikurse vërehet, bëhet fjalë për një mosmarrëveshje civile, zgjidhja e të cilave i nënshtrohet juridiksionit civil. Në këto kushte nuk konstatohen problematika lidhur me vendimmarrjen për mosfillimin e procedimit penal. Sa u takon procedimeve penale ndaj shtetasve/subjekteve tregtarë me emrin “\*\*\*\*”, nr. “\*\*\*\*” dhe nr. “\*\*\*\*”, u vërtetua që janë në fazën e hetimit.

#### **Rivlerësimi profesional sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”**

**62.** Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, bazuar edhe në opinionin e Komisionit të Venecias<sup>136</sup> dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese<sup>137</sup>, të cilat kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e

<sup>135</sup> Shihni denoncimin nga Sh.M., protokolluar nga Komisioni me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 13.4.2023, në dosjen e Komisionit.

<sup>136</sup> Shihni opinionin \*\*\* e Komisionit të Venecias.

<sup>137</sup> Shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, Komisioni nuk i çmoi problematikat e evidentuara dhe të trajtuara hollësisht në këtë vendim si shkaqe që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të germës E të Aneksit të Kushtetutës apo që ta bëjnë atë të papërshtatshëm, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, në asnjë rast nuk u evidentuan favorizime të palëve në proces, e po kështu, krijohet bindja se veprimet dhe mosveprimet e subjektit nuk janë të tilla që do të cenonin besimin e publikut te figura e tij si pjesë e sistemit të drejtësisë, sikurse parashikon pika 5 e nenit 61 të ligjit.

**62.1** Në përfundim, në zbatim të pikës 1 të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni ka vlerësuar se:

i) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

ii) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.

iii) Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.

iv) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Për sa më sipër, sipas germës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

**63.** Për çështjet e referuara në katër denoncimet si vijojnë: (i) denoncimin e shtetases S.Sh., që lidhet me procedimin penal nr. “\*\*\*\*” të vitit 2017; (ii) denoncimin e shtetasit E.Gj., që lidhet me procedimet penale nr. “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*”; (iii) denoncimin e shtetasit G.N., që lidhet me procedimin penal nr. “\*\*\*\*”; (iv) një denoncimi anonim që lidhet me procedimin penal nr. “\*\*\*\*” të vitit 2016, ku në veprimet e prokurorit u konstatua e njëjta problematikë pasi subjekti nuk është shprehur me vendim për memoriet dhe kërkesat e palëve sipas parashikimit të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, trajtuar secili përkatësisht në paragrafët 54 – 54.7; 57 – 57.8; 58 – 58.6 dhe 60.6 – 60.24, për një qëndrim sa më objektiv, Komisioni, vlerësoi transferimin e këtyre çështjeve pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

## **SEANCA DËGJIMORE**

**64.** Në datat 24 dhe 27.4.2023, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj, në përfundim të së cilës ai kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisioneren Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit dhe administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj, si dhe shpalli vendimin në datën 27.4.2023, sipas pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

## **QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**65.** Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjatë dy seancave dëgjimore. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar

tërësisht bashkëpunues, pasi është përgjigjur me korrektesë dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime/deklarime në mënyrë shteruese për informacionin e kërkuar bazuar në dokumente shkresore, të cilat kanë qenë konsistente dhe në koherencë të plotë me deklaratimet ndër vite dhe atë *Vetting*, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

## **KONKLuzion Përfundimtar**

**66.** Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, parimin e proporcionalitetit dhe parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve për një proces të rregullt ligjor, sipas parashikimit të pikës 5 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59/a të ligjit.
- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit.
- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 59/c të ligjit.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, germën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.
2. Transferimin e çështjeve të referuara në katër denoncime nga publiku, sikurse arsyetuar në këtë vendim, pranë institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.



Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 27.4.2023.

**ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Kryesuese (kundër)**

**Firdes SHULI**  
**Relatore**

**Suela ZHEGU**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Ertugena Sokoli*